



**ALEANCA
PËR
SHQIPËRINË
EVROPIANE**

**PROGRAMI I QEVERISË
2013 - 2017**

SHQIPËRIA E GJENERATËS TJETËR

Liri • Përgjegjësi • Solidaritet



Jam krenar për besimin që një shumicë e pazakonshme zgjedhësish investuan tek ne, Aleanca për Shqipërinë Evropiane.

Njësoj siç luftuam të bashkuar për ta fituar këtë besim të madh, do të luftojmë më tutje, me ende më shumë përkushtim ndaj vendit dhe njerëzve, për të jetësuar ndryshimin që Shqipëria e kërkoi më 23 qershor, me forcën e një vote plebishitare të ngjashme vetëm me atë të vitit 1992.

Vullneti popullor i shprehur me atë forcë e rilindi demokratikisht këtë vend përmes zgjedhesh më në fund të lira e të përshëndetura botërisht dhe na e dha ne socialistëve e progresistëve, privilegjin e lartë të drejtimit të punëve të Shqipërisë.

Ne e marrim këtë detyrë me mirënjohjen e thellë që buron prej një privilegji kaq të posaçëm, dhe me të gjithë përluljen që dikton besimi i ardhur nga gjykimi i popullit Sovran.

Jemi krenarë për fushatën plot dritë, ngjyra, energji pozitive që zhvilluam si një koalicion për të ardhmen, duke ringjallur shpresën dhe zgjeruar pjesëmarrjen aktive të njerëzve shumë përtej kufijve të partive politike.

Me diskutimin dhe miratimin e këtij programi në Kuvend, nis përballja e përditshme me realitetin e vështirë të një Shqipërie të lënduar thellë në trup, zemër e mendje, nga një rrënim i gjithanshëm.

Liri e njerëzve dhe e konkurrencës pa asnjë diskriminim e kufizim politik, në funksion të meritës;

Përgjegjësi e gjithkujt përpara vendit e ligjit, në funksion të një shoqërie ku të drejtat e secilit nuk ndahen nga detyrimet ndaj komunitetit;

Solidaritet me më të dobët, në funksion të një bashkëjetese ku barazia e mundësive s'mund të mjaftojë pa drejtësinë sociale.

Këto janë vlerat që do të ndriçojnë rrugën e Aleancës për Shqipërinë Evropiane, në çdo vendim dhe veprim për përmbushjen e këtij programi.

Vizioni ynë është Një Rilindje Shqiptare.

Misioni ynë është të ecim më shpejt për të ndërtuar Shqipërinë e Gjeneratës Tjetër.

Funksioni ynë është mirëqeverisja për të përmbushur zotimet tona duke vënë në jetë, me kurajo e vendosmëri politika të reja dhe duke i dhënë jetë, një kulture të re të ushtrimit të pushtetit.

Bindja jonë është e thjeshtë: Shqipëria meriton më shumë.

Ky vend, vendi ynë i përbashkët, nuk meriton analfabetizmin funksional të mbi 50% të të rinjve, papunësinë e mbi 1 milion njerëzve që jetojnë me ç'u sjell dita dhe me ankthin e pandashëm të së nesërme, shkatërrimin e gjithanshëm të natyrës së vet, ku kush mundet përfiton duke bërë dëm.

Shqiptarët nuk i meritojnë shkeljet e vazhdueshme të lirive dhe të drejtave të tyre, gënjeshtat e përditshme zyrtare, vetminë përballë rreziqeve e problemeve që nuk përballohen dot asesi pa shtetin në krah.

Shqipëria nuk e meriton korrupsionin dhe kriminalitetin që e kanë lidhur e po ia marrin frymën, as renditjen në fund të çdo tabelë ndërkombëtare për standartet e jetës e të shërbimeve publike, mes vendeve të këtij kontinenti apo më gjerë; as imazhin e rënduar në tërë këto vite, kryekreje prej pushtetesh që kanë ndërruar ngjyrë e jo natyrë, radhë e jo zakon, vend e jo model, nuk e meriton Shqipëria.

Shqipëria meriton më shumë, sepse ka gjithçka i duhet që ky popull të jetojë në një ekonomi normale, një shoqëri të sigurtë, një vend të denjë mes të barabartësh në tryezën e Familjes së Bashkuar Evropiane.

Shqiptarët meritojnë më shumë, sepse mund të bëjnë shumë më shumë, nëse kush flet, vendos dhe vepron në emër të tyre, nuk shoh thjesht interesat e punët e veta; nëse kush qeveris nuk i ndan dhe përçan për t'i sunduar, po i drejton me forcën bashkuese të shembullit; nëse kush bën e miraton ligje e rregulla nuk është shkelësi i parë i tyre, po i pari që ligjeve e rregullave u nënshtrohet pa kushte.

Qëllimi ynë është i qartë:

Të qeverisim siç e meriton Shqipëria. T'u japim shqiptarëve një pamje të prekshme të Shqipërisë Evropiane që ëndërrojnë dhe meritojnë. Ta bëjmë Shqipërinë model frymëzues jo vetëm të paqes, po edhe të zhvillimit në rajon.

Ne i sjellim Kuvendit të Shqipërisë këtë program qeverisës, të plotvetëdijshëm se ku duam të shkojmë; me vullnetin për të ndarë me njerëzit e këtij vendi çdo të vërtetë, sado të hidhur; me gatishmërinë për të marrë për këtë vend gjithë vendimet e nevojshme, sado të vështira; me vendosmërinë për t'u rënë ndesh pushteteve apo pozicioneve të privilegjuara që janë krijuar përmes padrejtësive qeveritare, duke deformuar ekonominë tonë, sado të konsoliduara; me frymën e ndërtimit të urave të bashkëpunimit me këdo që ndan me ne jo çdo ide ose bindje, po së paku vetëdijen se Shqipëria është atdheu, kurse Evropa është e ardhmja jonë.

Unë besoj fort se me këtë vetëdije, shqiptarët votuan Rilindjen. Dhe Rilindje do të jetë!

Edi RAMA



PËRMBAJTJA

INTEGRIMI NË BASHKIMIN EVROPIAN

6

SHQIPËRIA EVROPIANE, NË RAJON DHE NË BOTË

8

SHTETI I SË DREJTËS DHE DEMOKRATIZIMI I SHOQËRISË

12

ZHVILLIMI EKONOMIK

25

SHËRBIMET PUBLIKE

43



INTEGRIMI
NË BASHKIMIN
EVROPIAN





Procesi i anëtarësimit në Bashkimin Evropian është një objektiv kombëtar, në funksion të demokratizimit dhe transformimit të shoqërisë shqiptare, në përputhje me vlerat dhe parimet e Evropës së Bashkuar, për t'i dhënë fund kësaj, një tranzicioni të pafund që nuk krijon institucione demokratike, modele zhvillimi të qëndrueshme dhe cilësi jete.

Marrja e statusit të vendit kandidat dhe fillimi i bisedimeve për anëtarësimin në Bashkimin Evropian do të përbëjnë përparësinë e veprimit politik të shumicës së re. Zbatimi me korrektësi i Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (MSA), përmbushja e pjesës së mbetur nga 12 prioritetet e Planit të Veprimit, janë elementë kryesorë për cilësinë dhe shpejtësinë e procesit të aderimit të Shqipërisë në BE.

Ne do të hartojmë Strategjinë e re për Zhvillim dhe Integrim 2014 – 2020 dhe strategjitë e tjera sektoriale, duke siguruar përputhshmërinë e këtyre dokumenteve me IPA II, sikundër do të përditësojmë Planin Kombëtar për Zbatimin e MSA.

Do të përmirësojmë rrënjësisht modelin aktual të bashkërendimit të ndihmës së BE dhe asistencën dypalëshe e ndërkombëtare, duke e kanalizuar atë drejt agjendës zhvillimore të vendit. Në vend të ping pongut institucional do të ndërtojmë një mekanizëm në nivel ndërinstitucional për identifikimin e nevojave dhe kapaciteteve për programimin dhe zbatimin e projekteve të financuara nga BE.

Do të zbatojmë rekomandimet e auditorëve të BE-së në lidhje me akreditimin e strukturave për menaxhimin e fondeve të BE-së. Njëkohësisht, do të qartësojmë përgjegjësitë institucionale për mirëmenaxhimin e ndihmës së huaj, duke përfshirë rolin e Koordinatorit Kombëtar të IPA (NIPAC). Do të bashkërendojmë përgjegjësitë ndërmjet autoriteteve shtetërore në lidhje me projektet e infrastrukturës të financuara nga BE dhe do të ndërmarrim masat paraprake për të mundësuar menaxhimin e fondeve bujqësore IPARD.

Me opozitën parlamentare, do të përvijojmë një marrëdhënie të re, duke nxitur kulturën e

kompromisit politik, duke prodhuar reforma të prekshme e të qëndrueshme shtetndërtuese. Do të ndërtojmë një marrëdhënie të hapur besimi e bashkëpunimi me partnerët ndërkombëtarë në këtë proces dhe më posaçërisht, me të gjitha institucionet vendimmarrëse të BE-së.

Mbështetja dhe konsensusi popullor për këtë qasje do të përkthehet nga ne në veprime konkrete e reforma të qëndrueshme që synojnë konsolidimin e demokracisë dhe të shtetit të së drejtës, krijimin dhe forcimin e një ekonomie tregu funksionale, të aftë për të përballuar forcat e konkurrencës dhe zbatimin e standardeve evropiane në jetën e përditshme.

Bashkërendimi i brendshëm, shoqëruar me vendosjen e shërbimit të jashtëm në pararojë, janë dy elementë të domosdoshëm që do të garantojnë cilësi dhe ritëm më të shpejtë në këtë angazhim. Në të njëjtën kohë, do të garantojnë kurs reformash radikale që do ta trupëzojnë procesin e integrimit evropian në shtratin e politikave zhvillimore të vendit.

Vullneti ynë politik do të jetë i prekshëm falë krijimit të një shërbimi publik evropian dhe reformimit tërësor, strukturor të shërbimit diplomatik dhe financimit të tij, në përputhje me këtë prioritet kombëtar.

Do të ofrojmë stimuj për të promovuar profesionalizimin, meritokracinë dhe qëndrueshmërinë në shërbimin publik për administratorët e rinj evropianë, duke u ndarë një herë e mirë nga sëmundjet e partisë-shtet, nepotizmi e konflikti i interesit.

Ne e konsiderojmë suksesin e procesit të integrimit evropian, të lidhur ngushtë me komunikimin e zhdërvjelltë që duhet të përfshijë të gjithë aktorët kryesorë, e sidomos partnerët socialë, shoqërinë civile, shoqërinë akademike dhe grupet e interesit. Vetëm në këtë mënyrë, pritshmëria e qytetarëve do të jetë realiste dhe reformat do të mund të shoqërohen me mbështetjen e duhur, si dhe ndjenjën e përkatësisë së procesit të integrimit evropian nga ana e shoqërisë shqiptare.



SHQIPËRIA EVROPIANE,
NË RAJON DHE NË BOTË





Politika e jashtme

Programi ynë qeverisës për politikën e jashtme synon jo vetëm të korrigojë gabimet e së shkuarës që kanë rrezikuar të ardhmen euro-atlantike të Shqipërisë, por të rrisë cilësinë dhe të përshpejtojë ritmin e procesit të integritimit në Bashkimin Evropian, besueshmërinë në rajon dhe strukturat euro-atlantike.

Parimet bazë që udhëheqin politikën tonë të jashtme janë normat e gjithëpranuara të së drejtës ndërkombëtare, të mirëkuptimit dhe të respektit të ndërsjellë midis kombeve, respektimit të lirive dhe të drejtave themelore të njeriut, fqinjësisë së mirë, bashkëpunimit rajonal, dhe solidaritetit ndërkombëtar. Politika jonë e jashtme do të udhëhiqet nga parimet e parashikueshmërisë, qëndrueshmërisë dhe vazhdimësisë e ka në qendër të misionit të saj mbrojtjen e interesave kombëtare, parandalimin e konflikteve dhe kontributin për stabilitetin demokratik në rajon e më gjërë.

Vizioni ynë mbështetet mbi partneritetin strategjik me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimin Evropian, marrëdhëniet e konsoliduara dhe strategjike me fqinjët tanë anëtarë të BE-së dhe të NATO-s, si Italia, Greqia dhe Turqia, influenca dhe rrezja e veprimit e të cilave është e pazëvendësueshme në rajonin e Mesdheut dhe në Ballkan, zgjerimin e bashkëpunimit më të thellë e të gjithanshëm me Gjermaninë dhe Austrinë, inkurajimin e rritjes së shkëmbimeve dypalëshe me Francën, Mbretërinë e Bashkuar, Vendet e Ulëta dhe Spanjën, forcimin e lidhjeve me të gjitha vendet e tjera të Bashkimit Evropian dhe Izraelin, sikundër dhe të shkëmbimeve me vende të rëndësishme në rrafshin global si: Kina, Japonia, Rusia, India, Brazili.

Përmbushja e angazhimeve si vend anëtar i NATO-s dhe procesi i anëtarësimit në BE përbën për ne një objektiv kombëtar përcaktues për të ardhmen e shqiptarëve brenda dhe jashtë vendit.

Akset kryesorë të politikës tonë të jashtme

- *Partneritetet strategjike me SHBA dhe BE*
Partneritetet strategjike me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimin Evropian përbëjnë

dy themelet kryesorë të politikës sonë të jashtme. Ne zotohemi që të vëmë në veprim një metodë konsultimi dhe bashkëveprimi intensiv me SHBA dhe BE në forumet dypalëshe, si dhe ato shumëpalëshe në mënyrë që të rritim cilësinë dhe të shumëfishojmë frytet e bashkëpunimit tonë strategjik me Uashingtonin dhe Brukselin.

Përmbushja e angazhimeve që burojnë nga anëtarësimi i Shqipërisë në NATO përbën për ne një prioritet. Ndërkohë që kontributin ushtarak në misionet ndërkombëtare paqeruajtëse apo ndërtimin e paqes, do ta shoqërojmë me një kontribut civil e diplomatik në përputhje me mundësitë tona.

Marrëdhëniet me SHBA do të thellohen në të gjitha aspektet e politikës së jashtme, duke filluar që nga proceset informative të analizës dhe ato të parashikueshmërisë strategjike, deri tek diplomacia publike. Njëkohësisht, marrëdhëniet me BE-në do të fuqizohen nëpërmjet konsultimeve të drejtpërdrejta me kryeqytetet e vendeve që luajnë një rol kryesor në vendimmarrjen e politikës së jashtme evropiane.

- *Cilësi dhe ritëm dhe në procesin e aderimit në BE*
Angazhimi ynë kryesor është marrja e statusit të vendit kandidat dhe fillimi i bisedimeve për anëtarësimin në Bashkimin Evropian. Zbatimi me korrektësi i Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (MSA), 12 prioritetëve të identifikuar nga BE dhe perthithja e ndihmës financiare të BE, mbeten vendimtare në këtë drejtim. Shërbimi ynë diplomatik do të jetë më efikas në përfaqësimin e agjendës evropiane të Shqipërisë në kryeqytetet e vendeve që luajnë një rol kryesor në vendimmarrjen Evropiane.

Ministria e Punëve të Jashtme do të jetë pjesë e rëndësishme e mekanizmit në nivel ndërinstitucional për identifikimin e nevojave në procesin e bisedimeve për anëtarësim në BE, duke drejtuar aspektet e jashtme të këtij procesi. Ndërkohë që aspektet e brendshme do të bashkërendohen nga Ministria e Integritimit Evropian

- *Shqipëria evropiane si model frymëzimi në rajon: përmirësimi i marrëdhënieve dhe thellimi i bashkëpunimit ekonomik me vendet fqinje*



Ne besojmë tek Shqipëria evropiane si model frymëzimi, faktor paqeje dhe stabiliteti demokratik. Ky besim diktohet nga përgjegjësia jonë gjeostrategjike si një vend anëtar i NATO-s, nga pesha dhe hapësira që ka fituar faktori shqiptar pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës dhe perspektiva e integritetit euro-atlantik, e cila orienton doktrinën e sigurimit kombëtar në rajon. Ruajtja dhe konsolidimi i paqes dhe stabilitetit demokratik, sikundër thellimi i bashkëpunimit rajonal me pikësynim final, ankorimin e vendeve të Ballkanit Perëndimor në NATO dhe BE, do të përbëjnë shinat kryesore, ku do të drejtohet politika jonë e jashtme në rajon.

Të drejtat e shqiptarëve në Maqedoni, Mal të Zi dhe Luginën e Preshevës do të përbëjnë prioritet konstant të politikës sonë të jashtme në rajon. Ne do të synojmë trajtimin e çështjes çame në përputhje me normat e gjithëpranuara të së drejtës dhe marrëdhënieve ndërkombëtare.

Konsolidimi i marrëdhënieve me fqinjët tanë anëtarë të BE-së dhe NATO-s si Italia, Greqia dhe Turqia, influenca dhe rrezja e veprimit e të cilave është e pazëvendësueshme në rajonin e Mesdheut dhe në Ballkan, përbën për ne një prioritet. Ky konsolidim do të mbështetet në projekte strategjike për rimëkëmbjen ekonomike dhe lidhjen e rajonit tonë me Evropën. Përparësi kryesore në këtë drejtim do t'i jepet diplomacisë energjitike.

- *Bashkëpunim strategjik me Kosovën*

Bashkëpunimi strategjik me Kosovën do të jetë në funksion të rritjes ekonomike dhe cilësisë së jetës dhe përshtetimit të procesit të integritetit euro-atlantik. Prania e dy shteteve, Shqipërisë dhe Kosovës, përbën një kapacitet qeverisës dhe administrativ shumë të madh për të ndërtuar një të ardhme të përbashkët euro-atlantike. Do të vijojmë ndërmarrjen e hapave që ndihmojnë procesin e njohjeve të mëtejshme të Kosovës në arenën ndërkombëtare .

Do të nënshkruajmë “Traktatin e Miqësisë, Bashkëpunimit, Fqinjësisë së Mirë dhe Sigurisë”, i cili do të instalojë praktikën e organizimit të mbledhjeve të përbashkëta të qeverisë, ku do të orientojmë dhe mbikëqyrim strategjitë e bashkëpunimit të thelluara në planin politik,

ekonomik dhe social.

- *Shqipëria evropiane me një rol të ri në bashkëpunimin shumëpalësh*

Pavarësisht anëtarësimit të Shqipërisë në organizata të ndryshme ndërkombëtare, potenciali i saj nuk përfaqësohet denjësisht për shkak të problemeve të brendshme dhe mungesës së vizionit strategjik. Ne do të intensifikojmë bashkëpunimin dhe përmbushim detyrimet në kuadër të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, OSBE, Këshillit të Evropës. Ne çojmë bashkëpunimin me FMN-në, Bankën Botërore dhe OBT-në, si një shans për zhvillimin e mëtejshëm ekonomik e social, konsolidimin makroekonomik dhe fuqizimin e urave tregtare përmes rregullave të harmonizuara me vendet e tjera pjesëmarrëse në këto organizata.

- *Diplomacia në shërbim të zhvillimit ekonomik të vendit*

Shërbimi diplomatik do të vihet në shërbim të zhvillimit ekonomik të vendit, duke ndërmarrë një kurs iniciativash në fushën e promovimit të Shqipërisë pranë investitorëve të huaj dhe mbështetjes së biznesit vendas në arenën ndërkombëtare. Ekonomia dhe sektorët me avantazh të krahasuar do të jenë forca shtytëse e intensifikimit të kontakteve njerëzore dhe e bashkëpunimit rajonal. Do t'i japim një shtysë të re bashkëpunimit rajonal përmes gërshetimit të “Evropës Juglindore 2020” me projektet e agjendës “Evropa 2020”, të cilat kanë ndikim të drejtpërdrejt në përmbushjen e kriterëve ekonomike të anëtarësimit në BE.

- *Shqiptarët në botë*

Ne do të mbështesim aktivisht shqiptarët që jetojnë dhe studiojnë jashtë vendit, duke i dhënë prioritet vendeve ku ka më shumë prezencë shqiptarësh. Do të ndërtojmë një politikë shumëkahëshe, e cila përfshin rrezatimin e gjuhës dhe kulturës shqiptare, njohjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore, ofrimin e incentivave për ata që dëshirojnë të investojnë në ekonominë shqiptare, reformimin e shërbimit konsullor, duke krijuar shërbime të posaçme, sipas praktikave më të mira evropiane.

Shërbimi i jashtëm është sot pasqyra më e mirë e keqeverisjes. Ky shërbim vuan nga politizimi i skajshëm, pemët familjare dhe rrjetet klanore,



klientelizmi, mungesa e transparencës dhe eliminimi i sistemit të karrierës në bazë të meritës. Në themel të këtij problemi qëndrojnë moszbatimi apo keqzbatimi i ligjit.

Reforma tërësore strukturore e shërbimit diplomatik dhe e financimit të tij do të shërbejë si një shembull për ndërtimin progresiv të një shërbimi publik evropian në vendin tonë. Për përpilimin e kësaj reforme ne do kërkojmë ndihmën dhe mbështetjen e partnerëve ndërkombëtarë. Ne do të racionalizojmë përfaqësimin diplomatik të Shqipërisë në botë, në funksion të përmbushjes me efektivitet të prioriteteve të politikës sonë të jashtme.

Siguria kombëtare dhe kontributi në sigurinë globale

Programi për mbrotjen dhe sigurinë kombëtare do të vazhdojë të mishërojë standardet dhe parimet e Aleancës së Atlantikut të Veriut. Ndër parimet bazë të saj, siguria kombëtare përbën themelin për një zhvillimin demokratik dhe rritje të qenësishme ekonomike të vendit.

Reformimi i forcave të armatosura në përputhje me standardet e NATO-s, do të synojë rritjen e shkallës së profesionalizmit, depolitizim, dinjitet dhe integritet, duke e kthyer atë në një forcë aktive në shërbim të vendit dhe të denjë për standardet e vendeve anëtare të Aleancës.

Hapat kryesorë për arritjen e këtyre objektivave do të fillojnë nga angazhimi i institucional për përgatitjen e Dokumentit të Strategjisë Kombëtare. I mbetur i paripunuar që nga viti 2004, ky dokument i rëndësishëm do të hartohet në përputhje me kushtet e reja të mjedisit të sigurisë, si dhe bazuar në “Konceptin e ri Strategjik” të Aleances, të vitit 2010. Pas miratimit në Kuvendin e Shqipërisë, qeveria do të përgatitë Dokumentin e Ri të Strategjisë Ushtarake, për të realizuar përputhjen e nivelit të ambicjeve kombëtare, me burimet financiare në fushën e mbrojtjes, të parashikuara këto në dokumentin e Rishikimit Strategjik të Mbrojtjes.

Qeveria do të mundësojë kryerjen e një reforme të thellë në Forcat e Armatosura nga pikëpamja

doktrinare, konceptuale dhe strukturore, me qëllim që të rrisë profesionalizmin, të sigurojë depolitizimin e strukturave dhe të forcojë luftën kundër korrupsionit.

Një platformë solide do të hartohet për rritjen e bashkëpunimit me NATO-n, me vendet anëtare dhe ato partnere, për një mbështetje më të madhe të tyre në arritjen e standardeve të kërkuara dhe realizimin e kontributit tonë në misionet e mbrojtjes kolektive dhe ato paqeruajtëse të drejtuara nga Aleanca.

Do të hartojë një plan afatmesëm dhe afatgjatë të zhvillimit të FARSH për periudhën 2013-2020. Synimi i hartimit e zbatimit të planit afatgjatë të zhvillimit do të jetë:

- Krijimi i një strukture të re organizative të FA, duke ulur në mënyrë graduale numrin aktual të personelit;
- Rishikimi i tërë sistemit të edukimit, arsimimit dhe trajnimit të Forcave të Armatosura, me qëllim përgatitjen e ushtarit profesionist, nënofficerit, oficerit të trupës dhe shtabit të Forcave të Armatosura, në përputhje me nevojat e strukturës së re të kësaj force.

Prioritet do të marrë realizimi i gatishmërisë operacionale të Grup Batalionit të Këmbëorisë së Mekanizuar si dhe Grupit të Forcave Tokësore për Operacionet Speciale, duke përmbushur në këtë mënyrë detyrimet ndaj NATO-s në kapacitetet ushtarake, të kërkuara për mbrojtjen kolektive dhe operacionet e ruajtjes së paqes.

Ne do të ripunojmë kuadrin ligjor që rregullon veprimtarinë e Forcave të Armatosura. Në thelb të kësaj pune do të jetë përmirësimi i Statusit të Ushtarakut me synim, rikthimin e dinjitetit të nëpërkëmbur dhe rritjen e besimit të tyre tek shteti.

Rishikimi i kuadrit ligjor për përmirësimin e trajtimit financiar të ushtarakëve aktivë është një domosdoshmëri për mbajtjen dhe tërheqjen e burimeve njerëzore cilësore në Forcat e Armatosura për të ardhmen, por edhe për trajtimin dinjitoz të ushtarakëve në rezervë dhe lirim.



SHTETI I SË DREJTËS
DHE DEMOKRATIZIMI
I SHOQËRISË





Siguria e jetës

Rritja drastike e shifrave të kriminalitetit, veçanërisht e veprave penale të rënda kundër jetës e pronës së qytetarëve dhe shkelja e vazhdueshme e të drejtave e lirive themelore të njeriut, dikton domosdoshmërinë e një reforme themelore shumëdimensionale për të rikthyer sigurinë dhe garantimin e rendit publik, të jetës shoqërore dhe të zhvillimit të sipërmarrjes në Shqipëri, si dhe përmbushjen e angazhimeve tona rajonale e ndërkombëtare.

Anashkalimi ose shkelja e ligjit, mungesa e transparencës dhe e pjesëmarrjes së publikut, anarkia në kuadrin ligjor e reformat sektoriale, militantizmi, mungesa e profesionalizmit, formimi i munguar, demotivimi e në shumë raste, korrupsioni ose lidhjet me botën e krimit, janë ndër arsyet e rritjes eksponenciale të shifrave të krimit dhe nivelit të ulët të efikasitetit të Policisë së Shtetit, duke cënuar besimin e publikut në forcën dhe zbatimin e ligjit.

Duke e konsideruar një prioritet absolut, sigurinë dhe rivendosjen e rendit publik, Qeveria angazhohet për të rikthyer besimin e publikut në një Shqipëri më të sigurt, ku forca e ligjit vlen për të gjithë në mënyrë të barabartë, në përmbushje dhe respekt të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Objektivi ynë absolut është shembja e murit të pandëshkueshmërisë dhe imuniteteve të paligjshme.

Ne:

(i) do të rikthejmë Policinë e Shtetit në krye të detyrës, për të garantuar rendin dhe qetësinë publike;

(ii) do të rikthejmë Policinë e Shtetit në kontroll të territorit, duke angazhuar të gjitha burimet e nevojshme për parandalimin e krimit dhe uljen dukshëm të shkallës së kriminalitetit;

(iii) do të normalizojmë trafikun rrugor, duke marrë masat e domosdoshme për evitimin e aksidenteve të rënda;

(iv) do të përmirësojmë cilësisht shërbimin e Policisë së Shtetit në kufi dhe luftën kundër krimit ndërkufitar.

Qeveria do të ndërmarrë masa për parandalimin e krimit kundër jetës dhe pronës së qytetarëve, duke i kushtuar vëmendje të veçantë rasteve të krimit në familje, mbi baza gjinore, kundër të miturve, të moshuarve e të gjitha shtresave shoqërisht në nevojë, hakmarrjes dhe gjakmarrjes, si dhe ndaj konflikteve të hapura me potencial për të sjellë pasojë kriminale. Duke përfutur edhe nga ndihma dhe përvoja e partnerëve ndërkombëtarë, do të shënojmë rritje cilësore në luftën kundër krimit ekonomik e veçanërisht kundër pastrimit të parave. Ne do të ridimensionojmë po ashtu, luftën e Policisë së Shtetit ndaj veprave penale kundër mjedisit, shkatërrimit të territorit, monumenteve dhe trashëgimisë kulturore.

Qeveria e re do të zbatojë një program konkret për reformimin e thellë të Policisë së Shtetit dhe agjencive të tjera ligjzbatuese:

(i) për të përmbushur standardet më të larta të funksionimit demokratik, transparent, të kontrollueshëm dhe llogaridhënës ndaj qytetarëve;

(ii) për të vënë në zbatim një model pune të bazuar rigorozisht në zbatimin e ligjit, përgjegjësitë, kompetencat, procedurat e veprimtarisë së Policisë së Shtetit;

si dhe

(iii) për të konsoliduar marrëdhëniet me institucionet e pavarura dhe bashkëpunimin intensiv me partnerët ndërkombëtarë e ndërveprimin policor rajonal dhe ndërkombëtar.

Kjo reformë do të nisë me rikonceptimin strukturor dhe funksional të Ministrisë së Brendshme dhe Policisë së Shtetit. Synimi kryesor është ndërtimi i një sistemi mekanizmesh të përqëndruara që garantojnë efikasitet, përgjegjshmëri, veprim funksional për mbrojtjen e plotë të ligjit në të gjithë vendin dhe efektivitet në kohë. Parimi i reformës “Një Shtet – Një Polici” do të bëjë të mundur njësimin e funksioneve policore të disa agjencive ligjzbatuese të ngjashme, duke eliminuar mbivendosjen e kompetencave, anarkinë e veprimit ose mosveprimin, si dhe duke garantuar standardizimin e veprimit në territor dhe kohë.



Qeveria do të fokusohet në përmirësimin e menjëhershëm të cilësisë së shërbimit të Policisë së Shtetit për qytetarët, duke rritur fuqinë parandaluese e goditëse ndaj krimit dhe duke garantuar barazinë para ligjit, pa asnjë përjashtim. Qeveria do të angazhojë të gjitha burimet e duhura për të vënë në jetë parimet themelore në veprimtarinë e punonjësve të Policisë së Shtetit: unifikimi i procedurave të punës, standardizimi i protokollit të performancës, raportimi dhe monitorimi i efikasitetit në punë, thjeshtimi i strukturës organizative dhe reforma e niveleve të drejtimit, ridimensionimi i përgjegjësive për çdo funksion, përcaktimi i ngarkesës së punës dhe përgjegjësitë përkatëse. Zbatimi me efektivitet i këtyre parimeve do të garantojë që asnjë shkelje e ligjit të mos rezultojë e pandëshkuar për mungesë apo konfuzion kompetencash ose mosushtrim të kompetencave të njohura nga kuadri ligjor.

Qeveria do të riorganizojë njësitë policore që shërbejnë pranë qytetarëve, duke synuar përforcimin e shërbimit në territor pranë njerëzve, rritjen e cilësisë së policimit, ndërhyrjes dhe zgjidhjen në kohë të konflikteve që kthehen në burim të ngjarjeve kriminale. Për të shtuar forcën parandaluese të Policisë dhe hetimin efektiv të veprave penale,

(i) do të shkurtojë hallkat e tepërta të drejtimit të strukturave të Policisë;

(ii) do të ridimensionojë dhe përforcojë strukturat bazë të Policisë në nivel të komunitetit;

(iii) do të rishpërndajë forcën policore, duke mbajtur parasysb lëvizjet demografike dhe hartën e potencialit kriminal;

(iv) do të vëmë në zbatim një sistem të përpunimit të hollësishëm të informacionit dhe të analizave kriminale;

(v) do të ndërtojë partneritet efektiv dhe të qëndrueshëm mes Policisë së Shtetit, institucioneve të qeverisjes vendore, shoqërisë civile dhe komunitetit.

Për të rritur shkallën e bashkëpunimit mes Policisë së Shtetit dhe qytetarëve, veçanërisht brezit të ri, qeveria do të përfshijë në kurrikulën e arsimit të detyrueshëm elementët themelore të edukimit ligjor lidhur me fenomenet kriminale, qarkullimin

rrugor, misionin dhe funksionet e Policisë së Shtetit, si dhe edukimin qytetar për transparencë dhe pjesëmarrje në policim. Do të organizojmë një seri aktivitete sensibilizuese për njohjen e legjislacionit dhe bashkëpunimin e publikut në parandalimin dhe evidentimin e veprave penale.

Do të zbatojë një plan masash konkrete për t'i rikthyer dinjitetin dhe autoritetin institucionit dhe punonjësve të Policisë së Shtetit. Këto masa do të përfshijnë drejtimit në vijim.

Ne do të saktësojmë, modernizojmë dhe respektojmë plotësisht kriteret e rekrutimit, promovimit dhe karrierës për punonjësit e Policisë së Shtetit; do të përcaktojmë saktë përshkrimin e punës, përgjegjësitë, si dhe procedurat e punës, monitorimit, vlerësimit dhe promovimit për çdo punonjës të Policisë së Shtetit në të gjitha nivelet duke korrigjuar paligjshmërinë, korrupsionin, militantizmin dhe mungesën e profesionalizmit në këto procese. Mbi këtë bazë, do të rikthejmë vlerat e meritokracisë, profesionalizmit, paanshmërisë dhe devotshmërisë në detyrë dhe do të promovojmë një model policor modern në formë dhe përmbajtje. Në këtë kuadër, ne do të ridimensionojmë sistemin e gradave duke synuar konsolidimin e karrierës dhe gradës për funksion.

Ne do të reformojmë rrënjësisht sistemin e arsimit dhe formimit të vazhdueshëm për punonjësit e Policisë së Shtetit, me qëllim diversifikimin e kapaciteteve njerëzore të Policisë së Shtetit dhe përshtatjen me hapat e zhvillimit shoqëror e kulturor të vendit tonë. Formimi vazhdueshëm do të jetë një element themelor për promovimin dhe karrierën e punonjësve të Policisë.

Qeveria jonë do të përmirësojë menaxhimin e burimeve mbështetëse për të përmirësuar kushtet e punës, teknologjinë e shërbimit, si dhe menaxhimin financiar, me qëllim motivimin dhe rritjen e performancës së shërbimit të Policisë së Shtetit. Qeveria angazhohet të rishikojë trajtimin financiar dhe pagat bazë të punonjësve të Policisë dhe do të shqyrtojë efikasitetin e përdorimit të pagesës së diferencuar për punonjësit që arrijnë rezultate të larta në luftën kundër krimit. Duke rivlerësuar dimensionin human dhe solidar të Policisë së Shtetit si institucion, qeveria do të



garantojë përkujdesje shtetërore të posaçme për familjet e punonjësve të Policisë që kanë humbur jetën në krye të detyrës.

Qeveria do të rivendosë marrëdhënien e besimit dhe bashkëpunimit reciprok mes Policisë së Shtetit me institucionet e pavarura kushtetuese që kanë rol kyç në luftën kundër krimit, veçanërisht Prokurorinë, Shërbimin Informativ Shtetëror dhe sistemin gjyqësor, duke rishikuar kuadrin e përbashkët të akteve koordinuese dhe bashkëpunimin me njësitë e përbashkëta të luftës kundër trafikëve, krimit të organizuar dhe terrorizmit.

Qeveria angazhohet për bashkëpunim të hapur, të gjerë dhe në mirëbesim të plotë me partnerët ndërkombëtarë dhe agjencitë policore të vendeve të rajonit dhe BE-së për të rritur efikasitetin në hetimin dhe goditjen e krimit ndërkufitar e krimit të organizuar; për të bashkërenduar punën fushën e formimit policor, dhe për të përfituar nga ndihma e tyre në zhvillimin e teknologjisë dhe të infrastrukturës.

Qeveria do të garantojë transparencë të plotë për qytetarët dhe mediat lidhur me veprimtarinë e Policisë së Shtetit. Ne do të zgjerojmë, modernizojmë dhe përmirësojmë komunikimin dhe bashkëpunimin me mediat për t'u krijuar atyre mundësitë që u takojnë me ligj, për të monitoruar punën e qeverisë për parandalimin, hetimin dhe ndëshkimin e krimeve, si dhe për të kontribuar në konsolidimin e kulturës së zbatimit të ligjit në Shqipëri.

Siguria e pronës

Mekanizmat që garantojnë respektimin e pronës publike dhe private në Shqipëri janë sot të bllokuara. Menaxhimi i pronave publike është kaotik, nuk ka strategji që e udhëheq, bëhet pa transparencë dhe është shpesh pre e korrupsionit. Qeveria jonë do t'i verë këta mekanizma në lëvizje, duke zhbllokuar dhe bërë funksionale katër shtyllat, mbi të cilat do të mbështet ngrehina pronësore e shtetit:

(i) *kthim-kompensimi i pronave private;*

(ii) *Agjencia e Legalizimeve;*

(iii) *Zyra e Hipotekës (ZRPP);*

dhe

(iv) *pronat publike në nivel të qeverisjes qendrore dhe vendore.*

Qeveria jonë do të ndërmarrë një ristrukturim të gjerë të sistemit të menaxhimit të pronës në Shqipëri, për ta kthyer atë në një sistem modern, efikas dhe transparent në përputhje me praktikën më të mira të vendeve të tjera evropiane. Kjo reformë do të nisë me riorganizimin e të gjitha agjencive që merren me administrimin, regjistrimin dhe dokumentimin e pronave (si Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, ALUIZNI, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Agjencia e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave Publike). Në të njëjtën kohë, qeveria jonë do të rishikojë Strategjinë Ndërsektoriale në Fushën e të Drejtave të Pronësisë 2012 – 2020, për të përcaktuar hapat konkretë dhe prioritarë për t'i dhënë fund kaosit në administrimin e pronave publike dhe private dhe ngritjen në këmbë të një sistemi sa më të përshtatshëm për mbrojtjen e të drejtës së pronësisë, si një prej të drejtave themelore të individit.

Qeveria do t'i kushtojë rëndësi të posaçme hartimit të një dokumenti strategjik për konsolidimin e tokës bujqësore; përfundimit të shqyrtimit të vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokat bujqësore dhe ngritjes së infrastruktures së përshtatshme për ndjekjen dhe trajtimin në vijimësi të këtij procesi.

Qeveria jonë do të zhdukë tri 'zarfat' e hallkave të korrupsionit: zarfi tek kthimi i pronave, zarfi tek legalizimet dhe zarfi tek regjistrimi i pronës. Për të arritur këtë qëllim, qeveria:

(i) *do të përfundojë regjistrimin fillestar në zonat kadasrale që kanë mbetur, duke bërë të mundur krijimin e regjistrit të pasurive të paluajtshme;*



(ii) do të realizojmë regjistrimin e pronave në zonat turistike, bregdetare, akset e rrugëve kryesore;

(iii) do të verë në zbatim një program të veçantë për regjistrimin e pronave në bregdetin e jugut të Shqipërisë;

(iv) do të krijojë Regjistrin Kombëtar Elektronik të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, si një regjister efektiv dhe efikas që u shërben institucioneve publike, atyre private dhe individëve;

(v) do të rishikojë legjislacionin në fuqi lidhur me legalizimin e ndërtimeve informale, me qëllim përcaktimin e rregullave të qarta dhe të drejta që do të shërbejnë për përfundimin e procesit të legalizimit dhe parandalimin e ndërtimeve të paligjshme në të ardhmen.

Për qeverinë e re nuk do të ekzistojë më termi “ish-pronar”. Kjo nuk është çështje termi, por çështje strategjie në zgjidhjen e problemit. Shqiptarët do të jenë të gjithë pronarë të ligjshëm në prona të ligjshme. Qeveria do ta zgjidhë çështjen e pronarëve të vjetër duke:

(i) i dhënë përparësi kompensimit në natyrë, në raport me kompensimin financiar, në mënyrë që të ulet fatura financiare për shtetin;

(ii) e orientuar procesin e privatizimit të pasurive publike drejt kompensimit të ish-pronarëve;

(iii) saktësuar fondin e kompensimit për ish-pronarët, i cili do të operojë në mënyrë transparente sipas një skeme të qartë dhe të barabartë për të gjithë të interesuarit; dhe

(iv) eliminuar me ligj dhe në praktikë zvarritjet burokratike, si bazë për korrupsionin që lidhet me procesin e kthim-kompensimit të pronave.

Qeveria do t'i japë zgjidhje çështjes së pronave të institucioneve fetare

Për të zgjidhur me efektivitet çështjes së kthimit dhe kompensimit të trashëgimtarëve të pronarëve, Qeveria do të nisë punën me kryerjen e një analize të plotë dhe gjithëpërfshirëse të kuadrit normativ në fuqi për kthimin dhe kompensimin e pronave dhe të institucioneve përgjegjëse për zbatimin e tij. Kjo analizë do të identifikojë problemet reale që pengojnë këtë proces dhe do të rekomandojë nisma ligjore e politike për ta përfunduar procesin

e kthim-kompensimit brenda një kohe të përshtatshme, në përgjigje të rekomandimeve të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

Barazia para ligjit dhe sundimi i tij

Shteti i së drejtës është në një krizë të thellë në Shqipëri, ndërkohë që forcimi i sundimit të ligjit është kushti më themelor për konsolidimin e demokracisë dhe zhvillimin e qëndrueshëm politik, ekonomik dhe shoqëror në vend. Suksesi i reformave në drejtësi varet në një shkallë të lartë nga bashkëveprimi mes disa institucioneve të pavarura, duke përfshirë Presidentin e Republikës, Këshillin e Lartë të Drejtësisë dhe Ministrinë e Drejtësisë. Qeveria jonë angazhohet të mobilizojë të gjitha burimet e duhura njerëzore, teknike e financiare që ajo ka në dispozicion, në shërbim të hapjes së një faqeje të re në sundimin e ligjit në Shqipëri, në përputhje edhe me standardet e pritshme për një vend kandidat për anëtar të BE-së. Në katër vitet e ardhshme, ne angazhohemi:

(i) të ndërmarrim të gjitha nismat ligjore dhe masat në kompetencën tonë për të forcuar pavarësinë, paanshmërinë, profesionalizimin dhe efikasitetin e sistemit gjyqësor;

(ii) të ndërmarrim reforma rrënjësore, afatgjata dhe gjithëpërfshirëse për të rivendosur integritetin e pushtetit gjyqësor dhe institucioneve të sistemit të drejtësisë;

(iii) të krijojmë të gjitha kushtet e domosdoshme për funksionimin efikas të sistemit të drejtësisë shqiptare në përputhje me standardet e BE-së;

(iv) të sigurojmë respektimin e standardeve më të larta ndërkombëtare në fushën e të drejtave të njeriut, duke përfshirë aksesin e plotë dhe të barabartë në drejtësi për të gjithë;

(v) të krijojmë një kuadër ligjor penal modern;

(vi) të garantojmë bashkëpunimin e plotë dhe efektiv me institucionet ndërkombëtare të drejtësisë;

dhe

(vii) të përmirësojmë procesin e hartimit të legjislacionit.



Qeveria do të ndërmarrë nisma strategjike dhe të mirëpërlllogaritura për të përmirësuar strukturën e sistemit të drejtësisë në Shqipëri, në pajtim me praktikat më të mira të vendeve anëtare të BE-së dhe në bashkëpunim të plotë me aktorët kombëtarë dhe ndërkombëtarë që kanë lidhje me sistemin e drejtësisë në vend. Për këtë qëllim, qeveria do të iniciojë:

(i) ndryshime në ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë” dhe në ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar, me qëllim përcaktimin e rregullave dhe procedurave të qarta që duhet të ndjekin strukturat inspektuese përkatëse pranë këtyre dy institucioneve;

(ii) ndryshime në ligjin për Gjykatën Kushtetuese;

dhe

(iii) amendimin e Kodit të Procedurës Penale.

Qeveria do të ndërmarrë disa nisma të rëndësishme për ta bërë sa më funksional administrimin e drejtësisë në Shqipëri. Disa nga këto nisma janë:

(i) hartimi dhe miratimi i ndryshimeve në të drejtën materiale e procedurale civile dhe administrative, me qëllim harmonizimin me ligjin “Për Gjykatën Administrative”;

(ii) sigurimi i burimeve financiare të nevojshme për zgjerimin e shërbimit të provës;

(iii) reforma e sistemit të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, si garanci në rritjen e besimit të qytetarëve dhe ndërkombëtarëve tek sistemi i drejtësisë;

dhe

(iv) përfundimi i instalimit të sistemit të audio-regjistrimit në të gjitha gjykatat.

Qeveria do të ndërmarrë nismat ligjore dhe rregullatore për të siguruar ekzekutimin e vendimeve të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut apo në raste të tjera kur shteti shqiptar është palë përgjegjëse. Po ashtu, qeveria do të nënshkruajë marrëveshjeve dypalëshe për të garantuar ndihmën e ndërsjelltë juridike në fushën civile dhe penale edhe me vendet me të cilat nuk ekziston ende një marrëdhënie në këto fusha.

Për të kontribuar në përmirësimin e performancës së prokurorëve, gjykatësve dhe avokatëve, qeveria do:

(i) t’i japë mbështetje të plotë Prokurorisë së Përgjithshme për të përfunduar vlerësimin e prokurorëve;

(ii) t’i japë mbështetje të plotë Këshillit të Lartë të Drejtësisë për të përfunduar vlerësimin e gjyqtarëve;

(iii) të ndërmarrë nisma ligjore për t’i dhënë të drejtën gjykatave dhe/ose Avokatit të Popullit të monitorojnë dhe penalizojnë avokatët që nuk respektojnë procesin gjyqësor, duke përfshirë edhe rastet e mosparaqitjeve në seancat gjyqësore;

(iv) të ndërmarrë nisma për të mundësuar aplikimin e parimit të karrierës, bazuar në vlerësimet periodike të gjyqtarëve për emërimet në shkallët e gjyqësorit dhe shndërrimin e Gjykatës së Lartë në gjykatë karriere.

Qeveria do të hartojë dhe miratojë *Strategjinë kundër Korrupsionit në Sistemin e Drejtësisë*, duke përfshirë si subjekte të saj jo vetëm gjyqtarët, prokurorët dhe administratën e tyre, por edhe policinë, avokatët, noterët, si dhe agjencitë e tjera të ngarkuara me zbatimin e vendimeve gjyqësore (përmbarrimin, burgjet, hipotekat, etj.) si dhe të një plani veprimi me masa konkrete e transparente për publikun. Në zbatim të kësaj strategjie, qeveria do të krijojë një Grup të Posaçëm Pune për evidentimin dhe hetimin e sjelljeve dhe akteve korruptive në administratën dhe sistemin e drejtësisë, duke bërë ndryshimet përkatëse në Kodin e Procedurës Penale

Për të garantuar akses të plotë në drejtësi për grupet në nevojë, qeveria do të rishikojë tarifatat për trajtimin gjyqësor të pretendimeve të qytetarëve edhe nëpërmjet harmonizimit të ndryshimeve të kushteve të përcaktuara për ndihmën juridike falas. Po ashtu, qeveria do të hartojë, miratojë dhe zbatojë në bashkëpunim me institucione të tjera publike dhe me shoqërinë civile një Strategji të Drejtësisë për të Miturit. Në funksion të sigurimit të transparencës së plotë të punës së saj dhe të rritjes së pjesëmarrjes së publikut në çështje që kanë të bëjnë me sistemin e drejtësisë, qeveria do t’i ofrojë medias mundësinë e informimit të shpejtë, profesional, kritik e real lidhur me ecurinë e reformave në sistemin e drejtësisë.



Qeveria do të hartojë dhe zbatojë një reformë rrënjësore në sistemin e institucioneve të vuajtjes së dënimeve penale, të shoqëruar me trajnime të vazhdueshme të personelit të këtyre institucioneve dhe përmirësim të kushteve të jetesës e sidomos të kujdesit shëndetësor ndaj të dënuarve. Për këtë qëllim, qeveria do të miratojë ndryshime në ligjin “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të të paraburgosurve”, me qëllim përmirësimin e trajtimit të të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve, konkretisht përcaktimin e rregullave të qarta për trajtimin e kërkesave dhe ankesave të të dënuarve, shërbimin mjekësor, masat disiplinore dhe procedurat e ndryshme për leje, në përputhje me kriteret dhe rekomandimet e Komitetit për parandalimin e dhunës e të torturës të Këshillit të Evropës. Po ashtu, qeveria do të miratojë ndryshime në ligjin “Për Policinë e Burgjeve”, me qëllim përmirësimin e procedurave të punësimit, transferimit, trajnimit dhe rritjes së përgjegjshmërisë së punonjësve të policisë së burgjeve. Qeveria do të sigurojë kapacitetet e nevojshme financiare për trajtimin e duhur të personave që vuajnë dënimin penal me fonde nga buxheti i shtetit dhe donacionet e huaja.

Krimi i organizuar, terrorizmi e trafikimi

Qeveria do të angazhohet intensivisht dhe në mënyrë të qëndrueshme në goditje të krimit të organizuar dhe trafikut të qenieve njerëzore e substancave narkotike, në respekt të plotë të ligjeve të vendit dhe të angazhimeve të saj ndërkombëtare. Qeveria do të angazhojë të gjitha burimet e duhura njerëzore, teknike dhe financiare për një bashkëpunim të plotë dhe efektiv me partnerët rajonalë e ndërkombëtarë në luftën kundër terrorizmit dhe krimit ndërkombëtar. Për këtë qëllim, qeveria do të themelojë *Byronë Kombëtare të Hetimit*, si një njësi e specializuar në luftën kundër krimit të organizuar, luftës kundër trafikëve, veçanërisht trafikut të qenieve njerëzore dhe lëndëve narkotike, krimit ekonomik dhe luftës kundër korrupsionit, për të garantuar një standard të lartë të evidentimit dhe hetimit të veprave penale. Sofistikimi i veprimtarisë kriminale kërkon përgjigje të menjëhershme, ndaj ngritja dhe fuqizimi i Byrosë Kombëtare të Hetimit do t'i japë një ritëm të ri luftës me krimin e organizuar dhe

korrupsionin në çdo nivel. Ngritja e kësaj byroje do të jetë në zbatim të *Strategjisë së re dhe Planit të Veprimit kundër Krimit të Organizuar*, të cilën qeveria do ta hartojë gjatë vitit të parë të qeverisjes e do ta vërë në zbatim në vitet në vijim.

Demokracia parlamentare

Qeveria jonë do të jetë llogaridhënëse ndaj Kuvendit dhe do të punojë për të përligjur besimin e tij.

Ne besojmë se fuqizimi i parlamentarizmit do të arrihet përmes shndërrimit të Kuvendit në një platforme të përbashkët politike dhe jo thjeshtë si një certifikues i akteve të Qeverisë.

Lënia e mandatit të deputetit, nga ata të cilët si të tillë do të jenë në funksionin e ministrit, synon që sigurojë dhe të realizojë më mirë të drejtën e Kuvendit për kontroll kundrejt qeverisë.

Kjo shumicë qeverisëse e konsideron detyrim kushtetues raportimin e informimin para Kuvendit dhe do t'i përgjigjet me efikasitet dhe seriozitet institucional kërkesave të Kuvendit kundrejt saj.

Për të patur me Kuvendin një komunikim e marrëdhënie më dobiprurëse, tërësisht në përputhje me përcaktimet kushtetuese, është vendosur që një ministër i kësaj qeverie të ketë detyrë funksionale të tij lehtësimin e këtij raporti. Qëllimi është që veprimtaria e Kuvendit të mos zhvillohet sipas interesit politik të momentit të qeverisë.

Kjo qeveri do të bashkëpunojë ngushtë me Kuvendin e Shqipërisë, si institucion në tërësi, për të gjitha reformat ligjore dhe kushtetuese, të cilat do të synojnë vendosjen dhe konsolidimin e shtetit të së drejtës, si dhe përsheptimin e integritetit evropian të vendit.

Qeverisja vendore

Vizioni dhe programi ynë për qeverisjen vendore përputhet me parimet dhe standardet e mishëruara në Kartën Evropiane të Vetëqeverisjes Vendore. Qeveria e re do të mbështesë fuqizimin e pushtetit vendor dhe procesin e decentralizimit në funksion të rritjes së efikasitetit të qeverisjes vendore përmes:



- (i) zbatimit të reformës administrativo-territoriale;
- (ii) përmirësimit të procesit të decentralizimit të financave publike;
- (iii) rritjes së cilësisë dhe modernizimit të shërbimeve publike në nivel të qeverisjes vendore, bazuar në standardet evropiane;
- (iii) rritjes së transparencës dhe llogaridhënies së qeverisjes vendore në raport me komunitetin; dhe
- (iv) rritjes së përfshirjes së qytetarëve dhe grupeve të interesit në vendimmarrjen në nivel të qeverisjes vendore. Prioritetet e qeverisë në këtë fushë janë si më poshtë vijon.

Reforma administrativo-territoriale. Prioriteti kryesor i qeverisë do të jetë rishikimi i ndarjes administrativo-territoriale, duke synuar konsolidimin territorial të njësive vendore të nivelit të parë dhe nivelit të dytë. Kjo reformë do të zbatohet nëpërmjet një procesi të hapur gjithëpërfshirës dhe në bashkëpunim me të gjithë faktorët politikë në vend, komunitetet vendore, shoqërinë civile dhe partnerët ndërkombëtarë. Ajo do të konceptohet dhe zbatohet në përputhje me praktikën më të mirë të reformave të tilla që janë zbatuar në vende të BE-së.

Reforma do të synojë rritjen e efikasitetit dhe përmirësimin e cilësisë e të aksesit të qytetarëve në shërbimet publike vendore; rritjen e burimeve financiare dhe të mjeteve për qeveritë vendore; përmirësimin e mekanizmave të demokracisë përfaqësuese dhe fuqizimin e instrumentave të demokracisë direkte; rritjen e kapaciteteve të administratës publike vendore, si dhe forcimin e strukturave komunitare në nivel njësie vendore, lagje dhe fshati.

Qeveria do ta vërë në zbatim ndarjen e re administrativo-territoriale të vendit në prag të zgjedhjeve vendore të vitit 2015 dhe do ta shoqërojë atë me një paketë reformash fiskale dhe ligjesh mbështetëse, si dhe me ngritjen e mekanizmave konkrete për fuqizimin e njësive të reja vendore.

Reforma e decentralizimit fiskal. Autonomia financiare është thelbi i autonomisë vendore. Duke përkrahur decentralizimin e mëtejshëm të financave publike, qeveria qendrore do të krijojë mundësi që qeveritë

vendore të kenë më shumë burime financiare, në mënyrë që ato të kryejnë funksionet dhe kompetencat e tyre në mënyrë efektive dhe të qëndrueshme.

Për të arritur këtë synim, qeveria do të ndërmarrë nisma të rëndësishme ligjore, duke përfshirë hartimin e ligjit të ri integral për financat e qeverisjes vendore, të paketës së re të decentralizimit fiskal, i cili do të përfshijë zbatimin e konceptit të ndarjes së taksave kombëtare (tax sharing), si dhe përmirësimin e kritereve të ndarjes së transfertës së përgjithshme nga buxheti i shtetit për qeveritë vendore. Ne do të rishikojmë mekanizmin financiar të transfertave të kushtëzuara nga buxheti i shtetit, duke synuar financime të integruara sipas instrumentit të “Kontratave Rajonale të Zhvillimit”, duke rritur transparencën dhe efikasitetin në shpërndarje, si dhe në bashkërendim me objektivat kombëtare.

Rajonalizimi dhe reforma e qarqeve. Qeveria do t’i japë prioritet zbatimit të një reforme të posaçme për nivelin e dytë të qeverisjes vendore që do të synojë krijimin e rajoneve dhe rikonfigurimin e qarqeve sipas modeleve evropiane të Rajoneve Vetëqeverisëse. Kjo reformë do t’u japë një drejtim të ri politikave kombëtare dhe rajonale të zhvillimit, hartimit dhe zbatimit të strategjive rajonale të zhvillimit; do t’i hapë rrugë zgjerimit të funksioneve dhe kompetencave të institucioneve dhe agjencive qeveritare në nivel rajonal; do të sjellë rritjen e burimeve financiare dhe asetëve për rajonet; dhe do të krijojë një model të ri dhe më efikas organizimi dhe funksionimi të autoriteteve qendrore dhe vendore në nivel rajonal. Kjo reformë bëhet veçanërisht e domosdoshme në kuadër të përfshirjes së pritshme të Shqipërisë si vend kandidat në BE dhe do t’u japë rajoneve mundësinë që të përfitojnë drejtpërsëdrejti ndihmë teknike dhe financim nga instrumentat e ndihmës së BE-së.

Përmbyllja e procesit të decentralizimit të kompetencave në funksionet e përbashkëta dhe të deleguara. Qeveria e re angazhohet të përmbyllë procesin e përcaktimit të qartë dhe përfundimtar të përgjegjësisë dhe kompetencave në funksionet e përbashkëta dhe të deleguara, midis qeverisë qendrore dhe vendore, bazuar në parimin e subsidiaritetit. Ne do t’i japim



përparësi ushtrimit të kompetencave në nivelin e qeverisjes vendore dhe në rastet kur qeverisja vendore nuk është në gjendje të arrijë plotësimin e standardeve kombëtare, qeveria qendrore do ta mbështesë atë financiarisht.

Përmirësimi i marrëdhënieve ndërinstytucionale midis qeverisjes qendrore dhe asaj vendore. Qeveria e re do t'i japë përparësi ndërtimit të mekanizmave formalë dhe funksionalë të dialogut ndërinstytucional midis qeverisë qendrore dhe asaj vendore. Asnjë vendimarrje me impakt në qeverisjen vendore nuk do të merret pa u konsultuar më parë me përfaqësuesit e qeverisjes vendore. Kjo do të arrihet nëpërmjet krijimit të Këshillit Konsultativ Qeveri Qendrore - Qeverisje Vendore, përfshirjes së përfaqësuesve vendorë në instrumentat dhe mekanizmat vendimarrës të politikave sektoriale, që kanë pikëprerje me qeverisjen vendore, si dhe forcimit të bashkëpunimit institucional me shoqatat e të zgjedhurve vendorë dhe organizata të tjera të shoqërisë civile.

Zhvillimi vendor. Qeveria do të punojë me përparësi për të ndërtuar një model të harmonizuar të zhvillimit socialo-ekonomik dhe territorial në Shqipëri, duke synuar uljen e pabarazisë në zhvillim midis zonave dhe territoreve të ndryshme të vendit dhe mbështetjen e qeverisjes vendore në nismat për zhvillim vendor. Ky prioritet do të zbatohet nëpërmjet ndërtimit të një kuadri ligjor koherent që do të realizojë harmonizimin vertikal dhe horizontal të Planeve Strategjike të Zhvillimit, të hartuar nga çdo njësi e qeverisjes vendore. Politikat e decentralizimit fiskal do të garantojnë mbështetjen dhe financimin e duhur për zbatimin e strategjive rajonale dhe lokale të zhvillimit.

Mirëqeverisja në nivelin vendor. Rritja e autoritetit vendimarrës të njësisë të qeverisjes vendore, me ndarjen e re administrativo-territoriale të vendit, do të bazohet dhe do të respektojë parimet e mirëqeverisjes dhe të llogaridhënies publike në nivel vendor. Përparësi do të ketë forcimi i transparencës dhe pjesëmarrjes së komuniteteve, biznesit dhe shoqërisë civile në vendimarrjen publike në nivel vendor, nëpërmjet përmirësimit të kuadrit ligjor. Llogaridhënia e administratës publike dhe efikasiteti i shërbimeve në nivel vendor do të garantohet nëpërmjet ngritjes së një sistemi

të veçantë për “monitorimin e performancës në nivel vendor”.

Fuqizimi i administratës vendore. Qeveria e re do të mbështesë konsolidimin një administrate vendore të çburokratizuar, të paanshme politikisht, profesioniste dhe transparente. Ajo do t'i përgjigjet pritshmërive të komuniteteve dhe biznesit për shërbime publike; e aftë që të përballojë sfidat e integritit evropian të vendit, duke respektuar gjithmonë standardet dhe absorbimin e fondeve të BE-së në nivel vendor. Qeveria qendrore do të përkrahë ngritjen e një sistemi të favorshëm dhe të përshtatshëm për trajnimin e administratës publike vendore.

Sistemi i adresave. Qeveria angazhohet t'i japë fund një herë e mirë kaosit në administrimin e Regjistrimit të Gjendjes Civile dhe sistemit të adresave. Në bashkëpunim të ngushtë me qeverisjen vendore, do të angazhohemi në projekte konkrete për të sistemuar përfundimisht administrimin e Regjistrimit të Gjendjes Civile dhe Regjistrimit të Adresave, duke synuar përputhjen dhe administrimin e unifikuar të të dhënave të shtetasve.

Administrata publike

Administrata publike është keqpërdorur nga politika në vitet e fundit, në dëm të profesionalizmit dhe paanshmërisë së saj. Shumë vendime gjykatash për lirim të padrejtë nuk janë zbatuar, duke i shkaktuar shtetit dëm të drejtpërdrejtë ekonomik. Politizimi i administratës dhe pandëshkueshmëria e zyrtarëve përgjegjës ka përkeqësuar nivelin e shërbimeve publike ndaj qytetarëve. Komisioni Evropian ka kritikuar numrin e lartë të kontratave të përkohshme në administratë.

Këto të fundit, shpesh janë përdorur si monedhë shpërblimi për Partinë Demokratike në pushtet. Indekset ndërkombëtarë të korrupsionit në Shqipëri janë në rritje.

Objektivi ynë në 4 vitet që vijnë është rikthimi i dinjitetit në administratën publike, duke e çliruar nga politizimi dhe duke e profesionalizuar në të gjitha nivelet. Për të arritur këtë objektivi do të bëjmë të aplikueshëm ligjin e nëpunësit civil, duke krijuar



kuadrin real të aplikimit të tij dhe duke e zbatuar atë me rigorozitet nëpërmjet konkurseve të hapura e transparente për punësimin në shërbimin civil dhe procedurave transparente të ngritjes në karrierë.

Do të ndërtojmë mekanizmat efikase të kontrollit në mënyrë që administrata të jetë realisht në shërbim të qytetarëve. Struktura e re qeverisë e fokuson administratën drejt rezultateve të matshme dhe një pune më efikase, me numër më të vogël punonjësish. Shtimi i numrit të shërbimeve publike online dhe rritja e përdorimit të tyre do të kontribuojnë në modernizimin, rritjen e efikasitetit dhe luftën kundër korrupsionit në administratë.

Në fokus të qeverisë do të jetë përmirësimi i cilësisë së shërbimeve publike dhe verifikimi i cilësisë së tyre nëpërmjet teknologjisë së informacionit dhe komunikimit për ta rikthyer nëpunësin e administratës në shërbyes të qytetarëve.

Lufta kundër korrupsionit

Në vitin 2012, Shqipëria zbriti 18 vende në renditjen e Indeksit të Korrupsionit të organizatës prestigjioze Transparency International, duke u klasifikuar si vendi më i korruptuar në Evropë. Qeveria e re ka vullnet të palëkundur politik për luftimin e korrupsionit si një nga plagët më të thella që bjerr mundësitë për zhvillim të qëndrueshëm politik, ekonomik dhe shoqëror të Shqipërisë dhe e ndan atë dukshëm nga vendet e Bashkimit Evropian.

Qeveria jonë do të intensifikojë ndjeshëm luftën kundër korrupsionit, duke çmontuar murin e paprekshmërisë e pandëshkueshmërisë. Qasja e qeverisë sonë në luftën kundër korrupsionit do të përqendrohet tre drejtime: parandalim, ndërgjegjësim dhe ndëshkim.

Parandalimi. Qeveria dhe mazhoranca e re:

(i) do të kalojnë në sitë të gjithë legjislacionin ekzistues dhe do të propozojnë nisma ligjore për mënjanimin sa më të madh të mundësive për t'u angazhuar në praktika korruptive në sektorin publik dhe privat, në përputhje me standardet e BE-së dhe instrumenteve ndërkombëtare (si GRECO, OECD, UNCAC);

(ii) do të bartojnë politika shtetërore dhe do të zbatojnë masa konkrete, duke përfshirë ato që lidhen me përmirësimin dhe zgjerimin e sistemeve të qeverisjes elektronike, si dhe përmirësimin drastik të shërbimit ndaj qytetarit në të gjithë sektorët e shërbimeve publike, të cilat minimizojnë motivet dhe mundësitë e zyrtarëve publikë dhe të qytetarëve për t'u angazhuar në korrupsion;

(iii) do të bartojnë Strategjinë dhe Planin Kombëtar të Veprimit kundër Korrupsionit brenda vitit të parë të qeverisjes dhe do ta zbatojnë me efektivitet atë në vitet në vijim;

(iv) do të zbatojnë me përkushtim legjislacionin dhe do të ndërmarrin nisma të reja lidhur me publikimin e dokumentave zyrtare dhe transparencën në procedurat administrative.

Ndërgjegjësimi. Qeveria:

(i) do të përfshijë në mënyrë të gjerë dhe të rëndësishme shoqërinë civile, sektorin privat dhe atë akademik në hartimin, zbatimin dhe monitorimin e nismave ligjore, strategjive dhe programeve kundër korrupsionit;

(ii) do të ndërmarrë nisma ligjore dhe do të përkrahë zbatimin e masave që inkurajojnë njerëzit që denoncojnë korrupsionin;

(iii) do të ndërmarrë dhe përkrahë nisma për vetëdijësimin e qytetarëve dhe sidomos brezit të ri, lidhur me rolin dhe përgjegjësinë e tyre në luftën kundër korrupsionit dhe mekanizmat për eliminimin e tij, duke përfshirë këtu punën përmes edukimit etik dhe qytetar në shkollë.

Ndëshkimi i praktikave korruptive dhe vënia përpara përgjegjësisë të shkelësve të ligjit. Qeveria do të propozojë një reformim të thellë të sistemit të ndjekjes penale kundër korrupsionit dhe do të mbështesë fuqimisht partneritetin polici – prokurori në të gjitha nivelet dhe në të gjitha fazat e ndjekjes penale të rasteve të korrupsionit, duke përfituar edhe nga ndihma teknike e partnerëve ndërkombëtarë në vënien në zbatim të praktikave më të mira për hetimin dhe ndëshkimin e korrupsionit. Në katër vitet e ardhshme, qeveria do të punojë me përparësi për ta shndërruar sistemin gjyqësor, nga një prej segmenteve më të korruptuar të shtetit, në një partner të fuqishëm, pa të cilin çdo iniciativë kundër korrupsionit do të ishte e destinuar të dështonte.



Reformimi i sistemit gjyqësor dhe vendosja në vend e dinjitetit të tij të cënuar do të nxitin angazhimin profesional të gjyqtarëve për t'i shërbyer bërjes drejtësi dhe për të shmangur praktikatat e deritanishme korruptive. Kjo do të arrihet:

(i) duke mënjanuar çdo ndikim politik që ka shërbyer deri më sot për shkëmbime favoresh dhe influencash midis ekzekutivit dhe gjykatës;

(ii) duke i siguruar gjyqësorit kushte sigurie dhe pagese të një niveli të përshtatshëm për detyrën e tyre të lartë;

dhe

(iii) duke forcuar mbikëqyrjen institucionale të gjyqësorit, si me forcimin e instrumentave nga brenda vetë gjyqësorit, ashtu dhe të atyre nga jashtë tij (me theks të veçantë në deklarinimin dhe hetimin e pasurive), duke mbajtur gjithnjë parasysh jo vetëm parimin e ndarjes së pushteteve, por edhe të balancimit ndërmjet tyre.

Për të siguruar zbatimin e plotë të legjislacionit në fuqi dhe të angazhimeve tona për t'i kthyer një herë e mirë shpinën, korrupsionit në Shqipëri, si dhe nën shembullin e praktikave të mira të vendeve fqinje që janë bërë tashmë anëtare të Bashkimit Evropian, qeveria dhe mazhoranca e re do të ngrejnjë strukturën e Koordinatorit Kombëtar kundër Korrupsionit, që do të ketë mandat:

(i) për të propozuar nisma ligjore dhe institucionale me qëllim çrrënjësosjen e korrupsionit nga radhët e administratës publike dhe të të gjithë segmenteve shtetërore që ofrojnë shërbim publik;

(ii) për të koordinuar, monitoruar dhe raportuar mbi zbatimin e politikave qeveritare dhe shtetërore kundër korrupsionit. Po ashtu, në çdo ministri qeveria e re do të angazhojë një drejtues të lartë si përgjegjës për koordinimin e punës, për zbatimin e legjislacionit dhe të programeve qeveritare për eliminimin e korrupsionit.

Shoqëria civile

Në 8 vitet e fundit është goditur rëndë shoqëria civile, e cila nuk ka pavarësinë e duhur për të shprehur hapur qëndrimet e veta me interes social e kombëtar. Sektori, Organizata Jofitimprurëse i shoqërisë civile ka pësuar rënie. Një ndër arsytet

kryesore është presioni qeveritar, i cili shoqërohet me klientelizëm dhe mungesë transparence në ndarjen e fondeve publike, mungesë qartësie të kuadrit ligjor të OJF-ve dhe mungesë të mjedisit mbështetës. Kuadri ligjor ekzistues cënon rëndë pavarësinë e aktivitetit të sektorit jofitimprurës, duke vënë shenjën e barazimit mes tij dhe biznesit e rrjedhimisht duke e rënduar atë me taksa. Ky kuadër ligjor është krejtësisht i paqartë dhe abuziv për sa i përket marrëdhënieve të sektorit me shtetin, dhe si i tillë krijon pasiguri e i hap shtigje keqpërdorimit pushtetar.

Ne besojmë se fuqizimi i shoqërisë civile është një mjet i rëndësishëm në mbylljen e hendekut mes qytetarëve dhe institucioneve. Ne do të bëhemi promotorët e klimës së shëndetshme për pavarësinë, efektivitetin dhe qëndrueshmërinë e shoqërisë civile.

Për t'i vënë OJF-të në shërbim të interesit publik, do të përmirësojmë legjislacionin dhe masat financiare që rregullojnë veprimtarinë e OJF-ve. Zhvillim i kuadrit ligjor të OJF-ve do të nxitë mbështetjen e këtij sektori nga biznesi vendas, filantropia dhe shërbimet vullnetare.

Për të siguruar paanshmërinë e shtetit ndaj shoqërisë civile do të rritim transparencën nga ana e institucioneve zyrtare, me anë të publikimit të mundësive të bashkëpunimit dhe rregullave për aplikimin e organizatave, në projekte të ndryshme.

Një proces i gjerë konsultativ do të realizohet me shoqërinë civile për nismat e reja ligjore, si dhe për monitorimin e vlerësimit të tyre. Shoqërisë civile do t'i ofrohet asistencë për të rritur kapacitetet e tij në fushën e shërbimeve, të cilat ende nuk përballohen nga shteti.

Media

Kuadri ligjor, që garanton pavarësinë e medias është tërësisht i deformuar në praktikë.

Autoriteti i Mediave Audiovizive dhe Radiotelevizioni Shqiptar janë shembuj flagrantë të moszbatimit të ligjit nën qeverisjen e PD-së. Sipas ligjit, të dyja këto institucione duhet të jenë të balancuara dhe anëtarët duhet të jenë të zgjedhur nga shoqëria civile, por në realitet, sot AMA është tërësisht politike dhe e njëanshme.



Reklamat qeveritare, në shumicën e rasteve të padobishme dhe korruptive, nuk ndahen në bazë të vlerës së tregut, numrit të audiencës së kanaleve televizive e radiofonike apo numrit të tirazhit të shitjeve të shtypit të përditshëm, por në bazë të lidhjeve klienteliste dhe korruptive që ka qeveria me kanale televizive e radiofonike dhe gazeta afër saj. Incidentet e dhunës kundër gazetarëve dhe presioni mbi mediat nga politika apo biznese afër saj, përbëjnë një tipar dallues të ndërmarrjes mediatike të qeverisë së PD-së, në 8 vite qeverisjeje.

Kthimi i medias publike në një përfaqësuese të denjë të taksapaguesit shqiptar dhe zëdhënëse të interesit qytetar, do të jetë shumë i shpejtë dhe i qëndrueshëm, falë një kuadri ligjor transparent e të zbatuar në praktikë. Marrëdhëniet me median do të rinovohen duke i dhënë fund presioneve e favoritizmit. Respekti për mendimin ndryshe dhe kritika, si burim përmirësimi e reflektimi, do të kthehet në normalitet.

E drejta e informimit do të përfordhet për të gjithë, e veçanërisht për gazetarët. Për këtë, do të përmirësohen standardet ligjore të së drejtës së informimit, sipas legjislacionit të vendeve të përparuara në këtë drejtje me një sërë masash që nga monitorimi elektronik dhe transparent i kufijve kohorë për afatet e marrjes së përgjigjes nga administrata publike, hartimi i një liste shtruese të kritereve, në lidhje me rastet kur informacioni mund të refuzohet dhe kthimi në funksionalitet i faqeve zyrtare të institucioneve publike dhe ministrive, duke iu mundësuar qytetarëve akses më të madh.

Liria e shtypit dhe pluralizmi i informacionit do të sigurohen nga një kuadër ligjor që do t'u përgjigjet tre objektivave kryesore: luftës kundër centralizimit; garancisë për një pavarësi reale të redaksive; mbrojtjes efikase të burimeve të gazetarëve. Për të garantuar më mirë lirinë e shprehjes, do të ndërmarim një nismë ligjore për uljen e sanksioneve me gjoba ndaj gazetarëve dhe në rastet kur gjykata i vlerëson si gjoba të arsyeshme, të shkojnë në progres të drejtë me nivelin e pagave të gazetarëve shqiptarë.

Do të vendosim kritere objektive transparente, jodiskriminuese të licensimit e një proces licensimi të drejtë dhe transparent, të administruar nga një organ realisht i pavarur rregullator. Aksesit në lehtësitë e transmetimit do të jetë një kusht i rëndësishëm licensimi, ku rregullatorit të ristrukturuar do t'i ofrohet një mandat i qartë për të parandaluar pasojat negative të monopolizimit.

RTSH do të ristrukturohet, duke e kthyer atë në një stacion realisht publik e duke i dhënë këtij sektori forcë nëpërmjet garantimit të pavarësisë së AMA dhe RTSH. Drejtimi i RTSH-së do të sigurohet nga profesionistë dhe roli i Këshillit Drejtues do të përfordhet duke siguruar që të zgjedhurit në të, të jenë me kritere profesionale dhe jo partiake. Do t'i japim një mbështetje të veçantë mediave lokale (radio e televizione), të cilat banorët lokalë i ndjejnë më afër shumëllojshmërisë së problematikave të tyre të përditshme. Paralelisht do të merren të gjitha masat për ndalimin e rreptë të çdo lloj piraterie televizive.

Procedurat e zgjedhjes së anëtarëve të AMA-s janë sot politike dhe do të ndryshohen në favor të performancës profesionale, për t'u ofruar të gjithë transmetuesve vendorë e kombëtarë, trajtim të njëjtë para ligjit.

Dixhitalizimit, që ka si afat final mesin e vitit 2015 dhe që ishte një mision i pamundur për qeverinë e Partisë Demokratike, ne do t'i përmbahemi me gjithë vonesat e trashëguara.



ZHVILLIMI EKONOMIK





Njëzet e dy vjet mbas fillimit të zbatimit të “terapisë së shok-ut” dhe ndërtimit të “ekonomisë së tregut” kemi shkuar drejt “mbylljes” përfundimtare të një cikli të rëndësishëm të tranzicionit “nga planifikimi i centralizuar, drejt tregut të lirë”. Kemi shfrytëzuar e përdorur shumë mundësi për vendosjen dhe performancën e ekonomisë së tregut në kuadrin e paketës së rregullimeve strukturore, ruajtjen e ekuilibrave makroekonomikë, jemi fokusuar pothuajse plotësisht te rritja ekonomike si treguesi i vetëm i suksesit e i performancës së politikave ekonomike e qeverisjes.

Kemi ndërtuar një model ekonomik tipik të tranzicionit, një profil të vetë ekonomisë shqiptare që me të mirat dhe defektet e tij u bë “lokomotiva” që na tërhoqi deri në fund të dekadës së dytë të këtij tranzicioni radikal, ndoshta nga më radikalët në gjithë grupin e vendeve të Evropës Qëndrore e Lindore. Megjithatë, kohës dhe përmbajtjes së këtij modeli duket se i ka ardhur fundi, pasi shumë nga elementët dhe energjitë e tij e arritën maksimumin e tyre dhe tashmë rezultojnë të shteruara për një periudhë tjetër 15-20 vjeçare të ardhshme që shkon deri në horizontin 2025-2030.

Kriza ekonomiko-financiare globale na nxorri në pah probleme thelbësore me natyrë strukturore:

- Sa e qëndrueshme është rritja jonë ekonomike?
- Sa të qëndrueshme janë burimet dhe furnizuesit e kësaj rritjeje?
- A kemi modelin e përshtatshëm për të garantuar ritmet e kësaj rritjeje në vitet që vijnë?
- A kemi një ekonomi të strukturuar e rezistente, me të cilën mund të shkojmë drejt një zhvillimi të qëndrueshëm afatgjatë?

Ekonomia

• Modeli i ri ekonomik

Garantimi i rritjes së qëndrueshme nënkupton faktin se ne do të gjejmë e identifikojmë “burime të reja që ushqejnë rritjen ekonomike” apo dhe « zëvendësuesit » e disa prej burimeve aktuale të rritjes që në periudha afatshkurtra e afatmesme pritet të kontribuojnë shumë më pak se deri më tani.

Nëpërmjet politikave tona ekonomike e financiare ne :

- do ta mbushim “gropën” që po krijon tkurrja e disa sektorëve të ekonomisë, zvogëlimi i remitancave, apo “mbarimi” i privatizimeve;
- do ta eliminojmë apo ngushtojmë deficitin tregtar dhe atë të bilancit të pagesave?
- do ta ristrukturojmë hapësirën rurale ku mbizotërojnë mini-fermat dhe përmirësojmë tendencën drejt një tregu toke aktiv, apo thellimit të kooperimit në formën e shoqatave që është akoma i ulët?
- do ta zhvillojmë, ristrukturojmë e modernizojmë biznesin shqiptar që dominohet nga bizneset e vogla familjare dhe reflekton akoma elementë arkaikë e informalë?

Nëpërmjet politikave tona ekonomike dhe të zhvillimit, do t’i japim përgjigje konkrete pyetjeve, si:

- Cilat janë politikat strukturore që na konvergojnë më mirë e më shpejt me ekonominë evropiane?
- Cilët do jenë sektorët që do përbëjnë « motorin » e ekonomisë shqiptare në vitet në vazhdim?

Do të vendoset një dialog i përhershëm me komunitetin e sipërmarrjes, vendas dhe të huaj, si dhe me ekspertizë të spikatur të huaj dhe vendase. Ky dialog do të institucionalizohet në ngritjen dhe funksionimin e Këshillit Ekonomik Kombëtar, i cili do të operojë pranë kryeministrit.

• Sektorët prioritarë

Ne jemi të qartë në objektivat themelore të zhvillimit dhe modelit të rritjes ekonomike për 15-20 vitet në vazhdim. Do të ndërtojmë “profilin” e ekonomisë shqiptare të dy dekadave në vazhdim, të identifikuar nëpërmjet disa sektorëve prioritarë si manifaktura, energjia, turizmi, bujqësia dhe agroindustria, arsimit dhe shërbimet.

Ndodhemi në një moment thelbësor për të saktësuar një koncept e një politikë të qartë për modelin e rritjes ekonomike dhe faktorët jetësorë të saj. Mbyllja e “periudhës 22-vjeçare të tranzicionit” dhe kriza ekonomiko-financiare na ka vënë përballë një fakti të pakundërshtueshëm. Modeli i deritashëm i rritjes ekonomike në Shqipëri (i mbështetur kryesisht në të ardhurat nga emigracioni, donacionet si vend i varfër e në zhvillim që kemi përfituar me shumicë, kreditë e buta dhe ndihmën e huaj që kanë qenë një



arterie e rëndësishme që furnizonte rregullisht ekonominë tonë, privatizimet masive që i kanë krijuar buxheteve tona luksin e të qenit në ekuilibër dhe me deficit minimal, vetëpunësimi kryesisht bujqësor, “boom-i” mbi 15-vjeçar i sektorit të ndërtimit, shkarkimi i papunësisë nëpërmjet emigracionit, etj.), duket se po shkon drejt shterimit total ose të pjesshëm. Edhe politikat 22-vjeçare me prioritet “ruajtjen e ekuilibrave makroekonomikë” duke krijuar mundësi për rritjen ekonomike, duket se nuk mund të jenë më të vetmet.

Do të bëjmë politika më të strukturuar, të mirëadresuar e të gjera për nxitjen maksimale të rritjes ekonomike, për garantimin faktorial të qëndrueshmërisë së saj, për rritjen e prodhimit vendas dhe eksporteve, për hapjen masive të vendeve të reja të punës.

Do të identifikojmë qartë faktorët e rinj të rritjes ekonomike që me anë të mbështetjes së sektorëve prioritarë dhe politikave e masave specifike t'i kthejmë në avantazhe konkurruese.

• Strategjia për rritjen ekonomike

Rritja ekonomike për një vend si Shqipëria mund të vazhdojë të nxitet në tre mënyra:

1. Nëpërmjet borxheve dhe kredive nga jashtë;
2. Nëpërmjet eksporteve të lëndëve të para, të disa produkteve të gatshme dhe një kategorie të caktuar shërbimesh;
3. Nëpërmjet ristrukturimit ekonomik dhe reformave të vërteta strukturore, rritjes me prioritet të prodhimit të brendshëm, diversifikimit të produkteve dhe shërbimeve, adoptimit masiv të teknologjive të reja.

Dy mënyrat e para ne i gjykojmë se janë me nivel të lartë risku dhe jo të qëndrueshme. Ta mbështetësh rritjen vetëm tek investimet apo kreditë e huaja, gjë që na ka pëlqyer ta përmendim si “kulmin e suksesit të çdo qeverie” do të thotë:

- të ushqesh iluzionin e një jetese dhe zhvillimi përtej mundësive të tua konkrete,
- të jesh i varur shumë nga flukset, “devijimet” dhe “kapriçot” e shpeshta të tregjeve financiare ndërkombëtare,
- të prodhosh një rritje ekonomike jo reale, të mbështetur në monedha të fuqishme e të mbivlerësuara, të cilat sintetizojnë një strukturë

ekonomike e konsumi larg realitetit tonë.

Në kushtet kur borxhi publik në Shqipëri është në nivelet 64% e PBB dhe me tendencë rritjeje, kur deficit buxhetor është gjithashtu në tendencë rritjeje, mundësitë për ta konsideruar këtë rrugë janë të vogla. Aq më tepër që aktualisht, sfida dhe frika e çdo qeverie në botë është “tejkalmi i borxhit publik”. Edhe rritja ekonomike e bazuar ekskluzivisht tek lëndët e para dhe eksporti i tyre, apo “eksporti i krahut të punës” vlerësohet si jo e qëndrueshme në periudha afatmesme e afatgjata, sidomos për shkak të fluaktuacioneve të mëdha të çmimeve të tyre në tregjet ndërkombëtare dhe luhatjeve që pëson ky sektor nga evolucionet gjeopolitike, rajonale e ndërkombëtare.

Mënyra e tretë, që sipas shumë shembujve pozitivë në botë, ka prodhuar një rritje konstante afatgjatë është “promovimi i produkteve të përpunuara dhe ofrimi i shërbimeve moderne”. Duke parë zgjerimin e tregjeve ndërkombëtare dhe kërkesës për produkte të përpunuara si dhe efektet pozitive që ato japin në rritjen e punësimit të brendshëm, duhet që Shqipëria të bëjë politika specifike rritjeje ekonomike me këtë fokus. Kryefjala mbetet “rritja e prodhimit të brendshëm dhe shtimi i eksporteve”, shtimi i PBB nga prodhimi dhe jo nga konsumi siç ka qenë modeli dominues i deritashëm.

• Prodhimi vendas dhe nxitja e eksporteve

Meqenëse duam të nxisim rritjen ekonomike afatgjatë, duhet të mos mbetemi vetëm tek “politikat fundamentale” të programeve të ndreqjeve e përshtatjeve strukturore (si p.sh. stabiliteti makroekonomik, thellimi i privatizimeve, hapja e liberalizimi ekonomik), por:

- të fokusohemi maksimalisht drejt politikave prodhuese e sidomos politikave energjetike, industriale dhe agrare,
- të ndërtojmë politika specifike për mbështetjen dhe nxitjen e eksporteve;
- të jemi të kujdesshëm me stabilitetin financiar,
- të jemi maksimalisht të prirur për futjen masive të inovacioneve dhe teknologjive të reja në të gjithë sektorët e ekonomisë dhe të biznesit tonë,
- të kemi realisht në fokus zgjerimin e kapitalit



human dhe përfshirjen sa më të gjerë të popullsisë aktive të territorit në “kontributin dhe përfitimet nga/për rritjen ekonomike”.

Rritja ekonomike që ekziston në një terren ekonomiko-financiar, të dominuar nga deficit i bilancit të pagesave, deficit i konsiderueshëm tregtar, tregu ushqimor i varur dukshëm nga importet, nxitja subjektive e kërkesës së brendshme, mospërfshirja e gjerë e grupeve të ndryshme sociale dhe tërësia territoriale në kontributin e përfitimet nga rritja, nuk vlerësohet si rritje ekonomike e qëndrueshme dhe efikase. Kolona vertebrale e këtij ndryshimi duhet të jetë biznesi privat, ristrukturimi dhe modernizimi i tij.

Ne jemi të bindur se kaq nuk mjafton. Shqetësuese në mjaft raste është “cilësia” e biznesit, është brishtësia dhe “amatorizmi” i tij, është informaliteti i lartë. Në gjuhën e politikave ekonomike ne do ta përkthejmë këtë si “domosdoshmëri akute për politika që zhvillojnë, zgjerojnë dhe konsolidojnë biznesin” dhe jo thjesht “përmirësimi i klimës së biznesit”.

• Mbështetje për biznesin e vogël e të mesëm

- Do të thellojmë reformën rregullatore për reduktimin në maksimum të barrierave administrative dhe kostot e biznesit, për eliminimin e informalitetit dhe korrupsionit;
- Do të punojmë për thellimin e lirisë së tregut, garantimin e konkurrencës së ndershme dhe eliminimin e monopoleve;
- Do të hiqet taksa e biznesit të vogël dhe do të reduktohet barra fiskale e biznesit të vogël brenda vitit të ardhshëm;
- Do të rrisim efikasitetin e shërbimeve të administratës publike në favor të biznesit të vogël e të mesëm duke krijuar një partneritet të qëndrueshëm e të suksesshëm shtet-biznes;
- Do të përputhim plotësisht politikatat tona të zhvillimit të biznesit të vogël e të mesëm me politikën evropiane për ndërmarrjet e vogla e të mesme me theks të veçantë në rritjen e konkurrueshmërisë dhe të punësimit;
- Do të nxitim dhe mbështetim kulturën moderne të sipërmarrjes për biznesin, me theks të veçantë përmirësimin e menaxhimit,

kualifikimin e punonjësve, standardet e cilësisë dhe konkurrueshmërinë, thithjen e investimeve, thellimin e inovacioneve dhe teknologjitë e reja, etj.

• Sektori financiar

Shumicën dërrmuese të sektorit financiar në Shqipëri e dominon sektori bankar. Madhësia e sektorit bankar ka rreth një vit e gjysmë që është në nivelin rreth 12 miliardë dollarë (me rritje dhe rënie të ulëta momentale). Nga këto, rreth 5.4 miliardë dollarë janë të huaja e i janë dhënë biznesit dhe individëve. Ky nivel huaje ka rreth 2 vite që nuk ndryshon, duke rezultuar në një bllokim thuajse tërësor të kreditimit. Faktorët kryesorë ndikues përfshijnë, në njërin anë, mungesën e kërkesës së shëndoshë nga biznesi dhe individët dhe nga ana tjetër, kujdesin më të lartë të sektorit bankar ndaj rrezikut të moskthimit të kredisë. Cilësia e portofolit të kredive është përkeqësuar; kreditë me probleme zënë afro 25% të portofolit të kredive.

Ndërsa për sektorin bankar mund të themi që nuk po financon sa duhet ekonominë me kredi të reja edhe pse në kushte të kënaqshme të likuiditetit dhe kapitalizimit, për institucionet e tjera financiare, tregu kërkon përmirësim të ndjeshëm, si nga pikëpamja rregullative, mbikëqyrëse ashtu edhe në sasinë e cilësinë e shërbimeve.

Angazhimi ynë për të mbështetur zhvillimin e institucioneve financiare kredidhënëse, institucioneve të tjera financiare jobanka dhe krijimin e një banke në dobi të zhvillimit bujqësor, do të shoqërohen nga reforma e ristrukturimit të sistemit financiar, duke krijuar një institucion mbikëqyrës për të gjithë sistemin financiar. Mbështetje funksionimit të sistemit shumëkolonësh të pensioneve, duke nxitur sidomos për brezin e ri, pjesëmarrjen edhe në skemat private, suplementare e vullnetare të pensioneve. Zgjerim dhe thellim të tregut financiar me njësi e produkte të reja dhe aktivizim real të ekzistuesve, sidomos të tregut sekondar të letrave me vlerë të Qeverisë etj. Zhvillime më cilësore do të synohen edhe në tregun e sigurimeve.



• Rregullimi dhe mbikëqyrja e tregjeve

Monopolet sundojnë furnizimin dhe tregtimin e disa mallrave të domosdoshëm për shqiptarët dhe ekonominë tonë si gruri, sheqeri, orizi, vaji, barnat, karburantet, çimento, hekuri. Të kontrolluara janë edhe tregjet e shërbimeve të telekomunikacionit dhe të tregtimit të titujve financiarë, të lëshuar nga Qeveria e Shqipërisë. Ndryshimet e çmimeve në tregjet ndërkombëtare pasqyrohen në tregun vendas vetëm përmes rritjes së çmimeve me shumicë. Autoritetet rregullatore janë të pafuqishme dhe në më të shumtën e rasteve nuk kanë për qëllim të nxitin konkurrencën e ndershme, as edhe kur konstatojnë prezencën e monopoleve. Qeveria e sotme e ka orientuar me qëllim punën e këtyre autoriteteve vetëm drejt kapjes së “peshqve të vegjël”.

Qeveria i ka shtrirë monopolet edhe në shfrytëzimin e pasurive natyrore të vendit, duke vënë shumë të mira publike në shërbim të një pakice sipërmarrësish, ngushtësisht të lidhur përmes interesave politike dhe financiare me familjen në pushtet. Shumë projekte koncesionare kanë injoruar në mënyrë të plotë impaktin në mjedis, duke instaluar një sistem, ku për fat të keq, avantazhi konkurrues që ofron Shqipëria e sotme është dumpingu mjedisor. Ky sistem do të thotë përfitim përmes shkatërrimit.

Do të punojmë për një funksionim sa më transparent e efikas të tregjeve në të gjithë sektorët e ekonomisë.

Me masa e politika konkrete, do të nxitim e mbështetim lirinë e tregjeve, eliminimin e monopoleve dhe informalitetin, si dhe çdo formë tjetër që cënon funksionimin normal të tregjeve.

Do rritim në maksimum efikasitetin e masave dhe strukturave të mbikëqyrjes së tregjeve.

Do të përmirësojmë rrënjësisht mënyrën e organizimit dhe funksionimit të enteve të ndryshme rregullatore në funksion të rregullimit dhe mbikëqyrjes së tregjeve.

• Partneriteti publik-privat

Partneriteti publik-privat vlerësohet si një marrëdhënie efikase bashkëpunimi mes dy sektorëve, e cila në shtete të ndryshme të zhvilluara apo në zhvillim të shpejtë ka dhënë rezultate mbresëlënëse.

Ndryshimet ligjore të viteve të fundit që synonin të nxitnin partneritetin publik-privat, janë kompromentuar nga mbizotërimi i tejskajshëm i “koncesionit të pakërkuar”. Përdorimi në mënyrë të mbrapshtë i kësaj forme koncesionare të partneritetit publik-privat rrezikon të ardhmen e pasurive nëntokësore minerare, burimeve ujore, të drejtave publike mbi frekuenca numerike televizive e të telekomunikacionit, të avantazheve që ofron relievi, klima dhe pozicioni gjeografik i vendit.

Partneriteti publik-privat nuk do të konsiderohet si privatizim, shitje, kalim i pronësisë apo ndonjë formë tjetër e kësaj natyre, por si bashkëpunim ndërmjet dy sektorëve për të investuar në sektorë të ndryshëm të ekonomisë, në infrastrukturë, energji, mjedis dhe shërbime publike.

Do të punojmë që Shteti dhe sektori privat të ndërgjegjësohen maksimalisht për nxitjen dhe zgjerimin e këtij modeli.

Do ta konsiderojmë PPP si një politikë specifike dhe efikase për tërheqjen e kapitalit privat në ekonomi.

Do të ndërmerren masa e politika specifike për një promovim sa më të plotë të PPP në Shqipëri.

• Zhvillimi ekonomik dhe kultura e re politike

Ne do të punojmë për krijimin e një kulture të re politike, të orientuar nga konsensusi dhe qëndrueshmëria kur është fjala për:

- prioritetet strategjike dhe politikat thelbësore strukturore të zhvillimit,
- reformimin institucional të politikës dhe ekonomisë së orientuar nga respektimi i kulturës së konsensusit dhe ligjit,



- konsolidimin e rregullave bazë të tregut të punës dhe konkurrencës në sensin e privilegjimit të “tregjeve të koordinuara” në raport me “tregjet tërësisht të liberalizuara”,
- fiksimin e nivelit të mbrojtjes sociale,
- raportet ndërmjet bankave dhe tregut financiar në financimin e ekonomisë dhe zhvillimit, në mënyrë që të pershtatet sa më mirë dhe vetë biznesi,
- raportet ndërmjet modelit të kapitalizmit dhe “fuqisë ndryshuese” apo dhe përmbysjes së këtij modeli nga qeverisja,
- “specializimin” e sistemit arsimor, edukativ në funksion të modelit të zhvillimit, etj.

• Politika fiskale

Baza e politikës fiskale do të jetë taksimi i ndershëm. Zhvendosja nga politika e taksimit të sheshtë, drejt politikës së taksimit progresiv, ku “kush përfiton më shumë, të kontribuojë më shumë”, do të jetë lëvizja më e rëndësishme për të filluar një fazë të re të vendosjes së marrëdhënieve midis tatimpaguesve dhe tatimbledhësve, të një politike tërësisht transparente dhe në harmonizim të interesave të grupeve me të ardhura të ndryshme me ato të shoqërisë në tërësi, të stabilizimit e përmirësimit të politikave fiskale në papajtueshmëri me arbitrarizmin dhe arrogancën e punonjësve të administratës fiskale. Politika fiskale do të garantojë respektimin e deficitit buxhetor për të siguruar kontrollin e borxhit dhe sjelljen e tij në nivelin e pranueshëm për një vend në zhvillim, që nuk rrezikon zhvillimin dhe stabilitetin afatgjatë. Pra, politika fiskale që prodhonnë më shumë qëndrueshmëri fiskale. Kjo politikë do të ketë në fokus rritjen e efikasitetit të shpenzimeve publike, prioritarizimin e shpenzimeve me efekte sa më të gjera dhe të shpejta, hapjen e perspektivave të reja për investime nga sektori privat, të prirura nga përfitime e rritje ekonomike, dhe punësimi.

Politika fiskale që do të zbatohet nga qeverisja jonë ka si pikësynim të mbështesë zhvillimin ekonomik dhe të rrisë punësimin. Objektivat dhe mbështetësit e politikave afatmesme do t'i orientojmë:

- për përmirësimin e klimës së biznesit,
- për uljen e taksave dhe thjeshtimin e sistemit

tatimor e fiskal,

- për lehtësimin e presionit fiskal,
- për konsolidimin e biznesit dhe krijimin e një “kolone vertebrale” të qëndrueshme e të strukturuar të biznesit shqiptar e cila do të përbëjë dhe skeletin bazë të ekonomisë së qëndrueshme shqiptare, etj.
- për pagimin e borxheve publike ndaj bizneseve për shërbime apo kontrata të realizuara;
- për realizimin e pagesave të TVSH-së së rimbursueshme të papaguar;
- për nxitjen e investimeve të brendshme dhe të huaja në sektorin privat dhe zhvillimin e vendit.

• Mbrojtja e konsumatorit

Në situatën e rënieve ekonomike, një kuadër i fortë ligjor për konsumatorët dhe zbatueshmëria e tij merr një vlerë të shtuar, sepse krizat çojnë në rritjen e vulnerabilitetit të konsumatorëve dhe një zbatueshmëri efektive e kuadrit ligjor, rrit besimin e tyre në treg. Kjo sjell rritjen e blerjeve që është motori për rigjenerimin e ekonomisë.

Të drejtat e konsumatorëve të shprehura në një kuadër të shëndetshëm ligjor, përkthehen në detyrime për operatorët ekonomike, të cilët duhet të operojnë në një fushë me të njëjtat rregulla loje, gjë që rrit drejtpërsëdrejti konkurrencën e ndershme, hapjen e tregut dhe rritjen e punësimit dhe nxit mallra dhe shërbime më cilësore dhe me çmime konkurruese për konsumatorët.

Për të mundur një mbrojtje sa më të mirë të të drejtave të konsumatorëve do të ngrihet dhe do të funksionojë Inspektoriati i Mbikëqyrjes së Tregut, i mirëorganizuar dhe i pajisur me burimet e domosdoshme njerëzore dhe financiare, i cili duhet të maksimizojë efektin e aktiviteteve të tij zbatuese, për të garantuar një nivel të kënaqshëm të sigurisë së produkteve në treg, dhe për të ndihmuar në funksionimin e një tregu të lirë konkurrues.

Do të fuqizohet më tej Komisioni për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe rifreskimi i tij për shmangien e situatave problematike të vërejtura vitet e fundit.

Ministria përgjegjëse për tregëtinë do të realizojë koordinim më të mirë të të gjithë politikave ndërsektoriale në mbrojtjen e konsumatorëve.



Punësimi

Të dhënat vërtetojnë pohimin e pakundërshtueshëm se në Shqipëri janë 1 milion të papunë. Sipas të dhënave zyrtare në Shqipëri në 2013-s, ka më shumë se 51 mijë vetë më pak të punësuar se në vitin 2008. Rritja ekonomike relativisht e qëndrueshme e periudhës 2000-2008 nuk u shoqërua me rritje të punësimit, zvogëlim të ekonomisë joformale dhe zhvillim të kapitalit njerëzor. Qeveria e re do ta ndryshojë këtë tablo, duke ndryshuar strukturën e ekonomisë, nga një ekonomi e bazuar tek konsumi i mallrave të importuara, emigracioni e informaliteti në një ekonomi që bazohet tek puna dhe rritja e produktivitetit.

Angazhohemi të krijojmë 300 mijë vende të reja pune. 40 mijë vende të reja pune në industrinë prodhuese dhe 12 mijë vende pune shoqëruese të lidhura me to, 15 mijë në industrinë e lidhura me detin, 155 mijë në aktivitetet e lidhura me bujqësinë e blegtorinë, 62 mijë përmes reformimit të programit të ndihmës ekonomike, 11 mijë vende pune në industrinë e turizmit dhe 4 mijë vende të reja pune në teknologjinë e informacionit.

Riorientim tërësor i arsimit profesional drejt nevojave reale të tregut dhe kthim i shtetit në financuesin e mbështetësin kryesor të aftësisë profesionale. Sistemi mbi të cilin kjo reformë do të bazohet është sistemi dual gjerman që karakterizohet nga një ndërthurje e mësimi teorik me punë praktike. Gjithashtu, kurset dhe arsimi profesional do të zgjerohen edhe në zonat rurale për t'i dhënë nxitjen e nevojshme industrisë agro-përpunuese.

Do të trajnohen me përparësi të gjithë punëkërkuarit e regjistruar nën moshën 25-vjeçare. Po ashtu edhe të gjitha grave dhe vajzave të regjistruara si punëkërkuese do t'u ofrohet trajnim brenda një viti dhe brenda dy-vjeçarit të parë të të gjithë punëkërkuarëve të regjistruar.

Në bashkëpunim me sektorin privat në partneritete publike-private do të krijojmë shkollat e larta të arsimit profesional.

Do të ndërtojmë Agjencinë Kombëtare të

Punësimit, si një njësi me buxhet dhe administrim autonom, e cila do të do mbledhë në një dhe do të rikonceptojë sipas praktikave më të mira modernizimin e zyrave të punës, sistemin e sigurimeve të punësimit, programin e nxitjes së punësimit dhe trajnimet profesionale.

Do të rinisim dialogun e munguar prej kohësh me sindikatat për të rikthyer kulturën tripartite mes shtetit, punëdhënësve e punëmarrësve, çka do të rijetësojë edhe Këshillin Kombëtar të Punës si një instrument themelor në hartimin e politikave të punësimit, pagave e përfitimeve sociale.

Angazhohemi të përgjysmojmë papunësinë e regjistruar femërore dhe të rritim aksesin e Personave me Aftësi të Kufizuar në punësim, përmes programeve dhe kurseve kualifikuese të përshtatura për personat me aftësi të kufizuara.

Burimet natyrore

• Prodhimi i energjisë

Sistemi Elektroenergjetik i Shqipërisë (SESH) trashëgon një sërë problemesh e sfidash me natyrë strategjike, tekniko-teknologjike e operacionale, tregtare e financiare që jo vetëm kanë vënë në rrezik zhvillimin e funksionimit normal të vetë SESH, integrimin e tij në sistemet rajonale të energjisë dhe investimet e reja për prodhimin e energjisë elektrike, por e kanë kthyer sektorin në pengesë serioze për një zhvillim ekonomik të lartë dhe të qëndrueshëm të Shqipërisë.

Kjo gjendje e SESH manifestohet në :

- paqartësitë dhe subjektivizmin e theksuar në strategjitë e zhvillimit dhe reformat e domosdoshme strukturore të sektorit,
- zhbalancimin e kërkesës për energji elektrike dhe ofertës së prodhimit të energjisë elektrike nga burimet brenda vendit,
- humbjet e larta teknike dhe joteknike të energjisë elektrike,
- nivelin e ulët të arkëtimit të faturave të energjisë elektrike,
- treguesit cilësorë nën standardet tekniko-ekonomike të energjisë elektrike të furnizuar tek



konsumatori,

- mungesën e furnizimit të pandërprerë me energji elektrike të konsumatorëve,
- mosmarrjen e statusit të antarësisë në Tregun Rajonal të Energjisë,
- privatizimin e dështuar të sistemit të shpërndarjes së energjisë,
- kaosin juridik dhe financiar që e shoqëron SESH, duke e bërë sektorin e energjisë të ndodhet në prag të kolapsit financiar.

Qeveria do të synojë hartimin e një strategjie afatgjatë dhe efikase për sistemin elektro-energjistik të Shqipërisë, me qëllim krijimin e një Sistemi Elektroenergjetik të qëndrueshëm operacionalisht, teknikisht dhe financiarisht, të aftë për të plotësuar kërkesën në rritje për energji elektrike brenda vendit duke e shndërruar Shqipërinë nga vend importues i energjisë elektrike, në vend eksportues të saj.

Njëherazi synohet rritja e efikasitetit në përdorimin e energjisë elektrike në sektorë të ndryshëm të ekonomisë, shërbime dhe përdorim individual e ulja e humbjeve teknike dhe joteknike në shpërndarjen e energjisë elektrike.

Qeveria synon integrimin e Sistemit Elektroenergjetik Shqiptar (SESH) me Sistemet Rajonale dhe Evropiane të energjisë elektrike, si dhe rritjen e bashkëpunimit midis dy sistemeve elektroenergjetike Shqipëri-Kosovë, duke mundësuar shfrytëzimin me efikasitet të lartë të burimeve energjetike të të dy vendeve.

Do të kryhet një reforme legislative - strukturore në SESH dhe në tregun e energjisë elektrike, duke plotësuar kushtet për liberalizimin e shitjes së energjisë elektrike në përputhje me standardet e Bashkimit Evropian.

Do të rritet pavarësia e Institucionit Rregullator, duke garantuar ushtrimin e kompetencave të këtij institucioni në mënyrë të paanshme dhe transparente, për të qënë gardian i interesave publike, konkurrencës së lirë e të ndershme dhe transparencës.

Do të vihen nën monitorim të plotë të veprimtarisë, sektori i prodhimit të energjisë elektrike dhe i investimeve për ndërtimin e

burimeve të reja prodhuese të energjisë elektrike. Do të krijohet ambienti ekonomiko-ligjor që siguron një zhvillim të qëndrueshëm të sektorit dhe do të futet një kulture e re në kuadrin e ekonomisë së energjisë dhe përdorimin efikas të saj në ekonomi dhe në konsum familjar.

Qeveria do të kujdeset në harmonizimin sa më të mirë të zhvillimit dhe të investimeve në sektorin elektroenergjistik me ruajtjen e mjedisit dhe burimeve natyrore.

• Hidrokarburet

Sektori i hidrokarbureve karakterizohet nga këto veprimtari jashtë monitorimit efikas shtetëror në sektorin e prodhimit të naftës e të gazit, duke dëmtuar interesin publik dhe të ardhurat në buxhetin e shtetit.

Tregu i importit dhe i shitjes me shumicë të hidrokarbureve është nën tryshninë e situatës monopol. Veprimtaria e tregut për shitjen me shumicë dhe pakicë të hidrokarbureve kryhet në mungesë transparence për institucionet shtetërore dhe për publikun, duke dëmtuar rëndë interesat publike dhe private.

Plotësimi i kërkesës për hidrokarbure dhe lëndë energjetike hidrokrabure bëhet pothuajse tërësisht nga importi, kur Shqipëria është vend prodhues i naftës bruto, mospërpunimi i së cilës cënon interesin publik e privat në vend.

Qeveria do të synojë hartimin e një strategjie afatgjatë dhe efikase për sektorin e hidrokarbureve në Shqipëri, vënie nën një monitorim të plotë të veprimtarisë në sektorin e hidrokarbureve për të patur një zhvillim të qëndrueshëm të sektorit, duke garantuar interesat publike në këtë sektor, forcimin e kapaciteteve shkencore dhe teknike në funksion të zhvillimit të sektorit hidrokarbur sot e në perspektivë.

Tregu i karburanteve dhe gazit të lëngët do të zhvillohet me standarde teknike cilësore, në nivelin e vendeve evropiane, duke prishur monopolet e krijuara në këtë treg.

Do të nxitim përpunimin e naftës bruto brenda vendit.



Do propozojmë ndryshime ligjore dhe institucionale të domosdoshme, si dhe një paketë masash nxitëse e stimuluese për përdorimin efikas të gazit në ekonomi, shërbime dhe përdorim individual në Shqipëri, në dekadën e ardhshme.

Do të sigurohet mbështetje për zbatimin e politikave efektive për të mbështetur ndërtimin e Gazsjellsit TAP, duke realizuar përfitimet maksimale prej këtij projekti, përfshirë dhe mundësinë e shtritjes në tregun e brendshëm.

• Minerale

Sektori i industrisë minerare karakterizohet nga veprimtari jashtë monitorimit shtetëror të aktivitetit në sektorin minerar, duke dëmtuar imazhin mirëqeverisës dhe seriozitetin e shtetit, madje edhe nga veprimtari të jashtëligjshme që dëmtojnë rëndë interesin publik.

Puna në miniera kryhet jashtë rregullave dhe standardeve për sigurinë në punë, duke dëmtuar shëndetin e punonjësve, si dhe duke marrë jetë njerëzish në punët e rënda nën e mbi tokë. Shkalla e përpunimit të mineraleve vazhdon të jetë mjaft e ulët dhe eksportet janë kryesisht në mineral bruto, duke dëmtuar interesin publik.

Investimet në sektorin minerar janë pothuajse inekzistente, duke bërë që ky sektor të ketë sot një prapambetje teknike e teknologjike kolosale, çka reflektohet në produktivitetin minimal të tij.

Qeveria do të synojë:

- Zhvillimin dhe modernizimin e mëtejshëm të sektorit të gjeologjisë dhe minierave duke e shndërruar këtë sektor në një industri me kushte e standarde bashkëkohore.
- Hartimin e politikave specifike që nxisin, orientojnë dhe garantojnë investime e financime masive të brendshme e të huaja në industrinë minerare.
- Ndërmarrjen e masave ligjore dhe strukturore për të mundësuar rritjen e shkallës së pasurimit dhe përpunimit të mineraleve në vend.
- Rritjen e eksporteve minerare si një element i rëndësishëm i rritjes ekonomike, punësimit dhe nivelit të jetesës në zonat minerare.
- Monitorimin e veprimtarisë minerare me synim

garantimin e interesit publik në këtë sektor.

Do të kryejmë ndërprerjen e menjëhershme të veprimtarive minerare të rrezikshme dhe të jashtëligjshme e ndërprerjen e veprimtarive minerare që nuk kanë respektuar detyrimet kontraktuale, që kanë dëmtuar e dëmtojnë rëndë mjedisin, sidomos të atyre veprimtarive pranë zonave urbane.

• Pyjet

Sipërfaqet me bimësi pyjore dhe kullotat mbulojnë rreth 60% të territorit të vendit por në 20 vitet e fundit përlogariten rreth 100,000 ha pyje të shkatërruar. Humbja e sipërfaqes në pyje është shoqëruar me fenomene të tjera si erozioni, humbja e habitateve për faunën e egër, rrëshqitjet e tokës, etj.

Për të ndryshuar situatën, qeveria, fillimisht do të ndalojë për një periudhë të caktuar eksportin e lëndës drusore të papërpunuar, të druve të zjarrit dhe qymyrit të drurit, duke synuar të ulim me 30% prerjen e drurëve në pyje.

Do të hartohet e miratohet strategjia kombëtare për menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve pyjore. Kompanitë që marrin lejet për shfrytëzimin e pyjeve do të kenë edhe përgjegjësinë e mirëmbajtjes së tyre, duke mbjellë një fidan për çdo dru të prerë.

Do të kryhet riinventarizimi kombëtar i pyjeve, duke mundësuar krijimin e një kadastrë të re të pyjeve.

Do të hartohet një program kombëtar për pyllëzimet si dhe do të organizohet dita kombëtare e mbjelljeve në pyje.

Do të forcohet shërbimi i ekstensionit, me qëllim asistimin e komunitetit dhe pushtetit vendor në politikëbërjen dhe menaxhimin e zonave pyjore.

Do të hartojë një program të ri investimesh me qëllim rehabilitimin e shpejtë të zonave pyjore me vlerë kombëtare si Lura, Qafshatama etj.



Zhvillimi urban, rural dhe rajonal

• Planifikimi dhe zhvillimi i territorit

Qeveria synon të mbyllë përfundimisht epokën e informalitetit në zhvillimin e tokës, territorit, hapësirave urbane e rurale dhe të krijojë një mjedis institucional, ekonomik e social për zhvillimin e qëndrueshëm të territorit.

Do të garantohet transparencë në planifikimin dhe zhvillimin e territorit, si dhe në proceset ligjore që rregullojnë planifikimin e zhvillimin.

Do të garnatohet që *“ekuilibri midis interesave publike dhe private”* në zhvillimin e tokës, si dhe interpretimi dhe administrimi i saktë i të *“drejtës së zhvillimit”*, të jenë pjesë integrale të mendësisë dhe realitetit të zbatimit.

Për të realizuar këto objektiva, do të zbatohen një seri politikash e do të ndërmerren një sërë masash që konsistojnë, në nisjen e punës për hartimin dhe miratimin e Planit të Përgjithshëm Kombëtar si përkthim i strategjisë kombëtare të zhvillimit në territor dhe bazë për zhvillimin e qëndrueshëm, investimet dhe kontrollin e territorit. Miratimi i planit, do të paraprihet nga miratimi i Zonave të Rëndësishme Kombëtare, mbi bazën e së cilave do të vendosen 3 Moratoriume të rëndësishme për ndalimin e aktivitetit ndërtimor në Bregdet, në burime pyjore dhe sipërfaqe ujore e në të gjitha zonat me rëndësi për Turizmin.

Do të vlerësohet informaliteti në territor, do të krijohet baza e integruar e të dhënave për territorin dhe do të ndërmerret procesi i legalizimit dhe integritetit të vendbanimeve informale, për t'i dhënë fund veprimeve të paligjshme.

Do të shpallet Momenti ZERO, pas të cilit çdo ndërtim është subjekt prishjeje të menjëhershme.

Qeveria do të realizojë pa pagesë legalizimin e banesave pa leje në zonat informale.

Do të hartojmë dhe zbatojmë Programin për Bregdetin e Jonit që konsiston në pastrimin e territorit nga informaliteti dhe keqpërdorimi e do të paraqesë modelet e para të rigjenerimit të qëndrueshëm të hapësirave urbane dhe natyrore

me potencial turistik.

Do të rritim standardet e zhvillimit të tokës në bregdet dhe do të evidentojmë rrjetin ekologjik.

Do të ndërmarrim një program të thellë reformues për Rigjenerimin Urban dhe Zhvillimin cilësor të Tokës përmes projektsh-pilot për qendrat urbane, por edhe përmes mbështetjes së projekteve dhe agjendave të zhvillimit të lagjeve, mbi baza konkurruese.

Do të mbështetim pushtetin vendor, që të marrë rolin udhëheqës në zhvillimin e tokës, duke mbrojtur zonat natyrore, historike dhe bujqësore, për të garantuar partneritet publik e privat në financimin e infrastrukturave dhe shërbimeve e duke administruar shpërndarjen e së drejtës së zhvillimit.

Do të percaktohen tiparet arkitekturore dhe urbanistike tradicionale të zonave dhe fshatrave e qendrave të banuara, veçanërisht në zonat turistike.

• Turizmi

Turizimi është një sektor prioritar i zhvillimit të ekonomisë së vendit, i rritjes së prodhimit dhe zbutjes së varfërisë.

Zhvillimi i turizmit do të jetë pjesë e zhvillimit të qëndrueshëm, me potencial të madh rritjeje, por me një avitje të integruar dhe plotësuese ndërsektoriale, që menaxhon burimet në mënyrë të balancuar, gjeneron zhvillim ekonomik dhe garanton punësim.

Në synojmë të vendosim Shqipërinë si një destinacion të preferuar në ofertën mesdhetare të tregjeve ndërkombëtare të turizmit, duke krijuar një imazh të ri për Shqipërinë turistike, duke shfrytëzuar potenciale dhe burime vendore, duke u fokusuar në atë çka është unike në Shqipëri dhe duke ofruar shërbim në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Krijimi i një modeli turizmi vjetor të integruar, aktiv dhe social, me fokus në dimensionin kulturor-natyror-ekologjik dhe si një kombinim



midis turizmit familjar dhe elitar.

Hartimin dhe zbatimin e Strategjisë së Turizmit, në përputhje me strategjinë kombëtare të zhvillimit dhe me Planin Kombëtar të Territorit.

Realizimin në mënyrë të pandërprerë të një fushate informuese dhe promovuese për imazhin e Shqipërisë turistike. Rol të rëndësishëm do të kenë jo vetëm institucionet publike, por edhe operatorët e industrisë dhe të gjithë agjentët e zhvillimit në vend, përfshirë median, shoqërinë civile, por edhe sistemin e shërbimit diplomatik.

Do të formalizojmë dhe standardizojmë tregun e hotelarisë.

Do të krijojmë bazën e integruar të informacionit për turizmin, përfshirë operatorët, strukturat dhe sitet turistike dhe do të ndërmerim një reformë fiskale që synon reduktimin e TVSH-së për operatorët turistikë.

Do të krijojmë një paketë të veçantë turistike Shqipëri-Kosovë-Rajon, si bashkëpunim mes vendeve me popullsi shqiptare dhe fqinjëve në rajon, me qëllim kontributin në zhvillimin ekonomik të integruar.

Në përputhje me modelin e Turizmit, do të krijojmë tre programe kyç:

Programi për Turizmin Kulturoroh-Historik, që fokusohet në zonat e mbrojtura dhe monumentet e kulturës; promovon traditat shqiptare; adreson veçanërisht turizmin e bazuar në ekonomitë familjare dhe biznesin e vogël, në bashkëpunim me operatorët e turizmit elitar.

Programi për Eko-Turizëm që ndërton mbi burimet natyrore, përdorimin ekologjik të tyre dhe pajisjen me infrastruktura dhe shërbime bazike, sigurinë e lartë dhe guida të përsosura profesionalisht.

Programi për Turizmin Malor dhe Bregdetar, i cili shoqërohet me projekte madhore të investimeve kapitale për infrastruktura dhe shërbime, veçanërisht afër qendrave të banuara dhe përmes praktikave të partneritetit-publik-privat.

Përmes planifikimit rajonal, do të realizojmë dy programe të rëndësishme, *Programin e 10*

Poleve Turistike të Shqipërisë dhe Programin e fashës rajonale "Korridori i Kaltër", nga veriu në jug. Për këto programe, në përputhje me Planin Kombëtar, do të hartohen vizione zhvillimi dhe plane të investimeve kapitale; do të krijohen dhe rigjenerohen nje atraktive, gjeneruese të punësimit, të clusterave të turizmit dhe të aktiviteteve të specializuara. Do të konsolidohen qendrat urbane të fashës dhe të poleve.

• Bujqësia

Ekonomia bujqësore vazhdon të jetë një veprimtari ekonomike e rëndësishme (me mbi 18% të Prodhimit të Brendshëm Bruto). Reforma 20-vjeçare e sektorit të bujqësisë ka mbetur në një strukturë shumë të vogël të ekonomive bujqësore, më pak se 2 hektarë/ferma.

Shqipëria vazhdon të jetë një vend neto importues agrar, me 7 herë më shumë importe sesa eksporte, dëshmi kjo për vështirësi në rritjen e konkurrencës së sektorit bujqësor e ushqimor vendas. Prandaj nxitja e prodhimit bujqësor, nëpërmjet uljes së koston dhe rritjes së konkurrueshmërisë mbetet një objektiv parësor.

Inputet bujqësore dhe punimi i tokës, zënë një peshë kryesore në koston e përgjithshme dhe për këtë arsye :

- Do të reduktohet tatimi mbi vlerën e shtuar për farërat, fidanet, materialin gjenetik shtazor, plehërat kimike, pesticidet, vaksinat e blegtorisë etj.
- Do të krijohet dhe vihet në funksion qendra e kontrollit të cilësisë dhe sigurisë së inputeve bujqësore.
- Do të zbatohet programi i furnizimit të naftës pa akcizë për bujqësinë dhe aktivitetet rurale të ngjashme.
- Do të nxitet shpërndarja me çmime të favorshme e farërave të zgjedhura dhe të rendimenteve të larta.
- Do të nxitet dhe mbështetet, blerja në grup e pajisjeve të mekanikës bujqësore, traktorëve dhe moto-kultivatorëve.
- Rritja e eksporteve të prodhimeve bujqësore, përbën një tjetër përparësi. Ulja e koston së lëndëve të para është thelbësore, prandaj do të



përrjashtohen nga barra fiskale lëndët e para, ato të ndërmjetme dhe të ambalazheve për prodhimet e eksportit.

Nuk ka prodhim bujqësor konkurrues pa një sistem funksional të ujitjes dhe të kullimit të tokave. Aktualisht, vetëm 30% e tokës bujqësore është nën ujë. Ne angazhohemi që brenda 4 vjetësh të ketë ujë për vaditje në çdo parcelë të tokës së punueshme. Për këtë qëllim është e rëndësishme të rimëkëmbet sistemi kullues dhe vaditës i vendit. Për këtë arsye:

- Do të zgjerohet parku i mjeteve të nevojshme publike dhe private, të duhura për mirëmbajtjen e sistemit kullues dhe vaditës të vendit.
- Do të miratohen tarifatat e reja të furnizimit me energji elektrike për sistemin e kullimit dhe të vaditjes.
- Do t'u jepet një rol më i madh komunave në mirëadministrimin e burimeve ujore dhe rritjen e ujitjes dhe kullues.

Synojmë të investojmë 160 mln USD për rimëkëmbjen e sistemit të kullimit dhe vaditjes.

Konsolidimi i titujve të pronësisë mbi tokën është baza e nxitjes së investimeve në bujqësi. Prandaj, zbatimi i Ligjit Nr. 7501, që është marrë vetëm me tokën bujqësore, do të marrë një afat të përfundimit të veprimit të tij me atë çka është ndarë deri tani. Më tej, do të zbatohet vetëm Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë për të drejtën e fitimit të pronës. Në funksion të këtij qëllimi do të modernizohet sistemi i kadastrës dhe verifikohen e regjistrohen titujt e pronësisë publike dhe private mbi tokën bujqësore.

Rritja e punësimit përbën një objektiv madhor në zhvillimin rural. Kjo do të arrihet edhe duke nxitur krijimin e vendeve të reja të punës në agropërpunim si dhe punësim për fermeret në shërbime shumë të kërkuara në agro-turizëm, gjueti, peshkim turistik.

Mbështetja financiare e bujqësisë është e domosdoshme për të patur pritshmëritë e programuara për zhvillimin rural. Për këtë:

- Do të rishikohen skemat e mbështetjes financiare për bujqësinë, duke i orientuar ato drejt rritjes së prodhimit bujqësor dhe lidhjes së tij me tregun dhe

agropërpunimin,

- Do të 5-fishojmë financimin publik për mbështetjen e zhvillimit rural,
- Do të mbështeten me përparësi ngritja e qendrave të grumbullimit, ruajtjes dhe tregtise me shumicë të prodhimeve bujqësore dhe blegtorale,
- Do të mbështeten me fonde të garancisë, zbatimin i skemave të sigurimit të prodhimeve nga dëmtimet natyrore të kulturave bujqësore dhe blegtorisë,
- Do të përcaktohen modalitetet e nxitjes së kreditimit për bujqësinë dhe agropërpunimin në raport me fondet e garancive që do të vihen në dispozicion për këtë qëllim,
- Do të ristrukturohet dhe fuqizohet Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural.

Në fushën e ushqimit dhe të garantimit të cilësisë dhe sigurisë së tij, do të ndiqet një përqasje e integruar sipas parimit “nga ferma në tavolinë”. Për këtë do të merren masa për:

- Të vënë në funksion të plotë sistemin e identifikimit dhe të regjistrimit të blegtorisë;
- Të modernizuar sistemin e identifikimit, sinjalizimit të sëmundjeve infektive dhe parazitare në bimë dhe kafshë;
- Të zgjeruar mbulesën vaksinale në blegtori për të parandaluar dëmtimet në kafshë dhe shpendë dhe pasojat mbi shëndetin publik;
- Të mbikëqyrur tregjet e kafshëve si dhe kontrolluar procesin e përpunimit dhe shpërndarjes të tyre për mish në tregjet e vendit;
- Të promovuar të gjitha ndërmarrjet e agropërpunimit, të cilat zbatojnë sisteme të përparuara të kontrollit të sigurisë dhe cilësisë ushqimore si dhe për të caktuar afate mbi ndërmarrjet që ende nuk i përfshijnë këto standarde në teknologjinë e prodhimit.
- Të përfunduar akreditimin ndërkombëtar të qendrave kombëtare të referencës në fushën e sigurisë ushqimore.

Një përmirësim thelbësor do të ketë në informacionin bujqësor, hartografinë e kulturave dhe racave sipas rajoneve, si dhe përcaktimit të nevojave të specialiteteve të bujqësisë. Për këtë:

- Do të përfundojë harta e rajonalizimit të



kulturave të ndryshme bujqësore dhe e racave të ndryshme që do të mbështeten me financime publike;

- Do të përcaktohen nevojat për specialitete të reja dhe do të plotësohen nevojat me specialistë të bujqësisë, si dhe do të hartohet një program 4-vjeçar i edukimit dhe i formimit profesional në fushën e bujqësisë;
- Do të zbatohet programi i promovimit dhe i shpërndarjes së pervojës së historive të suksesit në bujqesi, blegtori dhe agropërpunim;
- Do të kryhet një inventar i plotë, si dhe do të mbikëqyret shkalla e zbatueshmërisë për të gjithë projektet në fushën e bujqësisë.

Peshkimi, është një sektor shumë i rëndësishëm, i cili kërkon mbështetje. Për këtë kërkohet një rishikim i skemave të furnizimit me naftë pa akcizë, për t'i bërë më të efektshme. Do të mbështetet rifreskimi i flotave të peshkimit dhe pajisja e tyre me mjete të peshkimit në thellësi, për të bërë të mundur furnizimin me lëndë të parë, të fabrikave të përpunimit të peshkut në vend. Do të ngrihen markatat e peshkimit për të harmonizuar interesat e peshkatarëve dhe të tregtarëve. Do të zhvillohet akuakultura. Do të hapet eksporti për molusqet drejt vendeve të BE.

• Mjedisi

Qeveria angazhohet të garantojë një mjedis të shëndetshëm për qytetarët, ta ruajë atë nga ndotja dhe dëmtimi, nga aktiviteti njerëzor dhe veprimtaritë ekonomike, ta trajtojë si vlerë të shtuar dhe pasuri për gjenerim aktivitetesh ekonomike, veçanërisht turistike, si dhe ta ruajë atë si trashëgimi për brezat e ardhshëm.

Mjedisi, shfrytëzimi i qëndrueshëm i tij, është një potencial i madh punësimi. Ne e konsiderojmë mbrojtjen e mjedisit si një detyrë të përbashkët për të gjithë qytetarët, organizatat mjedisore, shoqërinë civile, median, shkollën, shkencëtarët dhe sektorët e biznesit privat.

Falë pozicionit gjeografik dhe shumëllojshmërisë së ekosistemeve në vendin tonë gjenden 3200 specie bimësh që përbëjnë rreth 30% të florës evropiane. Gjuetia e paligjshme dhe shfrytëzimi

pa kriter i natyres, e veçanërisht i parqeve kombëtare kanë shkaktuar dëme të mëdha. Ne do ta përmirësojmë situatën nëpërmjet vendosjes së masave rigorozë për ruajtjen e zonave të mbrojtura, duke kontrolluar rreptë gjuetinë si dhe duke ndaluar përdorimin e armëve të gjuetisë nga persona të paautorizuar.

Shqipëria me rrjetin e saj hidrografik është një vend i pasur me pasuri të shumta ujore, por është e rëndësishme që të adaptojmë një përfaqje të re në menaxhimin e integruar të burimeve ujore. Kështu do t'i japim zgjidhje edhe pasojave të ndryshimeve klimatike, për të shfrytëzuar në mënyrë racionale ujin dhe evituar përmbytjet.

Ne do të realizojmë reforma dhe do forcojmë kapacitetet për të rritur cilësinë e këtyre shërbimeve ndaj publikut. Do të përgatitim plane për manaxhimin efektiv të baseneve kryesore ujore, në mënyrë të veçantë për Drinin, e Bunën dhe Semanin do të perfundojmë Kadastrën e Ujit. Një përkujdesje e veçantë do t'i kushtohet lumenjve, liqeneve dhe burimeve të tjera ujore, veçanërisht atyre që janë tepër të dëmtuar nga aktiviteti jashtëligjor ose ndotja mikrobiologjike dhe kimike.

Cilësia e ajrit është një element themelor për shëndetin publik. Mjaft zona të vendit rezultojnë me nivel ndotjeje më të lartë se normat e lejuara evropiane. Qeveria do të synojë uljen me 30% të nivelit të ndotjes në zonat urbane nëpërmjet:

- Shtimit të sipërfaqeve të gjelbra në zonat urbane;
- Kontrollit të emetimit të pluhurit në zonat urbane, duke aplikuar teknologji të reja monitorimi;
- Përdorimit të karburanteve konform kritereve të BE;
- Zbatimit të standardeve të rrepta në aktivitetet ekonomike që ndotin ajrin.

Publiku në përgjithësi nuk është i informuar mirë për situatën e ndotjes dhe për rrezikun e ndotjes, lidhjen ndërmjet mjedisit dhe shëndetit publik e përfitimet e një mjedisi të pastër për ekonominë dhe shoqërinë si një e tërë. Përpjekjet për fuqizimin e kapaciteteve të OJF-ve janë kryesisht të zbehta. Ne do ta ndryshojmë këtë situatë përmes:



- Pjesëmarrjes së OJF-ve në hartimin dhe zbatimin e ligjeve mjedisore,
- Fuqizimit të rolit monitorues të Agjencisë së Mjedisit,
- Ndarjes së kompetencave për autorizimet, menaxhimin dhe inspektimin.

Infrastruktura

• Transporti

Në katër vitet e ardhshme transporti dhe infrastruktura do të jenë në shërbim të objektivave madhore të zhvillimit ekonomik e social të vendit, por edhe kontributorë të drejtpërdrejtë të rritjes ekonomike dhe të punësimit. Në këtë sektor do të realizohet në mënyrë thelbësore partneriteti publik-privat.

Qeveria e mëparshme ka realizuar investime të mëdha në infrastrukturën rrugore e sistemet e ujësjellës-kanalizimeve, por sot përballemi me një situatë, ku impakti i këtyre investimeve ka qenë inferior, veprat janë realizuar jashtë standardeve teknike, investimet e realizuara si rezultat i mosmirëmbajtjes janë të papërfunduara dhe në degradim (përfshirë edhe Rrugën e Kombit), shërbimet që u ofrohen qytetarëve janë të një cilësie të ulët edhe transport, impakti në mjedis është shumë i rëndë, veprat janë realizuar me një kosto të lartë financiare për vetë kompanitë realizuese, si rezultat i mospagimit të faturave për punimet e kryera.

Shumë pak është bërë për të futur inovacionin, teknologjinë e lartë, kursimin e energjisë, dhe ruajtjen e mjedisit.

Po kështu, Raporti i Progresit i Bashkimit Evropian për këtë sektor flet për mungesë progresi, për afrim të dobët të legjislacioni, për kapacitete administrative e teknike të ulëta.

Objektiv kryesor në fushën e transportit është përshpejtimi i integritetit të sistemit të transportit, ngritja e një tregu të integruar, të përbërë për infrastruktura dhe transport me tokë, me det dhe me rrugë ujore të brendshme që të mbështetë në mënyrë efikase kërkesën zhvillimore për transport.

Për arritjen e këtij objektiv duhet kryer përafrimi i legjislacionit kombëtar me atë të BE-se, duke harmonizuar rregullat mbi sigurinë, ruajtjen e mjedisit, dhe shërbimet e transportit.

Masë e rëndësishme themelore është miratimi i Planit Kombëtar të Transportit.

Rritja e sigurisë rrugore përbën gjithashtu një prioritet madhor. Kjo do të realizohet në tri ndërhyrje kryesore: në drejtim të përfundimit të veprave të papërfunduara sipas standardeve si dhe eliminimit të pikave të zeza të aksidenteve; forcimit të rregullave të qarkullimit rrugor dhe zbatimit të tyre pa kompromis; si dhe një fushate ndërgjegjësuere e edukative që fillon në bankat e shkollës.

Numri i aksidenteve rrugore synohet të ulet në masën 20%, vetëm gjatë vitit të parë të këtij mandati qeverisës.

Plani Kombëtar i Transportit do të përmbajë përfundimin e ndërtimit të rrjetit kombëtar të rrugëve, duke përfshirë arterie strategjike si Korridori i Gjellbër Autostradal Veri-Jug; Korridori i Kaltër Veri-Jug dhe duke i dhënë prioritet përfundimit të akteve që shkojnë në qendrat administrative të qarqeve të vendit.

Rëndësi të veçantë do të marrin lidhjet me rrjetet rrugore të rajonit të Ballkanit.

Do të realizojmë gjithashtu investime në rrugët rajonale, të fshatrave dhe qyteteve me qëllim lidhjen me të mirë të tregut me qendrat e prodhimit duke gërshtuar kriterin ekonomik me atë të impaktit social.

Një domosdoshmëri përbën përcaktimi i metodave dhe hartimi i programit për mirëmbajtjen e rrugëve duke shtuar fondet dhe do të përmirësohet edhe administrimi i tyre. Investime do të bëhen edhe në sinjalistikën rrugore në rrugët ekzistuese dhe garantimi i standardit të lartë të saj në investimet në proces apo të reja.

Krijimi i një sistemi të integruar transporti kërkon përmirësim thelbësor në menaxhimin e këtij sistemi të transporteve, rritje të efikasitetit dhe kursimin e energjisë prej tij, si dhe ngritjen e



kapaciteteve logjistike, me vëmendje të veçantë drejt intermodalitetit si dhe heqjes së pengesave administrative.

Prioritet madhor përbën përmirësimi i ndjeshëm i cilësisë dhe sigurisë së transportit publik.

Me rëndësi në sektorin e transportit është përcaktimi i strategjisë kombëtare për hekurudhat shqiptare. Ne synojmë modernizimin e rrjetit hekurudhor, duke rritur cilësinë e tij, veçanërisht në drejtim të intermodalitetit, duke realizuar lidhjen me Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë, si dhe duke synuar integrimin me korridoret evropiane hekurudhore.

Hartimi i Planit Kombëtar për Zhvillimin e Porteve dhe realizimi i projekteve për rritjen e kapaciteteve të tyre, është gjithashtu një drejtim i rëndësishëm në këtë sektor. Plani Kombëtar për Zhvillimin e Porteve synon rritjen e aftësive përpunuese të tyre, rritjen e punësimit në transportin detar dhe projektimin e një sistemi modern të transportit detar. Do të realizohet specializimi i funksioneve të porteve dhe rritja e intermodalitetit të tyre, veçanërisht përmirësimi i lidhjes së tyre me hekurudhë.

Një vëmendje të veçantë do të marrë zgjerimi i Portit të Shëngjinit, si dhe ndërtimi i porteve turistike, mbështetur nga infrastruktura e logjistika e nevojshme për këtë qëllim.

Në transportin ajror, do të realizojmë hapjen e tregut dhe uljen e kostos së tarifave të udhëtimit për pasagjerët. Investimet e bazuara në partneritetin publik-privat do të realizohen edhe në transportin ajror për qëllime të brendshme e turistike.

• **Teknologjia e informacionit dhe e komunikimit**

Kapacitetet e ulëta vendase dhe një pasqyrë jo e qartë e përmasave të sektorit të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK) pengojnë vlerësimin faktik të tij.

Zhvillimi ekonomik dhe social i Shqipërisë, i përshtatur me tregun konkurrues botëror kalon detyrimisht nga përshtetimi dhe përdorimi masiv i TIK që janë sot faktori kyç i rritjes

së produktivitetit ekonomik në administratë, në biznes, në prodhimin industrial, në tregjet financiare. Për të mundur edhe në Shqipëri rritjen ekonomike të dhjetëvjeçarit të ardhshëm, falë inovacionit dhe TIK, lipset të përforcohen kushtet ligjore, ekonomike dhe të aftësohen kapacitete të rëndësishme njerëzore. Qeveria do të punojë në 3 drejtime kryesore duke vendosur objektiva të matshme:

Së pari, për shtimin dhe promovimin e shërbimeve dixhitale, e-shërbimeve, për qytetarët dhe biznesin. Prioritet do të jetë rritja e transparencës dhe përmirësimi i shërbimeve në administratën publike sipas parimeve të iniciativës Open Government Partnership.

Së dyti, në futjen masive të shërbimeve në arsim për të kapërcyer hendekun dixhital dhe për të aftësuar rininë. Politikat do të jenë të orientuara drejt përmirësimit dhe zgjerimit të kapaciteteve njerëzore në mënyrë që të rritet si numri i përdoruesve ashtu edhe numri i ofruesve vendas të e-shërbimeve. Në këtë mënyrë do të nxitet krijimi i vendeve të punës në këtë fushë për tregun shqiptar, rajonal e më gjerë.

Së treti, konsolidimi i infrastrukturës dixhitale në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, duke respektuar me rigorozitet parimet evropiane të konkurrencës së lirë e të ndershme.

• **Furnizimi me ujë të pijshëm dhe kanalizimet**

Për një cilësi me të lartë shërbimi për qytetarët dhe në shërbim të zhvillimit të sektorëve të tjerë të ekonomisë, kërkohet një përqaasje e re e integruar në drejtim të furnizimit me ujë, trajtimit të ujrave të ndotura si dhe mbetjeve urbane.

Në këta sektorë do të përfundojnë reformat strukturore si dhe do të investohet edhe duke përfshirë partneritetin publik-privat.

Për sistemin e ndërmarrjeve të Ujësjellës-Kanalizime do të realizohet agregimi dhe rajonalizimi i tyre, për të ulur kostot e operimit, rritjen e efikasitetit, veçanërisht duke ulur humbjet



teknike dhe mospagimin e shërbimit, realizimin e investimeve dhe shërbimin më të mirë ndaj qytetarëve.

Do të realizohen me prioritet projektet për Ujësjellës-Kanalizime në zonën e Durrësit dhe atë turistike të bregdetit të jugut.

Qëllimi është të realizohet një situatë optimale në garantimin e furnizimit të vijueshëm me ujë të pijshëm dhe në përmirësimin e ndjeshëm të funksionimit të sistemit të kanalizimeve.

• Administrimi i mbetjeve

Ndotja e mjedisit nga mbetjet është problem kryesor për shëndetin publik dhe për mjedisin në tërësi.

Nuk ka ndarje në grumbullim dhe sisteme trajtimi ndërmjet mbetjeve urbane dhe mbetjeve të rrezikshme.

Do të krijojmë e zbatojmë standarde të reja në administrimin dhe menaxhimin e intergruar të mbetjeve urbane, duke përdorur mekanizma ekonomike për të stimuluar grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim, duke vendosur një partneritet sërish të ngushtë privat-publik. Do të bashkëpunojmë ngushtë me pushtetin vendor, duke e mbështetur në këtë proces.

Do të ndalojmë importin e mbetjeve.

Do të eliminojmë venddepozitimet e mbetjeve që janë buzë lumenjve dhe do të përcaktojmë vende të tjera të përshtatshme për depozitim.

Do të pastrohen në mënyrë prioritare akset kryesore rrugore nga mbetjet dhe ndotës të tjerë.

Do të ndalojmë në mënyrë urgjente zjarret në vendgrumbullimet e plehrave pranë qyteteve.

Do të përfundojë hartimi i të gjitha planeve rajonale për menaxhimin e qëndrueshëm të mbetjeve dhe do të monitorohet zbatimi i tyre

Do të nxitim riciklimin e mbetjeve dhe me synim pakësimin e landfilleve e për të mundësuar incinerimin e tyre me qëllim prodhimin e energjisë

elektrike.

Profili makroekonomik dhe fiskal

Ritmi i rritjes së Prodhimit të Brendshëm Bruto për periudhën 2008 – 2012 është ulur nga 7.5% në rreth 1.5%. $\frac{3}{4}$ e rritjes nominale për këtë periudhë vjen nga rritja e nivelit të borxhit publik. Kjo prirje duket e ngjashme edhe për vitin 2013. Rritja ekonomike parashikohet sipas Moody's 1.7%; sipas FMN 1.8%; sipas BERZH 1.8%.

E rëndë është situata edhe në treguesit fiskalë. Për herë të parë në këto 20 vjet, që nga viti 2010 deri në vitin 2013, të ardhurat publike kanë qenë rreth 325-330 miliardë lekë, pavarësisht se parashikimi fillestar i buxhetit të 2013-s ka qenë në nivelin e 360 miliardë lekë. Për pasojë, të ardhurat gjithsej në përqindje ndaj PBB kanë pësuar një rënie të vazhdueshme nga 26.6% në vitin 2010 në rreth 23% në fund të vitit 2013. Mosrealizimi i të ardhurave ka çuar në rritje të pakontrolluar të borxhit publik, i cili është në nivelin rreth 64% të PBB.

• Borxhi publik

Ne jemi të vendosur që gradualisht të fillojmë ta ulim borxhin publik, ta sjellim atë në parametra të kontrollueshëm dhe të mos ia lëmë barrë brezave të ardhshëm. Objektivat tona kryesore janë:

- Ulje graduale e borxhit nëpërmjet kontrollit të deficitit fiskal dhe përshtatjes me rritjen ekonomike (vendosja e një rregulli fiskal transparent e të besueshëm).
- Në periudhën afatmesme synohet një borxh publik në parametra të përshtatshëm për nxitjen e ritmeve pozitive të rritjes, për strukturën ekonomike të vendit, si dhe për t'i lënë hapësira të mjaftueshme financimi sektorit privat.
- Fillimi i uljes së borxhit publik në pjesën e dytë të mandatit do të realizohet nga një qeverisje e përgjegjshme e kontrollit mbi deficitin buxhetor.

Në një periudhë relativisht të shpejtë, borxhi publik do të plotësohet dhe me pjesën "e fshehur" të tij; në bashkëpunim me institucione të njohura financiare do të bëjmë transparencë të plotë të gjithë detyrimeve të bartura dhe të pakontabilizuara në borxhin publik të deritanishëm.



• Përdorimi efikas i parave publike

Që politika fiskale të sjellë përmirësim gradual dhe të shëndetshëm të treguesve makroekonomikë, duhet të sigurohet efikasiteti i realizimit të shpenzimeve publike. Ne do të garantojmë mirëmenaxhimin e shpenzimeve publike nëpërmjet:

- Analizës së harmonizuar të zhvillimeve makroekonomike dhe fiskale;
- Planifikimit dhe monitorimit të kujdesshëm të Programit Buxhetor Afatmesëm dhe Buxhetit Vjetor;
- Bashkëpunimit me institucionet ndërkombëtare financiare dhe ato të Bashkimit Evropian;
- Menaxhimit të borxhit publik dhe ankorimit në mbështetje të borxhit publik nën kontroll;
- Harmonizimit të menaxhimit financiar dhe kontrollit efektiv të shpenzimeve në institucionet publike;
- Bashkëpunimit efektiv me të gjitha institucionet e tjera buxhetore në nivel qendror dhe vendor në lidhje me planifikimin e financimeve publike.

Përdorimi efikas i parave publike do të garantohet nga:

- forcimi i zbatimit të disiplinës financiare në menaxhimin e fondeve publike, nëpërmjet monitorimit dhe mbikëqyrjes së vazhdueshme dhe të kujdesshme të aktiviteteve të njëjësive shpenzuese;
- zhvillimi i sistemit të plotë të kontrollit të brendshëm financiar publik, për përmirësimin e menaxhimit financiar;
- kontrollit dhe auditimit të brendshëm në sektorin publik, për përgjegjshmëritë menaxheriale dhe për harmonizimin e metodologjisë dhe standardeve;
- përshtatja graduale e të dhënave të financave publike me metodologjinë ESA95 të BE.

• Administrimi fiskal

Gjatë 8 viteve të shkuara, ligjet fiskale janë ndryshuar mbi 70 herë dhe më së shumti, duke evituar konsultimet paraprake serioze me komunitetin e biznesit dhe aktorë të tjerë të interesuar. Kjo formë e ndryshimeve rezultoi në humbjen e peshës së paketës fiskale. Ne do

të rikthejmë rëndësinë e paketës fiskale dhe ndryshimet kryesore do të bëhen në fillim të çdo viti buxhetor.

Administrata tatimore do të bashkohet me atë doganore si dhe do të përthithë edhe administratën tatimore vendore, duke synuar rritjen e efikasitetit dhe një kontroll edhe më të arsyeshëm të tatimpaguesve. Shkëmbimi i informacionit do të mund të bëhet në kohë reale, duke siguruar bashkëpunimin për luftimin e evazionit nga mosrakordimi institucional. Rritja e të ardhurave buxhetore nuk do të bazohet kryesisht në rritjen e nivelit të taksave.

Për tatimet indirekte politikat tona 4-vjeçare përmbledhin:

- Do të kemi një përgjysmim të TVSH-së për ushqimet më jetike të shportës, bazë të konsumit.
- Përrjashtimi/ ulja nga ky tatim për barnat dhe shërbimet shëndetësore.
- Realizimi i premtimit për heqjen reale të TVSH-së për importimin e makinerive dhe pajisjeve.
- Ulja/ kompensimi i TVSH-së për pjesën e domosdoshme të furnizimit me energji elektrike të konsumatorëve familjarë të varfër.
- Për të nxitur prodhimin bujqësor do mundësohet përjashtimi ose vendosja e një norme të ulur, për plehrat kimike, farat e fidanët dhe për lëndët e tjera të para që përdoren në bujqësi dhe blegtori.
- Heqja e akcizës dhe taksës së qarkullimit të naftës për bujqësinë dhe peshkimin.
- Do të rishikohet me kujdes projektligji i ri i TVSH-së për të pasur një heqje graduale të skemave speciale të shtuara gjatë viteve, të cilat nuk janë në linjë me Direktivën e TVSH-së së Bashkimit Evropian.

Për tatimet direkte politikat tona 4-vjeçare përmbledhin:

- Tatimi mbi fitimin e biznesit të vogël do të jetë rreth dy herë më i vogël se tatimi mbi fitimin e biznesit të madh, ndërsa do të hiqet taksë mbi biznesin e vogël.
- Tatimi mbi fitimin për biznesin e madh do të ketë një normë më të lartë se ajo aktuale, për të reflektuar parimin e taksimit të ndershëm dhe nevojën që kompanitë e mëdha të kontribuojnë



më shumë se bizneset e vogla që funksionojnë nëpërmjet vetëpunësimit.

- Tatimi mbi të ardhurat personale të individëve do të ndryshohet në një skemë të normave progresive, duke rritur ngarkesën fiskale për pagat më të larta dhe duke e ulur për pjesën tjetër.
- Do të përdoret legjislacioni i ri në lidhje me transferimin e çmimit në përputhje me modelet e OECD-së.

Veprimet rregullative dhe organizative synojnë të arrijnë:

- Përpjekje serioze për uljen e kohës që i duhet biznesit për të paguar tatimet si dhe për uljen e kostove rregullative dhe korruptive për të paguar tatimet dhe doganën apo uljen e numrit të pagesave vjetore. Një kompani e huaj e njohur në tregun ndërkombëtar do të ftohet për të ndihmuar në këto drejtime.
- Përmirësim të dukshëm të kapacitetit dhe pavarësinë e njësisë së apelimeve, Avokatit të Tatimpaguesve dhe cilësisë së shërbimit të klientelës në tatime e dogana.
- Sistemi i apelimit tatimor është një shqetësim i përhershëm i komunitetit të biznesit që duhet rishikuar, të paktën për pjesën e procedurave brenda administratës fiskale. Ky sistem duhet të ofrojë apelime të paanshëm dhe një shkallë më të mirë transparence.
- Edukimi fiskal do jetë një tjetër element shumë i rëndësishëm i administrimit fiskal. Edukimi nuk do kufizohet vetëm tek tregtarët dhe shoqëritë tregtare, por do të orientohet edhe tek konsumatori final si hallka përfundimtare e sistemit.

• Statistikat

Që sipërmarrja të jetë e suksesshme, i nevojitet edhe informacion ekonomik i bollshëm, i saktë dhe transparent për vendimmarrjen. Aktualisht informacioni statistikor zyrtar është i mangët, i vonuar dhe i manipuluar. Operatorët ekonomikë dhe publiku i gjerë kanë humbur plotësisht besimin tek Instituti i Statistikave, i cili është kthyer në një instrument në dispozicion të propagandimit të gënjeshtreve të pushtetit. Ne e konsiderojmë informacionin statistikor një të mirë publike në shërbim të qytetarëve dhe faktorëve ekonomikë. Do të kthejmë seriozitetin dhe pavarësinë e Institutit të Statistikave, duke e vënë drejtimin e tij nën kontrollin e Kuvendit të Shqipërisë. Në një periudhë afatmesme, drejtimi i përditshëm i aktivitetit profesional të Institutit të Statistikave do të realizohet nëpërmjet binjakëzimit me një institucion të ngjashëm të një vendi të Bashkimit Evropian.



SHËRBIMET
PUBLIKE





Arsimi

Gjatë qeverisjes së mëparshme pesha e buxhetit për arsimin ndaj shpenzimeve buxhetore vjetore nuk e ka kaluar asnjë herë nivelin që kishte në vitin 2005. Shpenzimet publike për arsimin janë dy herë më të ulëta se niveli mesatar i vendeve të OECD. Qeverisja e djathtë ia la barrën e arsimimit buxheteve familjare. Analfabetizmi vlerësohet të ketë arritur në rreth 15%. Braktisja e shkollës në nivelin 9-vjeçar është në shkallën 10%. Jo rrallëherë, fëmijët në zonat rurale udhëtojnë me orë të tëra në këmbë dhe në dëborë, shi apo të ftohtë për të shkuar në shkollë. Të dhënat dëshmojnë se për çdo brez ka më shumë se 20 mijë të rinj që nuk e kanë mbaruar shkollën e mesme. Veçanërisht duke filluar nga arsimi i mesëm, nxënësit dhe studentët lihen pa asnjë mbështetje për sa i përket këshillimit për vazhdimësinë e studimeve dhe karrierës së tyre.

Qeveria e konsideron arsimin si një ndër politikat më të mira ekonomike dhe si një sistem thelbësor që garanton zhvillimin tërësor të vendit.

Synimi është që financimi publik për arsimin të arrijë në nivelin e 5% e PBB me qëllim që të sigurohet arsim cilësor për çdo fëmijë, pavarësisht origjinës, rrethanave familjare, apo gjendjes ekonomike.

Politikat arsimore do t'i mundësojnë çdo të riu deri në moshën 26 vjeç diplomim në universitet, formim në një profesion, ose sistemimin në një vend pune. Gjithashtu, institucionet arsimore publike do të gëzojnë mbështetjen maksimale në rritjen e funksionalitetit dhe rreptësisë ndaj rasteve të abuzimit dhe falsifikimit në arsim.

Do të krijohet një sistem arsimit parashkollor i konsoliduar që ofron akses për të gjithë fëmijët deri në moshën 5 vjeç. Gjithashtu do të reformohet tërësisht kurrikula e arsimit parashkollor, në kontekstin e reformës kurrikulare të arsimit bazë.

Nuk do të ketë asnjë shkollë me tre turne dhe asnjë klasë me më shumë se 30 nxënës. Prindërve dhe komunitetit do t'i krijohen mundësitë ligjore për ndryshimin e drejtuesve dhe mësuesve të

shkollave, në rastet kur këta të fundit nuk i shërbejnë interesit më të mire të nxënësve. Krijimi i “Kartës së Performancës së Shkollës” do t’u ofrojë prindërve informacion mbi standardet, cilësinë e mësimdhënies, shkallën e kënaqësisë së prindërve me punën e shkollës, dhe renditjen e saj në performancë. Qeveria gjithashtu do të synojë përmirësimin e të ardhurave reale të mësuesve dhe do të vendosë kritere shpërblimi e emërimi bazuar në meritokraci.

Kujdes i veçantë do të tregohet në zbatimin e politikave sociale në ndihmë të nxënësve të dizavantazuar dhe atyre në nevojë. Kështu, çdo nxënës që duhet të udhëtojë në këmbë mbi 20 minuta për të shkuar në shkollë, do të ketë transport falas të garantuar. Gjithashtu çdo fëmijë që është i treti e më lart në radhën e shkollimit të fëmijëve të së njëjtës familje do të ketë librat falas gjatë gjithë ciklit të shkollimit të detyrueshëm. Një tjetër angazhim i yni do të jetë kthimi i shkollës, në një mjedis pa barriera për të rinjtë me aftësi fizike të kufizuara. Do të sigurohet zgjerimi dhe forcimi i shërbimit të këshillimit psikosocial në shkolla, si dhe pajisja e çdo shkolle publike të ciklit të parë dhe të dytë me punonjësit përkatës të shërbimit këshillimor.

Deri në fund të mandatit të parë të qeverisjes do të rritet deri në 90% niveli i përfundimit të arsimit të mesëm. Në maturën shtetërore, do të arrihet rritja e numrit të provimeve me detyrim dhe konsiderim i maturës shtetërore si provim dalës, çka do të shërbejë në rritjen e cilësisë së pranimeve në shkollat e larta.

Qeveria do të realizojë ngritjen e qendrave këshillimore për karrierën në shkollat e mesme dhe vendosjen e programit të “mentorëve” (kurse pa pagesë pas orarit të mësimt). Gjithashtu do të mbështeten nismat për gjenerimin e modeleve bashkëkohore jotradicionale në arsimin e lartë (si maturë +2) dhe përfshirjen e kompanive të interesuara në financimin e disa profileve.

Prioritet i qeverisë është rritja e sigurisë në institucionet arsimore, veçanërisht për sa i përket eliminimit të rasteve të përdorimit të armëve dhe konsumit të narkotikëve apo substancave të tjera të dëmshme në shkolla.



Qeveria do të sigurojë ngritjen e një organizmi të drejtë e të pavarur vlerësimi, akreditimi, dhe renditjeje të universiteteve publike dhe jopublike. Do të ndryshohet skema e financimit të arsimit të lartë duke rritur financimet që shkojnë drejt sistemit dhe duke mundësuar cilësinë që ai ofron. Sigurimi i autonomisë së universiteteve deri në njësitë bazë, shoqëruar me rritjen e kapaciteteve menaxhuese të njësisë, do të jetë një tjetër prioritet i reformave që do të ndërmerren në arsimin e lartë.

Qeveria do të sigurojë kualifikimin korrekt dhe transparent të personelit akademik si dhe përmirësimin e kushteve të mësimdhënies dhe pagave të personelit akademik, drejt ngushtimit të hendekut me pagat në universitet jopublike.

Qeveria gjithashtu, do t'u ofrojë asistencë universiteteve publike në ngritjen dhe fuqizimin e qendrave të këshillimit për karrierën. Një vëmendje e veçantë, do t'i kushtohet arsimimit të rinjve në shkencat natyrore, teknike, dhe bujqësore, përmes aplikimit të burimeve dhe incentivave të nevojshme.

Niveli i kërkimit shkencor dhe botimeve të dala nga ky kërkim në vend është mjaft larg standardeve ndërkombëtare. Si në shumë fusha të tjera, arritjet individuale ose të disa grupeve të vogla të kërkuesve shkencorë shqiptarë, brenda e jashtë vendit, janë mbresëlënëse, por drejtimi i kërkimit shkencor nga ana e instancave shtetërore dhe vizioni i zhvillimit të shkencës nuk ka tejkalar qasjen dhe logjikën totalitare. Kërkimi shkencor është nën presionin e emërimeve nepotike dhe partiake, të cilat jo vetëm kërcënojnë të ardhmen e shumë kërkuesve shkencorë e studiuesve në vend, por dhe rezultojnë në uljen e cilësisë.

Ne e konsiderojmë progresin shkencor si paraprijës të zhvillimit shoqëror, ekonomik, e kulturor, si një faktor të konsolidimit demokratik, dhe si një pjesë themelore të imazhit të Shqipërisë Evropiane.

Mbështetja e zhvillimit të shkencës do të përfshijë subvencionimin e institucioneve akademike e shkencore në funksion të punës kërkimore. Ne do të krijojmë mundësitë për një kombinim të burimeve publike dhe private në shërbim të

financimit të kërkimit shkencor si dhe do të sigurojmë sinergjinë midis zhvillimit shkencor dhe programeve të zhvillimit kombëtar.

Qeveria do të mbështesë rritjen e kontributit shkencor të Akademisë së Shkencave sipas vizionit shkencor për zhvillimin e vendit. Gjithashtu, do t'i ofrohet mbështetje Akademisë së Shkencave për t'u bërë një forcë shtytëse e veprimtarisë kërkimore e shkencore në vend dhe përfaqësuese e denjë e komunitetit shkencor. Demokratizimi i drejtimit të instituteve shkencore dhe mbështetja e forumeve e grupimeve të kërkuesve shkencorë do të jenë një përparësi, me synim institucionalizimin e ndërhyrjes së tyre në politikat e shtetit për shkencën. Qeveria do të garantojë pavarësi të punës kërkimore dhe përforcojë profilin e kërkuesit shkencor.

Do të ndërmerren politika për sintetizimin e koordinimit të kërkimit shkencor në vend me zhvillimet ndërkombëtare. **Do të ofrohet mbështetje për bashkëpunimin mes kërkuesve shkencorë vendas dhe atyre të huaj. Qeveria do të krijojë mundësitë për angazhimin e kërkuesve shkencorë shqiptarë në universitetet e huaja, në kuadrin e programeve shtetërore dhe bashkëpunimit efektiv të institucioneve shtetërore me organizatat ndërkombëtare që financojnë programe të tilla.**

Sporti

Historitë individuale të sportistëve shqiptarë janë dëshmia më e mirë e lënies pas dore të sportit në vend. Mbështetja e gjithanshme dhënë sportistëve dhe të angazhuarve në aktivitete sportive, si dhe ajo dhënë shumëllojshmërisë së aktiviteteve sportive është krejtësisht e mangët. Sot në Shqipëri nuk kemi partneritet mes qeverisë dhe institucioneve sportive dhe kemi një ligj për sportin që nuk zbatohet. Mangësitë legjislative reflektohen si barrë e shumëfishuar në sistemin sportiv të vendit nga mungesa e strategjive si nga ana e institucioneve qendrore ashtu dhe nga ato federative apo klubet. Keqmenaxhimi si rrjedhojë e paaftësisë së institucioneve qendrore dhe interesave të tyre klienteliste, kanë çuar



në kolaps kapacitetin publik, institucional dhe infrastrukturor, të zhvillimit të sportit në vend.

Ne synojmë rikonstruktimin institucional, legjislativ dhe infrastrukturor të sportit, duke praktikuar modelet më të mira evropiane dhe duke synuar partneritetin me komunitetin për decentralizimin dhe promovimin e tij. Ne do ta kthejmë sportin në një faktor efikas të ndërtimit të mirëqenies për qytetarët dhe komunitetet në mbarë vendin.

Një ndër hapat me prioritet që do të ndërmerren në këtë sektor është nxjerrja e menjëhershme e legjislacionit sportiv nga gjendja kaotike, përshtatja e tij me standardet dhe normat ndërkombëtare dhe vendosja e masave administrative që sigurojnë zbatimin rigoroz të tij. Në kuadër të rishikimit dhe hartimit të një legjislacioni funksional për sportin, qeveria do të ndërmarrë hapat e mëposhtëm:

- Krijimi i “Këshillit të Lartë të Ekspertëve në Sport”;
- Krijimi i komisioneve sipas nevojave të sportit;
- Përcaktim i “Statusit të Sportistit të Nivelit të Lartë”;
- Qartësim i çështjeve të pronësisë së objekteve sportive;
- Sigurimi i fondeve themelore dhe dytësore për sportin;
- Përcaktimi i kompetencave midis pushteteve dhe lëvizjeve sportive (federatave, shoqatave, klubeve, etj.)

Krijimi i Statusit të Sportistit Elitar, bazuar në kriteret e arritjes dhe rezultateve të larta, do të sigurojë të tashmen dhe të ardhmen e sportistëve duke krijuar lehtësime në shkollim, punësim, stimulim financiar, sigurim shëndetësor, dhe pensione të veçanta, me qëllim konvertimin e sportit në punë.

Qeveria do të ndërmarrë hapa për krijimin e një konfigurimi organizativ të Federatave Kombëtare Sportive, me synim qartësimin e strukturës organizative dhe rolit të aktorëve. Gjithashtu do të sigurohet autonomia e plotë dhe vetëmënxhimi i Federatave Sportive, sipas rekomandimeve të organizmave ndërkombëtarë të sportit, të ratifikuara nga parlamenti.

Do të synohet rritja e fondeve për sportin, si dhe nxitja dhe sigurimi i kushteve për kryerjen dhe zhvillimin e aktiviteteve sportive në nivel lokal. Në këtë kuadër, do të stimulohen politika fiskale në favor të sportit. Qeveria gjithashtu do të hartojë dhe zbatojë një Program Kombëtar Anti-Doping sipas standardeve ndërkombëtare dhe Kartës Evropiane të Sportit, si dhe do të marrë masa urgjente dhe të ashpra për ndalimin e dhunës në sport.

Do të ndërmerren politika në mbështetje të aktivitetit sportiv të personave me aftësi të kufizuara si dhe do të mundësohet sigurimi i një pensioni të veçantë për sportistët me aftësi të kufizuara me rezultate të larta në nivel ndërkombëtar dhe përfshirje në Statusin e Sportistit Elitar për ata që plotësojnë kriteret.

Krijimi i “Federatës së Sportit Universitar” dhe “Federatës së Sportit Shkollor”, do të shërbejë për të koordinuar dhe gjallëruar jetën sportive në të gjitha shkollat e vendit, me aktivitete sportive kurrikulare dhe jashtëkurrikulare. Gjithashtu, do të arrihet përfshirja në kurrikula e standardit shtetëror të vlerësimit të aftësive bazike motore të fëmijëve nga 3 deri në 6 vjeç.

Për sa i përket infrastrukturës sportive, Qeveria do të mbështesë ndërtimin dhe mirëmbajtjen sipas standardeve bashkëkohore të objekteve dhe terreneve sportive publike. Gjithashtu, Qeveria do të nxitë dhe mbështetë klubet sportive për krijimin dhe ngritjen e qendrave sportive, rajonale, zonale dhe kombëtare, të cilat do të shërbejnë për promovimin dhe organizimin e jetës sportive në vend dhe evidentimin e talenteve të reja.

Kultura dhe trashëgimia kulturore

Kultura dhe Trashëgimia Kulturore do të drejtohen nga një ministri e dedikuar, pa shtojca të tjera dhe pa u kthyer vetë në shtojcë të askujt.

Arti e Kultura, kërkojnë një qasje të re të menaxhimit të institucioneve, për të rritur shkallën e pavarësisë së tyre artistike dhe krijuar hapësira për gjenerimin e të ardhurave nga burime të treta. Qasja e re do të arrihet me anë të një reforme që do të kryhet në dialog me komunitetin artistik



të vendit, duke vendosur një mekanizëm i ri në projektimin, shpërndarjen dhe menaxhimin e fondeve publike të parashikuara për projektet kulturore dhe artistike. Do të ndërtohet kështu kalendari kulturor dhe artistik i institucioneve kulturore përgjatë gjithë vitit, të parashikuar e të planifikuar në respekt të konceptit të teatrit të repertorit. Nga ana tjetër do nxitet fort arti alternativ si dhe do të arrihet transparenca e plotë në caktimin, dhe përdorimin e fondeve publike.

Artet pamore do të jenë dyer të hapura për artistët e rinj dhe për krijimtarinë e hapësirave të hapura e të lidhura me gjinitë e tjera artistike. Ekspozitat do të qarkullojnë brenda Shqipërisë, por dhe jashtë në kuadër të kalendarit kulturor me Kosovën.

Do të nxitin agjendat kulturore mbarëshqiptare, ndërrajonale që kultivojnë dhe traditën, por edhe debatin kulturor dhe artistik aq të munguar. Me Kosovën do të ndërtohen kalendarë kulturorë të përbashkët si rruga më e mirë e komunikimit dhe hapësira më e sigurt e pandashme.

Krijimtaria e shkruar do të meritojë një vëmendje të posaçme. Politikat për librin do të jenë të orientuara drejt lexuesve dhe edukatës së leximit, duke mbështetur krijuesit autorë e përkthyes në harmonizim me interesat e botuesve.

Bibliotekat do të forcojnë e promovojnë rolin e tyre edukativ me programe proaktive për çdo grupmoshë. Në Bibliotekën Kombëtare do të përfundojë dixhitalizimi dhe do të rritet roli i saj në trajnimin e bibliotekave të tjera, në qasjen proaktive ndaj lexuesit dhe në nxitjen e kulturës së leximit.

Për përhapjen e kulturës shqiptare të shkruar, do të përpunohet një strategji për të promovuar letrat shqipe në hapësirën evropiane, duke u përfaqësuar në panairt më të mëdha ndërkombëtare dhe duke lidhur marrëveshje me rrjetet kulturore që bëjnë të mundur qarkullimin e këtyre vlerave në hapësirën evropiane. Politikat e mësipërme do të realizohen nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Letrave që do të jetë një ndër objektivat e programit kulturor.

Do të mbrohen më mirë interesat e krijuesve duke riformtuar Zyrën e të Drejtave të Autorit në luftë kundër piraterisë intelektuale dhe mbështetur me përmirësime të nevojshme ligjore.

Një theks i fortë do të vihet në politikat e edukimit artistik masiv që në moshat e vogla. Do të përgatiten atelietë e posaçme sipas grupmoshave dhe do të ndërtohet kalendari «Edukim përmes Kulturës» nga të gjitha institucionet qendrore dhe më tej vendore të Artit e Kulturës për t'i kthyer ato në aktivitete të programuara. Do të bashkëpunohet me Universitetin e Arteve si dhe me institucionet qendrore dhe vendore të kulturës për krijimin e skemës së klubeve artistike në shkolla.

Sot më shumë se kurrë, trashëgimia kulturore, ka nevojë për një vizion afatgjatë zhvillimi. Është e domosdoshme dhe urgjente të kryhet menjëherë diagnostikimi i detajuar dhe fizik i gjendjes së trashëgimisë kulturore në të gjithë territorin.

Fokus të veçantë do të ketë ndërtimi i politikave të përbashkëta sidomos me Kosovën për trashëgiminë shqiptare.

Do të përpilohet harta e riskut për të gjitha monumentet e veçanta, por edhe për qendrat historike dhe parqet arkeologjike.

Do të realizohet përditësim i rregullt dhe rigoroz i listës, si dhe verifikimi i statusit të monumenteve të shpallura dhe atyre të propozuara për heqje nga lista.

Do të vlerësohen me përparësi të gjitha rekomandimeve të Komitetit të Trashëgimisë Botërore dhe do të hartohet një plan veprimi energjik në përputhje me skadencat e dhëna nga UNESCO.

Në bashkëpunim me donatorët ndërkombëtarë do të përgatiten projektet për partneritetet publik-privat për rijetësimin e trashëgimisë kulturore, duke garantuar transparenca, monitorim dhe mbrojtje e restaurim.

Do të rivlerësohet trashëgimia kulturore jomateriale, thuhet e harruar deri më sot, jo vetëm si një rigjallërim i jetës kulturore në të gjithë territorin, por edhe si bazë e bashkëpunimit kulturor ndërkufitar dhe ndërrajonal.

Në bashkëpunim me shoqërinë civile dhe median do të fillojë dhe vazhdojë në mënyrë permanente fushata sensibilizimi me shoqërinë civile për mbrojtjen e monumenteve të kulturës.



Për ruajtjen e trashëgimisë kulturore, në bashkëpunim me Policinë e Shtetit do të kryhet verifikimi i denoncimeve të bëra në media lidhur me dëmtimet e trashëgimisë kulturore dhe do të ndiqen me rreptësi të gjitha ngjarjet; do të hartohet një marrëveshje për të specifikuar mekanizmat e represionit kundër krimit mbi trashëgiminë kulturore dhe për të trajnuar njësi speciale të policisë kundër kësaj figure krimi.

Barazia gjinore

Do të ketë një angazhim efektiv të të gjithë institucioneve publike në luftën kundër dhunës ndaj grave, forcim të rolit të sistemit të drejtësisë në parandalimin dhe mbështetjen e viktimave të dhunës dhe dënimin e duhur të dhunuesve. Do të krijojmë një sistem kombëtar online të regjistrimit dhe monitorimit të rasteve të dhunës në familje dhe do të sigurojmë funksionimin e një linje kombëtare për viktimat e dhunës në familje. Riintegrim i grave dhe vajzave viktimat të dhunës nëpërmjet ofrimit të banesave sociale, punësimit, formimit profesional dhe ndihmës e shërbimeve sociale.

Ne synojmë të fuqizojmë pozitën e grave dhe vajzave përmes punësimit, nxitjes së sipërmarrjes, formimit dhe kualifikimit profesional të tyre. Do të afrojmë trajnime falas për të gjitha vajzat e papuna nën moshën 25 vjeç.

Do të zgjerojmë mbështetjen për nënat e reja në periudhën e parë të jetës së fëmijëve të tyre. Përfitimi i lejes së lindjes do të jepet për çdo nënë, pavarësisht nga kontributet në sigurimet shoqërore. Shteti dhe shoqëria do të ofrojnë kujdesje për fëmijën e sapolindur dhe për nënën.

Rinia

Dy në tre të rinj shqiptarë janë të papunë. Rinia, si pjesa më e madhe e shoqërisë shqiptare vuan shkallën më të lartë të papunësisë nga të gjithë grupmoshat. Tejet e rëndë është gjendja e punësimit dhe e mundësive të të rinjve në zonat rurale.

Do të krijojmë e zbatojmë Programin Kombëtar për Nxitjen e Sipërmarrjes Rinore dhe e Korpusit

Kombëtar të të Rinjve, si edhe themelimi i Programit të Formimit Profesional në Punë («çirakëria»).

Do të krijohet një fond i veçantë për rijetësimin e organizatave rinore, ngritjen e Qendrave Rinore, ku të rinjtë e talentuar do të ndihmohen e fuqizohen për zhvillimin e potencialit të tyre krijues.

Do të krijohen “Inkubatorët e Biznesit Rinor” që u mundësojnë të rinjve sipërmarrës hapësira për zyra, kryerjen e aktivitetit dhe lehtësira administrative.

Do të nxitet sistemi i kredive dhe mikrokredive, si dhe do të krijohen lehtësira fiskale për sipërmarrjet e të rinjve.

Kujdesi shëndetësor

Shërbimi i kujdesit shëndetësor është aktualisht nga shërbimet publike më të këqija për qytetarët shqiptarë. Shëndetësia shqiptare nuk arrin të realizojë asnjë nga funksionet e saj: nuk parandalon, nuk diagnostikon, nuk kuron dhe nuk rehabiliton.

Sistemi kontributiv i sigurimit të kujdesit shëndetësor ofron mbulim për më pak se gjysmën e popullsisë aktive në moshë pune. Për këtë arsye rreth 1 milion shqiptarë në moshë pune duhet të paguajnë nga xhepi i tyre për kujdesin shëndetësor, duke e shtuar pabarazinë dhe padrejtësinë sociale. Në 100 lekë që shpenzohen për shëndetësinë, vetëm 40 lekë financohen nga paratë publike. Financimi publik për shëndetësinë është i ulët dhe pjesa kontributive e tij është e ndërnuar mbi regresivitetin.

Sfida jonë është që t'u rikthejmë qytetarëve besimin e humbur tek shërbimi shëndetësor, t'u japim atyre mbrojtjen e merituar përmes një sistemi shëndetësor me mbulim universal dhe t'u krijojmë profesionistëve kushtet e nevojshme për të shërbyer me cilësi.

Ne e konsiderojmë kujdesin shëndetësor një të mirë publike dhe faktor themelor zhvillimi. Ne do realizojmë një sistem të kujdesit shëndetësor cilësor që ofron akses të plotë dhe garanton qëndrueshmëri financiare. Duke ndërmarrë një



reformë radikale ne do të ofrojmë një mbulim universal për kujdesin shëndetësor për gjithë shqiptarët rezidentë ku asnjë individ të mos mbetet pa kujdes shëndetësor, sepse nuk disponon mjetet e nevojshme financiare.

Ne do të zbatojmë një qasje të integruar në kujdesin shëndetësor, duke e bashkërenduar me politikat e sportit, mbrojtjes sociale, të sigurisë në punë, ruajtjes së mjedisit, të planifikimit dhe rregullimit të territorit, përfshire transportin dhe komunikacionin. Do të mbështesim funksionimin e mekanizmave koordinues ndërsektoriale për problemet madhore të shëndetit publik si përdorimi i drogës, abuzimi me alkoolin, duhanpirja, siguria rrugore, siguria ushqimore dhe kequshqyerja, sëmundjet infektive të reja si dhe ato të neglizhuara, menaxhimi strategjik i kimikateve, faktorët mjedisore, ndryshimet klimaterike.

Ne do të jemi promotorët e solidaritetit social midis të shëndetshmeve dhe të sëmurëve. Jemi të vetdijshëm se fillimisht duhet të dëshmojmë publikisht se çdo qindarkë e kontributit të përgjithshëm shpenzohet me efektivitet dhe jep përmirësim të matshëm të jetës së shëndetshme. Njëherazi do të kërkojmë zhvillimin e përgjegjësive individuale të çdo anëtarit të shoqërisë për kujdes shëndetësor individual, zhvillimin e përgjegjësive civile të ofruesve të mallrave dhe shërbimeve që ndikojnë drejtpërdrejt në shëndetin e individëve, si dhe rritjen e përgjegjësive të aktorëve që krijojnë efekte anësore negative në shëndetin e individëve.

Do të heqim tatimin mbi vlerën e shtuar në shërbimet dhe mallrat mjekësorë me efekt nga fillimi i vitit 2014. Do të arrijmë tek financimi i kujdesit shëndetësor me taksimin e përgjithshëm, duke eliminuar fillimisht regresivitetin në pagesën e kontributeve të sigurimit të detyrueshëm të kujdesit shëndetësor.

Sistemi i sotëm i financimit të shëndetësisë stimulon korrupsionin, burokracinë e tepruar dhe diskriminimin në masë. Paratë publike, edhe pse të pamjaftueshme, shpërdorohen, ndërsa qytetarët paguajnë nën dorë për të marrë shërbime thelbësive jetike.

Do të ndërtojmë Shërbimin Kombëtar

Shëndetësor që do të jetë **paguesi i vetëm** i shërbimit të kujdesit shëndetësor, duke siguruar që askush të mos përballë me pengesa financiare, moshore, gjinore, gjeografike apo kulturore në marrjen e shërbimit të kujdesit shëndetësor. Kujdesi shëndetësor do të financohet nga taksimi i përgjithshëm.

Ne do të rrisim rolin e shëndetit publik dhe programeve të parandalimit e të promovimit shëndetësor. Sëmundjet jontëzore kanë rritur përhapjen në Shqipëri, ku veçanërisht sëmundjet kardiovaskulare dhe tumorale janë kthyer në ndikues të ndjeshëm në shkurtimin e jetëgjatësisë dhe jetës së shëndetshme. Synimi ynë primar është zgjatja e viteve të shëndetshme të jetës së popullatës shqiptare dhe parandalimi i fataliteteve të parakohshme duke rivendosur, ruajtur dhe përmirësuar shëndetin.

Do të zhvillojmë programe kombëtare të parandalimit dhe zbulimit të hershëm të sëmundjeve tumorale dhe sëmundjeve kardiovaskulare. Brenda vitit 2014 do të fillojë zbatimi i një programi kombëtar për kontrollin bazë të shëndetit për popullsinë në intervalin moshor 40-60 vjeç si dhe në mosha më të reja për disa shtresa të veçanta të shoqërisë.

Si rrjedhojë e politikave shëndetësore pa vizion, të disbalancuara e abuzive, konstatohet se shërbimi i kujdesit shëndetësor parësor tek ne, tradicionalisht, mbetet i nënvlefësuar, si shtojcë e shërbimit shëndetësor spitalor dhe ndeshet me probleme të rënda. Aktualisht zgjidhen vetëm 25% të problemeve shëndetësore të popullatës dhe këto të fundit, me cilësi të pamjaftueshme. Megjithatë milionat e harxhuara çdo vit për ndërtimin, ristrukturimin e pajisjen e qendrave shëndetësore, konstatohet se ato kanë probleme serioze në infrastrukturë, kushte higjieno-sanitare apo pajisje të vjetëruara e shpesh jashtë funksionimit. Kjo e detyron popullatën t'i drejtohet niveleve më të larta të shërbimit shëndetësor si poliklinikave dhe spitaleve, duke ulur efikasitetin e sistemit dhe rritur xhapat e qytetarëve. Mungesa e protokolleve të përshtatshme të mjekimit reflektohet në mënyrë të drejtpërdrejtë cilësinë e varfër të kujdesit shëndetësor parësor. Prandaj, hartimi dhe zbatimi rigoroz i protokolleve



bashkëkohore të mjekimit do të jetë një nga prioritetet kryesore të reformimit të kujdesit shëndetësor parësor.

Shërbimi i Urgjencës Mjekësore është në kushte të mjeruara; mbërrin me vonesë, është i pajisur keq pa mjetet e shpëtimit të jetës, personel të pakualifikuar, etj. Për pasojë është përgjegjës për humbje të dhjetëra jetëve pacientësh dhe paaftësi të niveleve të larta.

Do të ngrejmë një Shërbim Kombëtar të Urgjencës Mjekësore që të sigurojmë prezencë të shpejtë e profesionale në të gjithë territorin e vendit, duke vendosur standarde të njëjta në të gjitha qendrat pritëse duke iu përgjigjur nevojave të ndryshueshme gjatë stinëve të vitit për kujdes në sëmundshmëri dhe trauma.

Spitalet publike janë kthyer në vatra të shpërdorimit të parasë publike. Mungesa e barnave në spitalet tona është një dukuri kronike, aq sa shqiptarët po “mësohen” me faktin se në spital shkohet me barna me vete. Ne do të hapim kantierin e shëndetësisë, me qëllim modernizimin infrastrukturor dhe rritjen e sigurisë në spitale. Spitalet publike do të jenë jo vetëm vendet ku njerëzit mjekohen, por edhe qendra që mishërojnë solidaritetin e kulturën shoqërore. Protokollet e mjekimit dhe procedurat standarde të punës nuk ekzistojnë akoma zyrtarisht në spitalet tona duke na rritur ndjeshëm keqpërdorimin dhe abuzimin në barna dhe materiale mjekësore. Hartimi korrekt e shkencor dhe zbatimi i protokolleve të mjekimit e procedurave standarde të punës është hap i domosdoshëm në rritjen e transparencës, verifikueshmërisë, përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies, me qëllimin final, rritjen dhe përmirësimin gradual të cilësisë së shërbimit spitalor. Ky është një parakusht i domosdoshëm në përgatitjen e spitaleve që të kontraktojnë me pagesin e vetëm sipas metodave dhe praktikave më të mira ndërkombëtare. Do të vendosen parimet e qeverisjes klinike në spitalet tona, duke synuar standarde të larta të kujdesit, shërbime të efektshme, transparencë dhe llogaridhënie. Spitalet do të administrohen në mënyrë efektive dhe do të financohen në bazë të paketave të shërbimit që pagesi i vetëm do të kontraktojë për kujdesin e nevojshëm spitalor të çdo individit. Më

tej synojmë që të kalojmë nga pagesa e shërbimeve sipas kostove në zbatimin e “Algoritmeve Klinike” (Clinical Pathways) dhe më pas në vendosjen e DRG-ve (Diagnosis – Related Group). Të gjithë spitalet publike dhe jopublike do t’i nënshtrohen procesit të akreditimit fillestar dhe rivlerësimit periodik. Shërbimet spitalore universitare do të kenë rol parësor edhe në udhëheqjen profesionale të shërbimeve spitalore në të gjithë vendin.

Shërbimi dentar ofrohet nga ofrues jopublikë jashtë vëmendjes së nevojshme të shtetit. Do të vendosen standarde profesionale në ofrimin e këij shërbimi, do të garantohet siguria e materialeve mjekësore dentare dhe do të kërkohet rivlerësimi periodik i aftësive profesionale të mjekëve stomatologë.

Çmimet e barnave janë shpesh më të larta se në vendet e Bashkimit Evropian. Në zonat rurale shërbimi farmaceutik mungon. Ne do të ulim çmimin e shitjes së barnave në Shqipëri. Nuk do të ketë asnjë produkt farmaceutik të regjistruar që do të shitet në vendin tonë me një çmim më të lartë se në vendin e tij të origjinës. Ne do të rrisim cilësinë dhe sigurinë e barnave, duke shtuar kujdesin për indikacionet, në përputhje me standardet evropiane dhe njëkohësisht, do të rrisim kontrollin e cilësisë gjatë të gjithë zinxhirit të shpërndarjes të barnave. Ne do të zgjerojmë mbulimin me shërbim farmaceutik të kualifikuar në të gjithë vendin aty ku nuk ka mbulim me shërbim privat. Do të ngrejmë një sistem të plotë të gjurmimit (track and trace) të barnave në territorin e vendit, duke siguruar që barnat dhe materialet mjekësore të nevojshme të arrijnë tek pacienti i duhur, në kohën e duhur, në dozën e duhur dhe nëpërmjet një kanali shpërndarjeje të autorizuar. Qendra e Kontrollit të Barnave do të shëndrrohet në Agjencinë Kombëtare të Barnave dhe Materialeve Mjekësore.

Informacioni për shëndetin, treguesit e shëndetit dhe kujdesin shëndetësor, lidhja e tyre me tregues bazë sociale, në nivel individual dhe kombëtar është i mangët, i pasaktë, i fragmentarizuar dhe jokoherent. Për pasojë, edhe vendimmarrja realizohet në mënyrë joprofesionale. Do të ngremë një sistem unik dixhital shëndetësor, me të cilin do të ndërliken të gjithë aktorët e sistemit shëndetësor, publikë dhe privatë. Në qendër të



sitemit do të jetë individi dhe dosja e tij elektronike shëndetësore. Dixhitalizimi i infomacionit për shëndetin dhe kujdesin shëndetësor do të përdoret edhe për të rritur ndjeshëm transparencën në komunikimin me publikun për gjendjen e shëndetit të popullatës, për përdorimin e burimeve të disponueshme, për të filluar zbatimin e standardeve të llogaridhënies së hapur të zyrtarëve publikë dhe të ofruesve të shërbimit si dhe të vendosjes së besimit midis popullatës, ofruesve të shërbimit dhe zyrtarëve të lartë. Do të zbatohet periodikisht mbajtjen e Llogarive Kombëtare të Shëndetësisë.

Do të zgjerohet më tej bashkëpunimin me shëndetësinë jopublike si komplementare në përmbushjen e qëllimit të përmirësimit të kujdesit shëndetësor. Institucionet jopublike do të zbatohet të njëjtat rregulla dhe procedura të akreditimit, rivlerësimit periodik, këmbimit të informacionit shëndetësor klinik dhe individual. Do të kërkohet zbatimi i protokolleve të mjekimit për shërbimet që paguesi i vetëm do të blejë në institucionet jopublike. Do të zgjerohet partneriteti publik-privat në kujdesin shëndetësor, duke synuar përfshirjen në shërbimet bazë, përveç shërbimeve mbështetëse.

Ne jemi vendosmërisht në krah të mjekëve, infermierëve dhe profesionistëve të shëndetit. Respektojmë përkushtimin me të cilin ata kujdesen për shëndetin e bashkëqytetarëve të tyre. Prandaj, do të vendosim një bashkëbisedim të përhershëm me ta, për të adresuar të gjitha çështjet që lidhen me formimin e tyre, kërkimin shkencor, autonominë profesionale, përfshirjen në qeverisjen dhe mbarëvajtjen klinike, pa lënë mënjanë nevojën për të plotësuar boshllëqet e krijuara në vite në trupën mjekësore të vendit. Urdhërat e profesionistëve të shëndetësisë do të reformohen duke u qeverisur me standarde të njëjta, duke u kërkuar të kenë rol më madh në rritjen e vazhdueshme të cilësisë së kontrollit të profesionsitëve të shëndetësisë.

Kujdesi dhe përfshirja sociale

28% e fëmijëve në Shqipëri jetojnë në familje të varfra që përfitojnë ndihmë ekonomike.

Një në tre fëmijë është aktualisht në nevojë, por vetëm një e treta përfitojnë shërbime dhe përkuajdesje. Mbi 50 mijë fëmijë të moshës së arsimit të detyrueshëm janë të detyruar të punojnë në punë familjare. Gjendja e fëmijëve romë e egjiptianë është e mjerueshme. Varfëria reale në Shqipëri është rreth 40%. Në zonat kodrinore e malore është mbi 50%. Varfëria reale e matur në kontekstin e fuqisë blerëse është mbi 62%, më e larta në rajon. Shqipëria është një nga vendet me indeks të ulët të barazisë gjinore, duke u gjendur në të njëjtën renditje me Zimbabvet, Libanin, Kamboxhian dhe Bangladeshin. Shumë gra dhe vajza shqiptare përballen më shumë se burrat me varfëri e papunësi. Diskriminimi gjinor është i gjithëpranishëm në vend.

Ne besojmë në energjinë e pashtershme dhe forcën transformuese e krijuese të secilit qytetar shqiptar. Ndaj me një agjendë sociale që na ngarkon të drejta e detyra të gjithëve, duam të ndërtojmë shoqërinë, ku energjia, kreativiteti e munda i secilit të gjejë hapësirë jetësimi, përmes shtetit që ofron shërbime publike sipas nevojës. Është mision i qeverisjes socialiste që t'i sigurojë çdo qytetari shqiptar pavarësisht të ardhurave, origjinës, moshës, gjinisë, etnisë, edukimit, orientimit seksual, identitetit kulturor, bindjeve politike e fetare, shërbime publike cilësore.

Kujdesi i veçantë për fëmijët dhe adoleshentët jetimë socialë dhe biologjikë, që në moshën 16-vjeçare dalin nga institucionet e përkuajdesit. Brenda mandatit të parë, strehim dhe punësim në kushte të përshtatshme për të gjithë jetimët që aktualisht janë të papunë e të pastrehë. Brenda mandatit të parë, strehim dhe punësim në kushte përshtatshme të jetimëve që dalin periodikisht nga institucionet rezidenciale.

Do të hartojmë paketën rregullatore për transformimin e Programit të Ndihmës Ekonomike në një Program për e Riintegrimin Social. Përcaktim i masës së pagesës nga Programi i Riintegrimit Social për individë dhe jo për familje. Masa e pagesës nga Programi i Riintegrimit Social do të synojë kapërcimin e vijës së varfërisë.

Programi i Riintegrimit në zonat rurale do të zëvendësojë pagesat e Ndihmës Ekonomike me



Programin “Punë në Vend të Asistencës.” Kjo do të gjenerojë punë për përfituesit e Programit të Riintegritimit Social pranë komuniteteve të tyre, njësitë e qeverisjes vendore apo projekte të qeverisjes qendrore.

Fondi Social do të jetë vëmendje e veçantë dhe sigurim i burimeve të nevojshme për grupet më të rrezikuara nga përjashtimi. Krijim i Fondit Kombëtar për Shërbimet Sociale dhe Fondeve Rajonale për Shërbimet Sociale si pjesë e Fondit Social.

Do të anulohet të gjitha ndryshimet ligjore që kanë sjellë kufizimin e të drejtave të përfaqësimit të Personave me Aftësi të Kufizuar.

Do të organizohen shërbimet e parandalimit, ndërhyrjes dhe riintegritimit të fëmijëve në familje e komunitet, brenda mandatit të parë të qeverisjes. Nxitje e programeve të sigurimit të ushqimit për fëmijët e varfër dhe të zonave të thella e të vështira klimaterike, pavarësisht të ardhurave të familjes. Shërbime për fëmijët që do të mbështesin përgjegjësinë e përbashkët prindërore dhe do të lehtësojnë prindërit në tregun e punës.

Do të identifikojmë të gjithë fëmijët në situatë rruge, sigurojmë të drejtën e tyre për identitet, dhe organizojmë lëvizjen e tyre të menjëhershme nga rruga në bashkëpunim me pushtetin vendor, njësitë e mbrojtjes së fëmijëve dhe organizatat e shoqërisë civile. Do të krijojmë një program elektronik për regjistrimin në lindje të të gjithë fëmijëve dhe sigurim i regjistrimit të të gjithë fëmijëve nga shtresa vulnerabël në Regjistrin e Gjendjes Civile.

Do të themelojmë zyrën për partneritet me organizatat me bazë besimi, e cila do të synojë forcimin e organizatave komunitare dhe me bazë besimi dhe zgjerimin e kapaciteteve në ofrimin e shërbimeve sociale.

Do të institucionalizojmë sistemin shtetëror për mbledhjen e të dhënave për komunitetin rom dhe egjiptian, si dhe do të sigurojmë regjistrimin e tyre në Regjistrin e Gjendjes Civile në mënyrë që të lehtësojmë procedurat për përfitimin e Ndihmës Ekonomikë për këtë shtresë.

Ish të përndjekurit politikë

Ne marrim përsipër t'i japim fund hipokrizisë dhe abuzimit njëzetëvjeçar me të përndjekurit politikë. Ne do të bashkëpunojmë me ta për ta mbyllur me dinjitet plagën e hapur të moskompensimit të tyre. Skema jonë e re e kompensimit për të përndjekurit politikë do të zgjerojë grupin e përfituesve dhe do të zbatojë një shpërblim progresiv, në varësi të viteve të dënimit dhe moshës aktuale të ish të përndjekurve. Do të ketë një vlerësim transparent të detyrimeve ndaj ish të përndjekurve. Politikat tona publike dhe sociale do të respektojnë Statusin e ish të Përndjekurit. Të gjitha shërbimet publike për ish të përndjekurit do të përballohen nga shteti.

Ne do të ngremë një institucion evropian të kujtesës historike që do të dokumentojë dhe bëjë të aksesueshme për publikun historinë e persekutimit nën regjimin komunist.

Veteranët dhe invalidët e luftës antifashiste

Socialistët janë bartës të vlerave më të mira të patriotizmit shqiptar dhe të atdhetarizmit të veteranëve të Luftës Nacionalçlirimtare. Ne nderojmë historinë tonë kombëtare dhe Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare me heronjtë e dëshmorët e vet, si një faqe të ndritur të historisë, ku roli i veteranëve të luftës mbetet një pikë referimi e palëvizshme. Veteranët çliruan vendin nga terrori nazifashist dhe e rreshtuan Shqipërinë në anën e duhur të historisë, krah për krah me të gjitha fuqitë e mëdha çlirimtare. Me mundin dhe sakrificat e tyre, ata kontribuan për zhvillimin e vendit dhe krijuan kulturën e punës e të shërbimit ndaj atdheut.

Politikat tona publike dhe sociale do të respektojnë Statusin e Veteranit. Shërbimi dhe kujdesi ndaj veteranëve do të jenë prioriteti ynë i patjetërsueshëm social. Të gjitha shërbimet publike për veteranët do të jenë falas.

Sigurimet shoqërore

Sistemi i sigurimeve shoqërore vuan nga probleme themelore. Midis tyre janë pensionet e ulëta me të cilat pensionistët nuk mund të përballojnë jetesën, raporti problematik kontribues-përfitues,



koeficienti shumë i ulët i zëvendësimit pension-pagë dhe bllokimi i skemave të pensioneve suplementare, sidomos i atyre të profesioneve të vështira.

Do të realizojmë reformë në fushën e pensioneve, të përqendruar në konsolidimin e sistemit aktual të sigurimeve shoqërore. Reformë në fushën e pensioneve që kontribuon në zgjidhjen e problemit të papunësisë dhe informalitetit. Sigurim i raportit optimal midis përfitimeve maksimale e minimale, në nivele të qëndrueshme.

Fillimi i negociatave dypalëshe me shtetet e tjera për të arritur në një marrëveshje për të siguruar mundësinë e transferimit të sigurimeve shoqërore për emigrantët shqiptarë që kthehen në atdhe.

Do të zgjidhim ngerçin ligjor të pensioneve të ushtarakëve në lirim. Do të përcaktojmë të drejtat e tyre në bazë të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese.

Do të miratojmë statutet e profesioneve të vështira për të harmonizuar kontributet specifike me të drejtat e përgjithshme sociale.

Strehimi

Strehimi social do të jetë prioritet për qeverinë.

Pas një vlerësimi të kujdesshëm ligjor, do të shpërndahen me transparence apartamentet e ndërtuara.

Do të përmirësojmë legjislacionin për strehimin, për të garantuar që strehimi, si një e drejtë themelore, të ofrohet me cilësi, me efikasitet energjitik dhe të jetë i përballueshëm për të gjitha shtresat, edhe ato në nevojë.

Do të realizohet një zgjidhje defnitive e strehimit për familjet që mbetën të pastreha nga akti normativ i nëntorit të 2012-s.

Do të punojmë për të ristrukturuar programin e kreditimit të lehtësuar dhe për të ngritur partneritete publiko-private që mbështetin sektorin e strehimit social.

Do të krijojmë partneritete publiko-private, duke realizuar vënien në shërbim të kërkesës për banesa sociale të stokut të pashitur të industrisë së ndërtimit rezidencial.



**PËRBËRJA
E KËSHILLIT
TË MINISTRAVE**



EDI RAMA

KRYEMINISTËR

Edi Rama ka lindur në Tiranë, më 4 korrik 1964. Ai është i martuar me zonjën Linda Rama dhe kanë dy fëmijë, Gregun dhe Rean.

Edi Rama ka një karrierë të larmishme në arte, sport, mësimdhënie, publicistikë dhe politikë. Ka qenë pedagog i pikturës në Akademinë e Arteve, lojtar i ekipit kombëtar të basketbollit, autor i librave “Refleksione” në bashkëpunim me Ardian Klosin, botuar fill pas rënies së diktaturës, dhe “Kurban”, botuar në vitin 2011. Po ashtu, Edi Rama ka botuar edhe dy libra arti me krijimet e tij, në bashkëpunim me artistin e njohur Anri Sala, si edhe është autor e pjesëmarrës i shumë ekspozitave nëpër botë.

Përfshirja e Edi Ramës në jetën publike dhe politike zë fill me lëvizjen për demokraci që rrëzoi regjimin komunist në Shqipëri, ku ai ishte një nga zërat më të spikatur publikë, por edhe një drejtues i njohur i lëvizjes studentore në Akademinë e Arteve.

Pas një largimi disa vjeçar jashtë Shqipërisë, ku iu përkushtua jetës artistike, por kritik aktiv në shtyp i qeverisjes së parë post-komuniste, Edi Rama hyri në politikë si Ministër i Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, në vitin 1998. Gjatë periudhës që drejtoi këtë ministri ai fitoi mbështetjen dhe vlerësimin e publikut shqiptar për mënyrën kreative dhe të efektshme të promovimit të artit dhe kulturës në Shqipëri.

Në vitin 2000 Edi Rama kandidoi për Bashkinë e Tiranës me mbështetjen e Partisë Socialiste, duke shënuar një fitore të thellë ndaj rivalit të tij. Pas fitores ai ndërmoi një fushatë transformimi dhe rigjenerimi të kryeqytetit, duke rikthyer hapësirat publike të pastruara nga ndërtimet pa leje, duke shtuar hapësirat e gjelbra dhe përgjithësisht, duke sjellë një vizion dhe frymë të re administrimi të punëve të kryeqytetit. Nën lidërshpinin e Edi Ramës, Bashkia e Tiranës u kthye në një institucion modern evropian. Projektet e tij për futjen e ngjyres në hapësirën publike përmes fasadave të rrënuara të banesave popullore të periudhës komuniste, rehabilitimi i shtratit të Lumit Lana, shtimi i parqeve dhe hapësirave të gjelbra në kryeqytet dhe rindërtimi me standarde të reja projektimi i rrjetit rrugor të Tiranës, janë vlerësuar me një sërë çmimesh ndërkombëtare, ku mund të përmenden World Mayor Award (2004) dhe European Hero Award i revistës Time. Edi Rama u rizgjodh sërish Kryetar i Bashkisë Tiranë në vitin 2003 dhe 2007 dhe për 11 vjet drejtoi kryeqytetin e Shqipërisë.

Në vitin 2005, Edi Rama u zgjodh Kryetar i Partisë Socialiste të Shqipërisë, të cilën e udhëhoqi gjatë viteve të vështira në opozitë dhe në fitoren plebishitare të 23 qershorit 2013.



NIKO PELESHI

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

Niko PELESHI, Zëvendëskryeministër i Republikës së Shqipërisë prej Shtatorit 2013

Z. Niko Peleshi ka lindur në Korçë , më 11 Nëntor 1970. Ai është i martuar me znj. Amarda Peleshi dhe kanë tre fëmijë Aleksian, Stivin dhe Johanin.

Ka kryer studimet e larta për Inxhinieri Elektronike në Universitetin Politeknik të Tiranës me rezultate të shkëlqyera duke marrë titullin Inxhinier Elektronik. Në vitin 1989 ka përfunduar shkollën e mesme të përgjithshme “Raçi Qirinxhi” në Korçë me Medalje të Artë.

Z. Peleshi ka patur një angazhim të gjatë në fushën e biznesit privat në qytetin e Korçës, si dhe në vitet (2001-2004) ka drejtuar me sukses Dhomën e Tregëtisë dhe Industrisë Korçë.

Karriera politike e Z. Peleshi fillon në Tetor të 2004-ës, kur emërohet Prefekt i Qarkut Korçë dhe e ushtron këtë funksion përreth 1 vit. Në vitin 2005, zgjidhet Kryetar i Partisë Socialiste të qytetit të Korçës. Në zgjedhjet lokale të Shkurtit 2007 zgjidhet Kryetar Bashkie i Korçës, për tu rikonfirmuar edhe njëherë si Kryetar Bashkie në zgjedhjet lokale të 2011-s. Prej vitit 2012 është anëtar i kryesisë së Partisë Socialiste.

Në vitin 2013 zgjidhet anëtar me të drejta të plota i Komitetit të Monitorimit të Kongresit të Autoriteteve Vendore dhe Rajonale të Këshillit të Europës.

Zotëron shumë mirë gjuhën angleze. Flet rrjedhshëm gjermanisht dhe greqisht.



MIMI KODHELI

MINISTRE E MBROJTJES

Ministre e Mbrojtjes e Republikës së Shqipërisë prej Shtatorit 2013

Znj. Mimi Kodheli ka lindur në Tiranë, më 11 Shtator 1964. Ajo është e martuar me Lekën dhe kanë një djalë, Mikelin.

Znj. Kodheli është Doktorante e Shkencave Ekonomike nga Universiteti i Veronës, Itali, në bashkëpunim me Universitetin e Tiranës, Fakulteti Ekonomik, prej vitit 2007. Ka një Master në Administrim Biznesi nga Universiteti i Lincoln, Nebraska, SHBA në bashkëpunim me Universitetin e Tiranës prej vitit 2000 si dhe është diplomuar në Universitetin e Tiranës, Fakulteti Ekonomik, Dega Financë në vitin 1986.

Znj. Mimi Kodheli ka hyrë në politikë në vitin 2002, kur edhe u bë Nënkyetare e Bashkisë së Tiranës. Në

vitin 2005, ajo u emërua Prefekte e Qarkut të Tiranës dhe në vitin 2009 u zgjodh Deputete e Kuvendit të Shqipërisë duke mbajtur pozicionin e Nënkyetares së Komisionit të Ekonomisë dhe Financës përgjatë gjithë legjislaturës. Që prej vitit 2007 e në vazhdim është Anëtare e Kryesisë së Partisë Socialiste.

Ajo është trajnuar në fusha të ndryshme si ato të tregjeve ndërkombëtare dhe të letrave me vlerë, tregjet e punës dhe të investimeve, trajnim për ndërmarrjet të vogla e të mesme, ekzaminim dhe menaxhim bankar. Ajo ka marrë pjesë në një program të Departamentit Amerikan të Shtetit të titulluar “Gratë në Politikë” si dhe atë të titulluar “Politikat e Sigurisë Kombëtare” - Qendra Europiane e Sigurisë, Marshall.

Znj. Kodheli zotëron gjuhën angleze dhe italiane, si dhe njeh mjaftueshëm gjuhën frënge dhe spanjolle.



SAIMIR TAHIRI

MINISTËR I BRENDSHËM

Ministër i Brendshëm i Republikës së Shqipërisë prej Shtatorit 2013.

Z. Saimir Tahiri u lind më datë 30 Tetor 1979, në Tiranë. Është i martuar me Fatlindën dhe ka një djalë me emrin Drini.

Vazhdon studimet për mbrojtjen e Gradës Doktor Shkencash, në fushën e së Drejtës Parlamentare në Shqipëri. Ka përfunduar studimet Master për të Drejtë Publike pranë Departamentit të së Drejtës Publike në Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë. Është diplomuar për Jurisprudencë në Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë.

Në vitin 2009, zgjidhet përfaqësues në Parlament i

Partisë Socialiste për Qarkun Tiranë, në Legjislaturën e XVIII të tij. Gjatë kësaj legjislature ka mbajtur funksionin e Nënkryetarit të Grupit Parlamentar. Që prej vitit 2011, Saimir Tahiri zgjidhet dhe ushtron detyrën e Kryetarit të Partisë Socialiste për Tiranën. Gjatë periudhës 2009- 2013 ka qënë Anëtar i Komisionit Parlamentar për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

Që prej vitit 2008 mban titullin Avokat. Në vitet 2006-2008 ka qënë pedagog i jashtëm pranë Fakultetit të Drejtësisë dhe në disa institucione arsimore të larta.

Ka njohuri shumë të mira të gjuhës angleze dhe italiane.



DITMIR BUSHATI

MINISTËR I PUNËVE TË JASHTME

Ditmir BUSHATI, Ministër i Punëve të Jashtme të Republikës së Shqipërisë prej Shtatorit 2013

Z. Ditmir Bushati, lindi në Shkodër, më 24 Mars 1977. Ai është i martuar me znj. Aida Bushati (Gugu). Ata kanë dy fëmijë, Hera dhe Martin.

Z. Bushati është zgjedhur deputet në Qarkun e Tiranës në 2009-n dhe u rizgjedh sërish në të njëjtin qark në zgjedhjet e 23 Qershorit 2013. Ai ka shërbyer si Kryetar i Komisionit Parlamentar për Integrimin Europian (2011-2013) dhe anëtar i Komitetit të Përbashkët Parlamentar BE-Shqipëri (2009-2013). Prej 2011, ai është zgjedhur Anëtar i Kryesisë së Partisë Socialiste të Shqipërisë.

Z. Bushati është diplomuar me medalje të artë nga Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës (1999). Ai ka kryer studimet për Master në të Drejtën Ndërkombëtare Publike (LL.M.) në Universitetin e Leidenit, Holandë (2001). Z. Bushati ka qenë përfitues i bursave të programeve të ndryshme të studimit dhe kërkimit si: TEMPUS, NUFFIC, Victor Felsom, Kokalis. Ai ka qenë kërkues shkencor në të Drejtën Ndërkombëtare Publike pranë Institutit TMC Asser, Hagë, Holandë (2003) dhe kërkues shkencor në Çështjet Europiane, pranë Universitetit të Athinës, Greqi (2000). Ai ka kryer një sërë specializimesh për çështjet ndërkombëtare në disa institucione prestigjioze si: Universiteti i Harvardit; Akademia e së Drejtës Ndërkombëtare në Dallas, SHBA; Akademia Universitare Abo, Finlandë.

Përpara përfshirjes në politikë, z. Bushati ka qenë aktivist i shoqërisë civile. Ai ka drejtuar

Lëvizjen Europiane në Shqipëri. Ka ushtruar gjithashtu funksionin e Drejtorit të Përafrimit të Legjislacionit në Ministrinë e Integritimit Europian, duke qenë njëkohësisht pjesë e ekipit negociator të Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit (MSA); këshilltar i Zëvendëskryeministrit për Çështjet Europiane; këshilltar ligjor në Gjykatën Kushtetuese; Zyrën e Presidentit të Republikës së Shqipërisë; Tribunalin Penal Ndërkombëtar për ish Jugosllavinë, Hagë, Holandë.

Z. Bushati ka shërbyer si analist i Freedom House (2007-2008) për Raportin “Kombet në Tranzicion” (Nations in Transit); reporter kombëtar për Shoqatën Europiane të së Drejtës Ndërkombëtare (ESIL); koordinator kombëtar i Fondacionit për Shoqëri të Hapur (OSF) për monitorimin e ecurisë së Shqipërisë në procesin e integritimit evropian (2006-2008). Ai ka shërbyer si konsulent në projekte të ndryshme të BE, BB, USAID, GIZ, OSI, Fondacionit Friedrich Ebert, IOM, SNV.

Z. Bushati gjithashtu është lektor në të Drejtën Europiane dhe Procesin e Zgjerimit të BE-së pranë institucioneve të ndryshme universitare e kërkimore në Shqipëri e Kosovë. Ai ka botuar punime shkencore dhe artikuj në fushat e lidhura me procesin e zgjerimit të BE-së, të Drejtën Ndërkombëtare Publike dhe të Drejtën Europiane.

Z. Bushati është zotërues i gjuhës angleze dhe italiane e njohës i frengjishtes.



KLAJDA GJOSHA **MINISTRE E INTEGRIMIT EVROPIAN**

Klajda GJOSHA, Ministre e Integrimit Evropian e Republikës së Shqipërisë prej Shtatorit 2013

Znj. Klajda Gjoshë lindi në Tiranë, më datë 28 Korrik 1983. Ajo është e martuar me z. Ardian Gjoni.

Znj. Gjoshë u diplomua në vitin 2006 me titullin Master në degën Studime Europiane në Universitetin e Reading në Mbretërinë e Bashkuar.

Në vitin 2005 përfundoi studimet Bachelor në degën Politikë dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare në Universitetin e Reading, në Mbretërinë e Bashkuar.

Gjithashtu në vitin 2002, znj. Gjoshë përfundoi shkollën e mesme në nivelin e avancuar pranë Kolegjit Storde në Mbretërinë e Bashkuar.

Znj. Gjoshë ka shërbyer si Zëvendësministre e

Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta (2012-2013). Prej vitit 2012 ajo është Nënkryetare e Lëvizjes Socialiste për Integrim, Kryetare e Forumit të Gruas të LSI-së dhe Anëtare Kryesie e kësaj partie.

Znj. Gjoshë ka ushtruar disa funksione drejtuese në institucione të tjera si: Bashkia e Tiranës, Drejtoria Rajonale e Punësimit Tiranë dhe Agjencia Kombëtare e Turizmit.

Gjithashtu, znj. Klajda Gjoshë ka kryer disa trajnime dhe internshipe pranë disa organizmave si: Agjencia Ndërkombëtare e Bashkëpunimit Japonez, Parlamenti Evropian, pranë zyrës së znj. Doris Pack, Bruksel.

Ajo zotëron shumë mirë gjuhën angleze dhe në nivel mesatar gjuhën italiane.



SHKËLQIM CANI MINISTËR I FINANCËVE

Shkëlqim CANI, Ministër i Financave të Republikës së Shqipërisë prej Shtatorit 2013

Z. Shkëlqim Cani është lindur më 6 Maj 1956, në qytetin e Tiranës. Ai është i martuar me znj. Merita Cani.

Z. Cani, që nga vitit 2003, mban titullin “Profesor”. Në vitin 1991 fitoi gradën shkencore “Doktor në Ekonomi”, Universiteti i Tiranës, për studime të specializuara në fushën bankare. Në periudhën (1981- 1983) ka përfunduar Kursin e Plotë Pasuniversitar të Tregtisë Ndërkombëtare pranë Fakultetit të Ekonomisë, Universiteti i Tiranës. Studimet universitare i përfundoi në vitin 1980, në Fakultetin e Ekonomisë, Universiteti i Tiranës, dega Financë.

Karriera e tij politikë fillon në vitin 1991 si Zëvendëskryetar i Këshillit të Ministrave. Deputet i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë në Legjislaturën XII (1991- 1992) dhe në Legjislaturën XIII (1992-1996), ku ka qenë anëtar i Komisionit Parlamentar të Ekonomisë dhe Financës. U zgjodh Deputet në Legjislaturën e XV në vitin 1997, ku ka qenë anëtar i Komisionit të Lartë Parlamentar të Ekonomisë, Financës dhe Privatizimit, por që e dorëzoi mandatin për shkak të emërimit Guvernator i Bankës së Shqipërisë (1997-2004), ku për këtë periudhë, ka mbajtur edhe detyrën e Guvernatorit të FMN-së dhe MIGA-s për Shqipërinë. U zgjodh Deputet në

Legjislaturën e XIX në vitin 2013.

Z. Cani ka kryer detyra të rëndësishme shtetërore, si: Anëtar i Komisionit Ndërmintor të Politikave Ekonomike (1998-2004); Anëtar i Klubit të Guvernatorëve të Bankave Qendrore të Azisë Qendrore, Rajonit të Detit të Zi dhe të Ballkanit dhe Zëvendëskryetar i këtij Klubi; Zëvendëskryetar i Komitetit Qeveritar të Borxhit të Jashtëm (1997-2004); Kryetar i Bordit të Bursës së Tiranës (1997-2002); Anëtar i Bordit Ekzekutiv të Lion’s Club (1994-1997) Drejtor i Përgjithshëm i Bankës Tregtare të Shqipërisë (1990-1991); Drejtor i Departamentit të Jashtëm dhe Anëtar i Bordit i Bankës së Shtetit Shqiptar (1985-1990).

Në vitin 1994, nga kolegji Heidelbergense Tiffinae, Ohioensis, SHBA, ka fituar certifikatë për studime në fushën politike dhe në politikat qeveritare (Qershor) dhe certifikatë të studimeve në Administrim Biznes (Maj). Në periudhën Janar – Mars 1989 ka ndjekur kursin e thelluar për politikat e analizës së kreditit, kuadrin ligjor dhe institucional të garancive financiare të eksportit pranë Deutsche Bundesbank dhe KfW, Gjermani. Kurse në periudhën Shkurt – Maj 1985 ka ndjekur kurs për politikat dhe instrumentet bankare pranë Laenderbank, Vjenë, Austri.

Njih shumë mirë gjuhën angleze. Ka njohuri të gjuhëve italiane, frënge, gjermane dhe ruse.



EDMOND HAXHINASTO

MINISTËR I TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS

Edmond HAXHINASTO, Ministër i Transportit dhe Infrastrukturës i Republikës së Shqipërisë prej Shtatorit 2013

Z. Edmond Haxhinasto lindi në Tiranë, më 16 Nëntor 1966. Ai është i martuar me znj. Enkeleida Haxhinasto dhe kanë një vajzë, Elizën.

Eshtë diplomuar në Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë, në degën Anglisht, në 1989. Në 1996 mori titullin Master në Administrim Biznesi për nivelet Ekzekutive, në Slloveni, ndërsa, në vitin 2000, kreu Master në Politikë Publike, nga Shkolla “Woodrow Wilson” e Universitetit Princeton, në SHBA.

Në vitin 2004 ishte ndër themeluesit e Levizjes Socialiste për Integrim, ku ka mbajtur pozicionet e Sekretarit për Marrëdhëniet Ndërkombëtare, Kryetarit të Komitetit Drejtues Kombëtar si dhe postin e Zëvendëskryetarit. Z. Haxhinasto është anëtar i Kryesisë së LSI, Sekretar Politik për Qarkun e

Elbasanit.

Gjatë viteve 2009 - 2010 ka shërbyer si Zëvendësministër i Punëve Publike dhe Transporteve. Më pas gjatë periudhës 2010-2012 ka mbajtur postin e Ministrit të Jashtëm të Republikës së Shqipërisë. Nga viti 2012, deri në vitin 2013, ka mbajtur postin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjisë.

Nga Janari 2011 deri në Prill 2013 ka mbajtur postin e Zëvendëskryeministrit të Republikës së Shqipërisë.

Ai ka shërbyer në disa detyra të tjera të rëndësishme si: Përfaqësuesi i Qeverisë në Grupin e Menaxhimit të Emergjencave të ngritur për situatën e Refugjatëve kosovarë në Shqipëri, Këshilltar Diplomatik i Kryeministrit të Shqipërisë, i Ngarkuar me Punë të përhershëm në Ambasadën Shqiptare në Beograd.

Z. Edmond Haxhinasto zotëron shumë mirë anglishten dhe italishten.



EGLANTINA GJERMENI

MINISTRE E ZHVILLIMIT URBAN DHE TURIZMIT

Eglantina GJERMENI, Ministre e Zhvillimit Urban dhe Turizmit e Republikës së Shqipërisë prej Shtatorit 2013

Znj. Eglantina Gjermeni ka lindur në qytetin e Krujës, në vitin 1968. Ajo është e martuar me z. Marian Gjermeni dhe kanë 2 fëmijë, Erik dhe Megi.

Aktualisht znj. Gjermeni mban titullin e Doktorit të Shkencave në Punë Sociale.

Titullin Master në Punë Sociale e mori në Universitetin Grand Valley State University në Michigan, SHBA në vitet 1997-1998. Studimet pasuniversitare për degën Punë Sociale i kreu në Fakultetin e Shkencave Sociale në Universitetin e Tiranës në vitet 1993-1994.

Studimet e larta i kreu në Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë në degën Histori, në vitet 1986 – 1990.

Në vitin 2009 Eglantina Gjermeni u zgjodh për herë të parë deputete e Partisë Socialiste në legjislaturën e XVIII të Kuvendit të Shqipërisë. Rizgjidhet në mandatin e saj të dytë në legjislaturën e XIX në zgjedhjet e përgjithshme të mbajtura në vitin 2013.

Në vitin 2011, znj. Gjermeni zgjidhet si Anëtare Kryesore e Partisë Socialiste të Shqipërisë. Gjatë

mandatit të saj të parë si deputete, ka qënë anëtare e Komisionit të Shëndetit dhe Çështjeve Sociale.

Për dhjetë vite me radhë ka drejtuar në mënyrë të suksesshme Qendrën “Aleanca Gjinore për Zhvillim”. Është një nga ekspertet më të njohura në vend për fushën e barazisë gjinore dhe çështjeve sociale. Znj. Gjermeni është autore e shumë botimeve dhe publikimeve në këtë fushë brenda dhe jashtë vendit.

Përgjatë karrierës së saj znj. Gjermeni ka marrë pjesë dhe është kualifikuar në një sërë trainimesh brenda dhe jashtë vendit në tematika si: Barazia Gjinore, Menaxhim Projektesh, Liderhip, Gratë në Politike. Çështjet Sociale, të organizuara nga institute prestigjioze ndërkombëtare si: Qendra e Trajnimit ILO në Torino, Qendra e Trajnimit për Zhvillimet Gjinore në Holandë, Grand Valley State University në SHBA, Central European University në Hungari, Fondacioni Soros, etj.

Prej vitit 1995 vijon të jetë Pedagoge pranë Departamentit të Punëve Sociale, në Fakultetin e Shkencave Sociale në Universitetin e Tiranës.

Zotëron shumë mirë gjuhën angleze dhe atë italiane.



ARBEN AHMETAJ

MINISTËR I ZHVILLIMIT EKONOMIK, TREGTISË DHE SIPËRMARRJES

Arben AHMETAJ, Ministër i Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes prej Shtatorit 2013

Z. Arben Ahmetaj, ka lindur më 28 Qershor të vitit 1969, në qytetin e Gjirokastrës. Ai është i martuar me znj. Albina Mançka, dhe ka dy vajza, Livia dhe Kejsi.

Z. Ahmetaj mban titullin Doktor i Shkencave në fushën e Sigurisë Energjetike, Siguri Ndërkombëtare, prej Universitetit të Bukureshtit (2005-2009). Ai është diplomuar prej Universitetit të Tiranës për Gjuhë Angleze, i Specializuar në Literaturë Amerikane dhe Angleze, në vitin 1991. Ka kryer në vitin 1996, Master për Tregti Ndërkombëtare dhe Diplomaci në Patterson, Universiteti i Kentucky, SHBA.

Z. Arben Ahmetaj është Anëtar i Parlamentit Shqiptar, i zgjedhur në Legjislaturën XVIII-XIX Qarku Korçë -Gjirokastrë. Është pjesë e Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste dhe anëtar në Komisionin për Ekonominë dhe Financat. Në karrierën e tij të mëparshme ka mbajtur rolin e Zëvendësministrit në Ministrinë e Integritimit

European, (2004-2005) dhe rolin e Zëvendësministrit në Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë, (2003-2004).

Ka kryer funksionin e Drejtorit të Përgjithshëm të Drejtorisë së Tatimeve të Shqipërisë dhe ka qënë përgjegjës për hartimin e politikave të reja dhe të legjislativionit të ri (Kodi i ri fiskal, akcizat dhe legjislacioni i ri për taksën e drejtpërdrejtë). Në vitet 1992-1993, ka kryer funksionin e Këshilltarit të Ministrit të Financave si dhe asistent i thesarit të SHBA.

Gjithashtu z. Ahmetaj ka marrë pjesë dhe ka kryer projekte studimi me Universitetin e Georgetown, Edmund Walsh School of Foreign Service, Washington, SHBA, Universiteti Harvard, Menaxhimin e Konfliktëve në Kohën e Teknologjisë së Informacionit (Athinë). Ai është autor i një sërë punimesh shkencore.

Ai zotëron shumë mirë gjuhët angleze, italiane, greke, si dhe është njohës i gjuhës ruse.



LINDITA NIKOLLA

MINISTRE E ARSIMIT DHE SPORTIT

Lindita NIKOLLA, Ministre e Arsimit dhe Sportit e Republikës së Shqipërisë prej Shtatorit 2013

Znj. Lindita Nikolla lindi në Tiranë, më 22 Tetor 1965. Ajo është e martuar me z. Ligor Nikolla dhe ka një vajzë që quhet Livia.

Znj. Nikolla, në Korrik 2010, ka kryer studimet Master në administrim publik, drejtimi: pushtet ekzekutiv pranë Albanian University dhe në vitin 1989 ka përfunduar studimet universitare pranë Fakultetit të Shkencave të Natyrës, dega Matematikë, Universiteti i Tiranës.

Ajo ka hyrë në politikë në vitin 2003. Gjatë viteve 2003-2006, është zgjedhur si Këshilltare e Këshillit të Njesisë Bashkiake Nr.1, Tiranë. Është zgjedhur për dy mandate në periudhën 2007- 2011 dhe 2011-

2013, Kryetare e Njesisë Bashkiake Nr.1 Tiranë. Në zgjedhjet e 23 Qershorit 2013 zgjidhet deputete e qarkut të Tiranës. Nga shtatori i vitit 2007 znj. Nikolla është anëtare e Kryesisë së Partisë Socialiste.

Në vitin 2006 ka përfunduar Akademinë për Udhëheqësi dhe Reformë pranë Institutit për Demokraci dhe Ndërmjetësim (NDI) në Tiranë dhe në Qershor të vitit 2008 ka kryer Akademinë mbi Policimin Komunitar dhe Qeverisjen Vendore në Universitetin e Pitsburgut, SHBA. Znj. Nikolla ka kryer gjithashtu një sërë kualifikimesh në menaxhimin e shkollës dhe mësimdhënien e matematikës, si dhe për fuqizimin e gruas në vendimmarrje.

Znj. Nikolla zotëron gjuhën angleze dhe një gjuhë frënge dhe italiane.



NASIP NAÇO **MINISTËR I DREJTËSISË**

Nasip NAÇO, Ministër i Drejtësisë i Republikës së Shqipërisë prej Shtatorit 2013

Z. Nasip Naço lindi në Skrapar, më 5 Prill 1961. Ai është i martuar me znj. Theodhora Naço, dhe kënë dy fëmijë: Betina dhe Franko.

Ai është diplomuar për Drejtësi në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës në 1992.

Në vitet 2008-2009, ai ka qënë Sekretar Politik i LSI-së, për Qarkun e Beratit.

Në legjislaturën e XVIII, zgjidhet deputet i Qarkut të Beratit, për Grupin Parlamentar të LSI-së, dhe në periudhën 2009-2011, ushtron detyrën e Zëvendëskryetarit të Kuvendit të Shqipërisë.

Në vitet 2011-2012 ai ushtron detyrën e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës. Më pas rizgjidhet Zëvendëskryetar i Kuvendit të Shqipërisë në Korrik 2012.

Z. Naço ka ushtruar disa detyra të rëndësishme shtetërore si: Prokuror në Prokurorinë e Rrethit Berat, Drejtor i Shërbimit Informativ në Ministrinë e Brendshme, Prokuror pranë zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm, Shef Sektori kundër Akteve Terroriste dhe Krimeve kundër Personit, pranë Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm, Drejtues i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës.

Z. Nasip Naço ka marrë pjesë në disa seminare dhe kurse trajnuese, të organizuara nga Zyra e Prokurorit të Përgjithshëm, nga Shkolla e Magjistraturës dhe jashtë vendit në Itali, Poloni, SHBA, Danimarkë, Gjermani, me tematika të ndryshme në fushën e së drejtës penale e procedurës penale, të përmbartimit gjyqësor, të policisë, etj.

Ai është njohës i gjuhës angleze dhe italiane.



MIRELA KUMBARO

MINISTRE E KULTURËS

Mirela KUMBARO, Ministre e Kulturës e Republikës së Shqipërisë prej Shtatorit 2013

Znj. Mirela Kumbaro Furxhi ka lindur në Tiranë, në vitin 1966.

Ajo është e martuar me z. Aleksandër Furxhi dhe është nënë e dy fëmijëve, Sara dhe Tom.

Ajo mban titullin Professore e Asociuar, të fituar në vitin 2012 në Universitetin e Tiranës, në fushën e gjuhësisë. Në vitin 2009 ka mbrojtur titullin Doktor i Shkencave në fushën e Studimeve Përkthimore pranë Universitetit të Tiranës. Ka mbrojtur Diplomën për Master në përkthim dhe komunikim ndërkulturor në vitin 1994, në E.S.I.T - Paris III, Universiteti i Sorbonne-Nouvelle, në Paris, Francë. Ka kryer studimet universitare dhe është diplomuar në Universitetin e

Tiranës në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja në fushën e letrave frënge, në vitin 1988.

Znj. Mirela Kumbaro Furxhi nuk vjen nga radhët e politikës, por nga karriera akademike dhe nga një angazhim i gjatë e aktiv në shoqërinë civile ku ka kontribuar në fushat e kulturës, arsimit dhe problemeve sociale.

Znj. Kumbaro është përkthyesë, publiciste dhe eksperte ndërkombëtare për projekte ndërkulturore dhe për programe kërkimore universitare, të ndërmarra nga organizatat ndërkombëtare si Bashkimi Evropian, Organizata Ndërkombëtare e Frankofonisë.

Ajo zotëron shumë mirë frëngjishten dhe italishten, si dhe mjaftueshëm anglishten.



ERION VELIAJ

MINISTËR I MIRËQENIES SOCIALE DHE RINISË

Erion VELIAJ, Ministër i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë i Republikës së Shqipërisë prej Shtatorit 2013

Z. Erion Veliaj lindi në Tiranë, më 17 Dhjetor 1979.

Studimet Bachelor i ka kryer për Shkenca Politike në Grand Valley State University në Miçigan të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Më pas ai përfundoi studiimet Master në Mbretërinë e Bashkuar pranë University of Sussex, me fokus tek Integrimi European.

Ai hyri në politikë pas një angazhimi të gjatë në shoqërinë civile, organizata ndërkombëtare dhe media. Në vitin 2003, z. Veliaj themeloi lëvizjen

“MJAFT”, një organizatë që unifikoi frymën aktiviste e protestuese të rinisë shqiptare e që në vitin 2004 mori dhe çmimin e Kombeve të Bashkuara për shoqërinë civile. Z. Erion Veliaj drejtoi lëvizjen “MJAFT” deri në nëntor të vitit 2007. Më pas Veliaj iu bashkua Iniciativës për Stabilitetin European, një organizëm kyç në promovimin e zgjerimit të BE-së.

Në vitin 2011, z. Veliaj iu bashkua kryesisë së Partisë Socialiste së Shqipërisë si Sekretar për Rininë dhe Emigracionin. Në zgjedhjet parlamentare të vitit 2013 ai u zgjodh deputet i Qarkut Gjirokastrë.

Z.Veliaj flet shumë mirë gjuhët angleze dhe italiane, si dhe njeh mirë gjuhët gjermane dhe frënge.



MILENA HARITO

MINISTRE PËR INOVACIONIN DHE ADMINISTRATËN PUBLIKE

Milena HARITO, Ministre për Inovacionin dhe Administratën Publike e Republikës së Shqipërisë prej Shtatorit 2013

Znj. Milena Harito u lind më 4 Tetor 1966, në Tiranë.

Ajo është e martuar me z. Isidor Shteto dhe ka dy fëmijë, një vajzë dhe një djalë.

Në vitin 1997 ka mbrojtur Doktoraturën në Teknologjitë e Informacionit dhe Komunikimit në Universitetin Paris VI, në Francë. Diplomën e Masterit në të njëjtën fushë (DESS – Diplôme d'études supérieures spécialisées) e ka kryer pranë të njëjtit universitet, Paris VI, në vitin 1993. Ndërsa studimet e larta pesëvjeçare i ka kryer në Tiranë, në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, me rezultate të shkëlqyera, nga viti 1984 në vitin 1989. Ka përfunduar studimet parauniversitare me medalje ari në shkollën e mesme të përgjithshme "Sami Frashëri" në Tiranë.

Karrierën e saj znj. Harito e ka filluar në Institutin e Informatikës në Tiranë si bashkëpunëtore shkencore në vitin 1989, për ta vazhduar më pas në Francë që nga Prilli i vitit 1991 deri në Shtator 1992, pranë një ndërmarjeje private në fushën e informatikës. Pas doktoraturës, u punësua në qendrën më të madhe kërkimore në Evropë në fushën e telekomunikacioneve, CNET, pranë operatorit France Telecom, në Paris. Karrierën e mëtejshme e vazhdoi brenda operatorit France Telecom-Orange, në drejtorinë e strategjisë e ngarkuar me marrdhëniet me rregullatorin francez dhe evropian, më pas si drejtore departamenti në disa sektorë që nga inovacioni deri tek implementimi i produkteve.

Znj. Harito u zgjodh deputete në Parlamentin Shqiptar në zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2013.

Znj. Harito flet shumë mirë frengjishten dhe mjaft mirë anglishten dhe italishten.



ILIR BEQAJ **MINISTËR I SHËNDETËSISË**

Ilir BEQAJ, Ministër i Shëndetësisë i Republikës së Shqipërisë prej Shtatorit 2013

Z. Ilir Beqaj u lind në Tiranë, më 18 shkurt 1968. Është i martuar me znj. Adriana Beqaj dhe ka një vajzë, Deborah.

Në vitin akademik 1999-2000, ka kryer studimet pasuniversitare për Administrim Ndërmarrje, në Institutin Francez të Menaxhimit pranë Universitetit Politeknik Tiranë.

Ka kryer studimet e larta universitare në Universitetin e Tiranës, në periudhën 1985-1990, ku është diplomuar për informatikë.

Në vitet 1990-1993 ka punuar në Bankën e Shqipërisë në detyrën e specialistit të informatikës e gjithashtu gjatë viteve 1993-1994 ka punuar në Njësinë e Informacionit Fiskal po në këtë Bankë. Gjatë periudhës 1994-2006, z. Beqaj ka punuar në Institutin e Siguri-

meve Shoqërore në detyra të ndryshme. Gjatë viteve 2003-2006 ka punuar në detyrën e Drejtorit të Përgjithshëm të Institutit.

Është zgjedhur deputet i Kuvendit të Shqipërisë në Qarkun e Shkodrës në legjislaturën 2009-2013. Në zgjedhjet e fundit Parlamentare të 2013-s zgjidhet deputet i Kuvendit të Shqipërisë i Qarkut Durrës.

Prej 2007-s është anëtar i Asamblesë Kombëtare të Partisë Socialiste.

Në periudhën 2007-2011 ka kryer detyrën e nënsekretarit për programin në Partinë Socialiste.

Nga viti 2011 është anëtar i Kryesisë së kësaj partie, si dhe Sekretar për programin në Partinë Socialiste.

Zotëron shumë mirë gjuhët e huaja angleze, frënge dhe italiane.



DAMIAN GJIKNURI

MINISTËR I ENERGJISË DHE INDUSTRIË

Damian GJIKNURI, Ministër i Energjisë dhe Industrisë i Republikës së Shqipërisë prej Shtatorit 2013

Z. Damian Gjikhuri lindi më 25 Maj 1972, në qytetin e Tiranës. Ai banon në Tiranë dhe është i martuar me Rovena Gjikhuri (Agolli) me të cilën ka një djalë të quajtur Aleks.

Ai është i diplomuar në Drejtësi në vitin 1994, në Universitetin e Tiranës dhe zotëron gradën Master në Politikë Publike dhe Ligj të lëshuar nga "NPS School" të Monterey, Kaliforni, SHBA (2004) dhe Kolegji i Ligjit Londër, Britani e Madhe (1996). Ai ka kryer edhe disa studime pasuniversitare në Qendrën për Politikën e Sigurisë në Gjenevë (2000) dhe të Drejtë Ndërkombëtare në Universitetin e Leidenit, Holandë (1994).

Gjatë aktivitetit profesional ka kryer dhe kurse të ndryshme profesionale në institucione të ndryshme arsimore dhe profesionale në SHBA dhe BE, në fushat e sigurisë, mjetet speciale të hetimit, hetimi penal, kontratat publike, koncesionet, politika publike, ligjet zgjedhore etj.

Z. Gjikhuri është anëtar i Partisë Socialiste që nga viti 2005 dhe është zgjedhur deputet në qarkun e Elbasanit (Gramsh) në vitin 2009 dhe 2013. Ai është

anëtar i Kryesisë së Partisë Socialiste dhe Sekretar për Çështjet Zgjedhore që nga viti 2011. Më parë, në vitin 2007 ai u zgjodh Nënkryetar për Çështjet Ligjore dhe Zgjedhore dhe bashkëautor i Kodit Zgjedhor 2008.

Gjikhuri ka qenë anëtar i Komisionit të Ligjeve të Kuvendit të Shqipërisë 2009-2013, si dhe bashkëkryetar i Komisionit të Reformës Zgjedhore 2011-2012.

Përpara zgjedhjes si deputet në vitin 2009, Z. Gjikhuri ka punuar si drejtues i një zyre ligjore dhe këshilltar ligjor për reformat rregullatore ekonomike në vend dhe rajon, financuar nga BE, USAID, GTZ, etj. Deri në vitin 2005, Z. Gjikhuri ka ushtruar funksione të ndryshme publike si: Drejtor i Kabinetit të Ministrit të Rendit Publik (2005), Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Mbrojtjes (2001-2005), Drejtor i Bashkëpunimit Ndërkombëtar dhe Marrëveshjeve në Ministrinë e Rendit Publik dhe kordinator kombëtar për çështjet e drejtësisë dhe të brendshme, për negociimin e hapjes së negociatave me KE (1999-2001), Drejtues i Planizim-Drejtimit në SHISH (1998), Gjyqtar i Shkallës së Parë (1995-1996), jurist në institucione të ndryshme (1994-1995).

Ai zotëron shumë mirë gjuhën angleze dhe mirë gjuhën italiane.



LEFTER KOKA

MINISTËR I MJEDISIT

Lefter KOKA, Ministër i Mjedisit i Republikës së Shqipërisë prej Shtatorit 2013

Z. Lefter Koka lindi në qytetin e Durrësit, më 4 Gusht 1964. Ai është i martuar me znj. Brunilda Koka me të cilën ka edhe tre fëmijë: Arbin, Rinën dhe Anën.

Z. Koka ka përfunduar studimet universitare pranë Fakultetit Ndërkombëtar të Shkencave Juridike në Strugë.

Në vitin 2000, pas një angazhimi të gjatë në sektorin privat, z. Koka zgjidhet Anëtar i Këshillit Bashkiak të Qytetit të Durrësit. Gjatë periudhës 2003-2007, z. Koka ka qenë Kryetar i Bashkisë Durrës e gjatë së njëjtës periudhë shërbeu edhe si anëtar i Këshillit të Qarkut Durrës.

Në zgjedhjet parlamentare të vitit 2009, z. Koka përfaqësoi votuesit e Qarkut Durrës në legjislaturën e XVIII të Parlamentit Shqiptar, nën siglën e Lëvizjes

Socialiste për Integrim.

Si deputet në legjislaturën e XVIII të Parlamentit Shqiptar, z. Koka shërbeu njëkohësisht si Kryetar i Grupit Parlamentar të Lëvizjes Socialiste për Integrim dhe si anëtar i Komisionit Parlamentar të Ekonomisë dhe Financave.

Nga viti 2009 e në vazhdim z. Koka ka shërbyer si Kryetar i Lëvizjes Socialiste për Integrim, dega Durrës dhe si anëtar i kryesisë qendrore të Lëvizjes Socialiste për Integrim.

Në zgjedhjet parlamentare të vitit 2013, z. Koka u rizgjodh si përfaqësues i Qarkut Durrës në legjislaturën e XIX të parlamentit shqiptar, nën siglën e Lëvizjes Socialiste për Integrim.

Z. Koka është njohës shumë i mirë i gjuhës italiane dhe njohës i gjuhës angleze.



EDMOND PANARITI

**MINISTËR I BUJQËSISË, ZHVILLIMIT RURAL
DHE ADMINISTRIMIT TË UJRAVE**

**Edmond PANARITI, Ministër i Bujqësisë,
Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave së
Republikës së Shqipërisë prej Shtatorit 2013**

Z. Edmond Panariti, lindi në Tiranë, më 1 Qershor të vitit 1960 dhe është i martuar me znj. Narin Panariti, me të cilën ka dy djem, Klajd dhe Bjorn Panariti.

Prof.Dr. Edmond Panariti, ka përfunduar studimet universitare në Universitetin Bujqësor të Tiranës, në vitin 1984. Ai mban gradën shkencore “Doktor i Shkencave” dhe titullin Profesor. Prof. Edmond Panariti ka kryer Studime të thelluara pasuniversitare gjatë viteve 1989-1992, pranë Shkollës Politeknike Federale (ETH) dhe Universitetit të Zyrihut në Zvicër. Në vitet 1995-2000, është fitues i dy bursave Fulbright për kërkim shkencor dhe ligjërime në Universitetet e Kentakit dhe të Misisipit në SH.B.A. Në vitet 1994-1998 dhe 2004, kryen studime të thelluara pasuniversitare në Universitetin Veterinar të Hanoverit

në Gjermani. Z. Edmond Panariti, ka një karrierë të gjatë profesionale në Institutin e Kërkimeve dhe Fakultetin e Mjekësisë Veterinare. Edmond Panariti, ka shërbyer si drejtues projekti në Organizatën Botërore të Shëndetësisë dhe aktualisht është Profesor titullar në Universitetin e Mjekësisë në Tiranë.

Z. Panariti, është anëtar i kryesisë së Lëvizjes Socialiste për Integrim që prej vitit 2004. Ai ka mbajtur funksionet e Kryetarit të Komitetit Drejtues Kombëtar dhe të Sekretarit për Bujqësinë dhe Mjedisin. Në vitin 2011, Prof. Panariti zgjidhet anëtar i Këshillit Bashkiak të Tiranës dhe më pas emërohet Zëvendëskryetar i Bashkisë së Tiranës. Në vitin 2012, emërohet Ministër i Jashtëm i Shqipërisë dhe njëkohësisht mbajti edhe postin e Presidentit të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës.

Prof. Edmond Panariti flet rrjedhshëm gjuhët angleze, gjermane, frënge dhe italiane.



ILIRJAN CELIBASHI

MINISTËR PËR MARRËDHËNIET ME PARLAMENTIN

Ilirjan CELIBASHI, Ministër për Marrëdhëniet me Parlamentin i Republikës së Shqipërisë prej Shtatorit 2013

Z. Ilirjan Celibashi u lind më 2 Tetor 1969, në Çorovodë, Skrapar. Ai është i martuar me znj. Ardiana Celibashi dhe kanë një vajzë, Telma.

Studimet e larta i kreu në Universitetin e Tiranës dhe në përfundim të tyre, në vitin 1992, u diplomua “Jurist”.

Në Korrik të vitit 1992, ai u emërua gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Fier, e më pas u emërua Kryetar i Gjykatës së Shkallës së Parë, Mallakastër, funksion të cilin e ushtroi deri në Janar të vitit 1998. Gjithashtu, ai ka shërbyer si gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit, Durrës.

Në Tetor 1998, u emërua Zëvendësministër i Rendit Publik. Në periudhën 2001-2006, ai u zgjodh Kryetar

i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Nën drejtimin e z. Ilirjan Celibashi, KQZ përgatiti dhe administroi zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të vitit 2001 dhe 2005, si dhe zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të vitit 2003.

Në zgjedhjet e përgjithshme për Kuvendin e Shqipërisë, të 23 Qershorit 2013, z. Celibashi u zgjodh deputet i Qarkut të Fierit, për Partinë Socialiste. Z. Ilirjan Celibashi ka marrë pjesë në një sërë kursesh dhe seminaresh për specializim në fushën e së drejtës.

Ai ka qenë pjesëmarrës dhe referues në takime dhe aktivitete të ndryshme brenda dhe jashtë vendit, si gjatë periudhës kur ai ushtronte funksionin e gjyqtarit, po ashtu edhe në periudhën kur ai ishte Kryetar i KQZ-së.

Z. Celibashi, zotëron shumë mirë gjuhët angleze dhe italiane.



BLEDI ÇUÇI

MINISTËR SHTETI PËR ÇËSHTJET E QEVERISJES VENDORE

Bledar Çuçi, Ministër Shteti për Çështjet e Qeverisjes Vendore i Republikës së Shqipërisë prej Shtatorit 2013

Z. Bledar Çuçi lindi në Tiranë, më 14 Nëntor 1970. Ai ka një djalë, Endi Çuçi.

Z. Çuçi përfundoi studimet pasuniversitare (Master) për menaxhim në Universitetin Hasselt në Belgjikë (1998); studimet e larta për Drejtësi në Universitetin e Tiranës (1995) dhe studimet në shkollën e mesme të përgjithshme “Petro Nini Luarasi” në Tiranë (1989).

Z. Çuçi ka shërbyer në disa funksione drejtuese ndër të tjera, si Kancelar i Gjykatës së Rrethit Tiranë në vitet 2000-2001. Ka qenë Këshilltar i Ministrit, Drejtësi i Drejtorisë Juridike dhe Integritetit dhe Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Pushtetit Vendor deri në fund të vitit 2005. Gjatë kësaj kohe z. Çuçi ka qenë edhe përfaqësues i qeverisë shqiptare në Komitetin për Demokracinë Lokale dhe Rajonale të Këshillit të Europës, Strasburg (2003-2005); anëtar i Grupit Negociator të Shqipërisë lidhur me nënshkrimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit mes Shqipërisë dhe Komunitetit European (2003-2006) dhe anëtar i Bordit të Drejtorëve të Institutit për Trajnimin e Administratës Publike në Shqipëri (2003-2005).

Gjatë viteve 2006-2010, ai ka punuar si ekspert i pavarur për çështje të administratës publike, të reformës në drejtësi dhe të kuadrit ligjor për biznesin në programe të financuara nga USAID, Departamenti për Zhvillim Ndërkombëtar i Mbretërisë së Bashkuar (DfID), Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) dhe BE-së Shqipëri dhe Kosovë. Në vitet 2010-2011, z. Çuçi ka qenë Drejtori Ekzekutiv i Shoqatës për Autonominë Vendore.

U aktivizua me strukturat drejtuese të PS-së që prej vitit 2007, kur u zgjodh anëtar i Asamblesë Kompartamentare të PS-së dhe kryetar i Komisionit të Asamblesë për Çështjet e Pushtetit Vendor. Ai u rizgjodh anëtar i Asamblesë së partisë edhe në vitin 2011. Në vitet 2011-2012, z. Çuçi ishte ekspert i PS-së në Komisionin e Posaçëm Parlamentar për Reformën Zgjedhore. Që prej Shkurtit 2012, ai mban detyrën e Nënsekretarit për Çështjet Zgjedhore në PS.

Ai ka ndjekur një seri kursesh e trajnimesh profesionale lidhur me administrimin e sistemit gjyqësor, prokurimet publike, mbrojtjen e mjedisit dhe menaxhimin e administratës publike, të organizuara nga Banka Botërore, Bashkimi European, USAID dhe qeveria italiane në Shqipëri, Lituani, Greqi, Itali e disa vende të tjera.

